




# KËNDVËSHTRIMI ALTERNATIV I PROGRESIT MJEDISOR

NEGOCIATAT E  
SHQIPËRISË NË **BE**  
DHE KAPITULLI 27

Prill 2021



OGREEN27+

Tiranë, Shqipëri

Prill 2021

Në e vlerësojmë mbështetjen e OSHC-ve partnere të GREEN27+, të cilat e mbështetën hartimin e këtij raporti dhe morën pjesë në mënyrë aktive në aktivitetet e konsultimit:

#### Drejtuan procesin dhe hartuan raportin:

Qendra Burimore e Mjedisit (REC Shqipëri)

Qendra Mjedisore për Zhvillim, Edukim dhe Rrjetëzimin (Qendra EDEN)

Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA)

Instituti i Kërkimeve Urbane (URI)



#### Mbështeten dhe kontribuan përmes konsultimeve:

Aarhus Information Centre, Shkodër

Albanian Shkodra Lake Forum

Association for the Protection of Life and Ecosystems, Bunizani

Center for Development of Communities, Durrës

Center for Protection of the Natural Ecosystems in Albania (EcoAlbania)

Center "Today for the Future"

Ecological Club, Elbasan (KEE)

Ecological Club, Lezhë (KEL)

Environmental Association "Çajupi", Gjirokastrë

For Social and Environmental Welfare

Good Governance of Natural Ecosystems, Divjaka

Gjirokastra Foundation

Lipëri di Viaggiare, Durrës

Local Democracy Agency (LDA), Vlorë

Organization for Protection of Environment and Development of Tourism, Kukës

Protection and Preservation of Natural Environment in Albania (PPNEA)

"Tjetër Vizion" non-profit organization, Elbasan

Unë, Gruaja, Pogradec

Mbështetur nga:





## Këndvështrimi alternativ i progresit mjedisor

Negociatat e Shqipërisë  
në BE dhe Kapitulli 27



# PËRMBAJTJE

<b>Hyrje</b>	<b>4</b>
<b>Përmbledhje</b>	<b>6</b>
<b>Metodologjia</b>	<b>9</b>
<b>1.1 Legjislacioni Horizontal</b>	<b>11</b>
1.1 Hyrje	12
1.2 Vlerësim i shpejtë i progresit	14
1.3 Vlerësim i hollësishëm i nënkapitullit – progresi i deritanishëm	15
<b>2. Mbetjet</b>	<b>33</b>
2.1 Hyrje	34
2.2 Vlerësim i shpejtë i progresit	37
2.3 Vlerësim i hollësishëm i nënkapitullit – progresi i deritanishëm	40
<b>3. Uji</b>	<b>66</b>
3.1 Hyrje	68
3.2 Vlerësim i shpejtë i progresit	70
3.3 Vlerësim i hollësishëm i nënkapitullit – progresi i deritanishëm	72
<b>4. Ruajtja e Natyrës</b>	<b>83</b>
4.1. Hyrje	84
4.2. Vlerësim i shpejtë i progresit	86
4.3. Vlerësim i hollësishëm i nënkapitullit – progresi i deritanishëm	87
<b>5. Pozicionimi i OJF-ve: pritshmëritë mbi çfarë duhet ndryshuar dhe përmirësuar</b>	<b>100</b>
<b>Referenca</b>	<b>104</b>

## Hyrje

Shqipëria po përparon drejt përbushjes së kushteve për të nisur procesin e negociatave me BE-në. Është e ditur dhe pranuar që Kapitulli 27: "Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike" është një nga kapitujt më kompleksë, ku aktorë të ndryshëm të shoqërisë duhet të përfshihen dhe të kontribuojnë. Partnerët kryesorë të Grupimit GREEN 27+: Qendra Burimore e Mjedisit (REC Shqipëri), Qendra Mjedisore për Zhvillim, Edukim dhe Rrjetëzim (EDEN), Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA) dhe Instituti i Kërkimeve Urbane (URI), janë angazhuar në zhvillimin e një programi mbështetjeje dhe rritje kapacitetesh për shoqërinë civile, duke synuar përmirësimin e procesit të integritimit të Shqipërisë në BE, duke nxitur dialogun midis institucioneve qeveritare dhe OShC-ve mbi legjislacionin mjedisor. Me mbështetjen e 20 organizatave mjedisore nga i gjithë vendi, programi i parë pilot është një kontribut i ngritur për procesin, duke zhvilluar dhe artikulluar pozicionin e OShC-ve në negociatat BE-Shqipëri, në lidhje me temat e Kapitullit 27. Në mënyrë që të maksimizohen rezultatet e prekshme të raportit, nënkapitujt tematikë të mëposhtëm janë identifikuar si fokus prioritar:

1. Legjislacioni horizontal
2. Mbetjet
3. Uji
4. Ruajtja e natyrës

Kjo qasje ka ndihmuar në pasqyrimin e pozicionit të OShC-ve mjedisore në procesin e përafrimit të Shqipërisë me BE-në në fushat e mësipërme të nënkapitullit.

Grupimi GREEN 27+ beson fuqimisht në rolin e rëndësishëm që shoqëria civile mjedisore shqiptare mund dhe duhet të luajë në procesin e negociatave me BE-në, një rol vendimtar dhe të pashmangshëm në të gjithë këtë proces.

Nga ana tjetër, gjendja aktuale e gatishmërisë institucionale për negociatat me BE-në tregon një hapësirë të kufizuar për përfshirjen e shoqërisë civile. Kjo, kryesisht për shkak të mungesës së mënyrave, njohurive për përfshirjen e OShC-ve, si dhe informacionit të kufizuar teknik mbi vetë procesin e negociatave me BE-në. Sidoqoftë, OShC-të mjedisore shqiptare po luajnë gjithnjë e më shumë rolin e tyre mbikëqyrës në zhvillimin e politikave, përbushjen e kërkesave dhe zbatimin e ligjit, të drejtën për të marrë

informacion dhe pjesëmarrjen publike, etj.

Ky raport vlen si një mjet për të kuptuar proceset e përafritit dhe negociatave me BE-në, në një moment kyç për zhvillimin dhe rritjen e lëvizjes së OShC-ve në Shqipëri, duke synuar marrjen e pozicionit të ekspertit për të mbrojtur disa përparësi mjedisore. Një shoqëri civile më e fortë rezulton në një qeverisje më të mirë, duke identifikuar zgjidhjet më të mira në arritjen e kërkesave të BE-së për mjedisin, si dhe duke ndihmuar institucionet e vendit në përmbushjen e përgjegjësiave të tyre.

Përfshirja në proces u përqendrua në sigurimin e opinionit dhe raportit alternativ të progresit përmes vlerësimit të progresit të vendit në sektorët e synuar.

Procesi i raportit kontribuoi gjithashtu në rritjen e kapaciteteve dhe rritëzimin e OShC-ve. Edhe pse situata e pandemisë e shkaktuar nga COVID-19ndikoi në zhvillimin e procesit të raportit, aktivitete të ndryshme u përdorën për të rritur kapacitetet e ekspertëve të OShC-ve në temat e negociatave me BE-në, si dhe për të ruajtur kanalet e komunikimit dhe dialogut midis autoriteteve dhe shoqërisë civile, në mënyrë që të rritet ndikimi i tyre në proceset e vendimmarrjes për aspektet e negociatave me BE-në.



**SANE** Supporting  
Albanian  
Negotiations  
in Environment  
**27**



- Ky raport u përgatit bashkërisht nga grupimi GREEN
- 27+, me ndihmën e Qeverisë Suedeze, përmes
- Agjencisë Suedeze të Mbrojtjes së Mjedisit, e cila
- mbështet punën e Republikës së Shqipërisë drejt një
- mjedisi më të mirë dhe zbatimin e përfitimeve mjedisore
- të BE-së për Kapitullin 27 me aftësitë dhe njohuritë
- suedeze për rregulloret e BE-së dhe zbatimin. Burimi i
- financimit për këtë tender vjen nga Agjencia Suedeze
- e Zrvillimit Ndërkombëtar (SIDA) në kuadër të zbatimit
- të programit SANE27.





## PËRMBLEDHJE

Rruga e Shqipërisë në procesin e integritimit evropian është e gjatë për sa i përket kohëzgjatjes dhe përpjekjeve. Puna filloi me aplikimin zyrtar të Shqipërisë për anëtarësimin në BE në 28 Prill 2009. Dialogu i rregullt politik dhe ekonomik midis BE-së dhe Shqipërisë ka vazhduar përmes strukturave përkatëse sipas Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA) që u nënshkrua në Prill 2009. Këshilli European i dha Shqipërisë statusin e vendit kandidat në qershor 2014. Qeveria e Shqipërisë është e angazhuar në reformat e lidhura me BE-në dhe në adresimin e përparësive kryesore të identifikuara për hapjen e negociatave të anëtarësimin.

Pas disa vitesh diskutimi, më në fund Këshilli vendosi (Mars 2020) të hapë negociatat e pranimit me Shqipërinë. Në muajt e ardhshëm, Komisioni European do të paraqesë propozime për kuadrin negociues me Shqipërinë. Ky kuadër përcakton udhëzimet dhe parimet që rregullojnë negociatat e anëtarësimin me Shqipërinë si një vend kandidat. Opinioni i përgjithshëm është se Kapitulli 27 nuk do të jetë ndër kapitujt me shumë përparësi për të filluar negociatat, por QShC-të mjedisore mbeten me bindje të forta se përgatitja dhe diskutimet mbi përparimin e vendit duhet të fillojnë që në fazat e hershme të procesit.

Legjislati Horizontal përfaqëson pjesën e Legjislatit të BE-së e cila parashikon metoda dhe mekanizma që synojnë përmirësimin e vendimmarrjes dhe zhvillimin dhe zbatimin e legjislatit. Ai prek tema të ndryshme mjedisore si natyra, uji, mbetjet, ajri etj. Megjithatë përfaqëson një fushë të sapozhvilluar të legjislatit, qeveria shqiptare është në një fazë mesatare të nivelit të transpozimit të tij. Zbatimi i kësaj pakete ka mangësi në disa pjesë dhe në disa të tjerë, është në fazën fillestare. Sfidat kryesore lidhen me: *Jetësimin e rolit të autoriteteve përgjegjëse në zbatimin e tij; ekzistencën e mekanizmave më efektive për të rritur transparencën në procedurat e konsultimit dhe informimit; Rritjen e investimeve në burimet njerëzore, teknologjitet e përparuar dhe mbështetjen e nevojshme nga teknologjia e informacionit; Organizimin e më shumë fushatave të edukimit dhe informimit që synojnë publikun e gjerë në mënyrë që ato të nxiten më shumë institucionet për të zhvilluar më mirë konsultimet dhe dëgjesat publike, duke rritur zbatimin e duhur të këtyre direktivave.*

Legjislati i BE-së për ruajtjen e natyrës përfshin direktivat, qëllimi i të cilave ndryshon nga ruajtja e përgjithshme e habitateve dhe llojeve përkatëse (Direktivat e Shpendëve

dhe Habitatare) deri te ruajtja e elementeve specifike të biodiversitetit (Direktiva e lëkurave të fokave) ose krijimi i mjeteve funksionuese të ruajtjes (Direktiva e Kopshteve Zoologjike). Vlerësimi i përgjithshëm tregon se ka progres të konsiderueshëm në transpozimin e Direktivave të Shpendëve dhe Habitatare, ndërkohë që ka pak ose aspak përparim në transpozimin e direktivave të tjera. Zbatimi është kryesisht në një fazë fillestare për të gjitha direktivat. Në përgjithësi, institucionet përkatëse janë ngritur, por kapacitetet e tyre janë të dobëta si në numër ashtu edhe në aftësitë e kërkuara për zbatimin e direktivave të BE-së. *Zbatimi i duhur cenohet nga niveli i ulët i njohurive mbi shpërndarjen e habitatare dhe llojeve me rëndësi të BE-së, si dhe zbatimi i dobët dhe ndjekja penale e kufizuar e krimeve mjedisore. OJQ-të mund të kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme në përfundimin e punës kërkimore, publikimin e shkeljeve dhe kryerjen e aktiviteteve edukuese që synojnë përmirësimin e njohurive dhe perceptimit të publikut për ruajtjen e natyrës.*

Legjislati i BE-së për menaxhimin e ujit përfshin direktiva të rëndësishme që kanë të bëjnë me menaxhimin e baseneve lumore, trajtimin e ujërave të pijshëm dhe të ujërave të zeza dhe vlerësimin e cilësisë së ujit. Vlerësimi i përgjithshëm tregon se ekziston një larmi e madhe e shpejtësisë së transpozimit për direktiva të ndryshme, duke filluar nga transpozimi i plotë (Direktiva e ujit të pijshëm) e deri më tani (Direktivat Detare, Përmbytjet dhe Ujërat nëntokësore). Zbatimi është kryesisht në një fazë fillestare për të gjitha direktivat. Sektori i ujit mbetet i fragmentuar dhe me përgjegjësi të shpërndara midis institucioneve në nivelin qendror dhe vendor. Ne e vlerësojmë Agjencinë e themeluar së fundmi për Menaxhimin e Burimeve Ujore, e cila ka burime dhe kapacitete njerëzore të kufizuara për të adresuar nevojat e sektorit të ujit, veçanërisht në planifikimin dhe menaxhimin e baseneve të lumenjve. Nga ana tjetër, investimet kapitale të zbatuara për ujin e pijshëm dhe trajtimin e ujërave të ndotura kërkojnë forcimin e kapaciteteve të shërbimeve të ujit në mënyrë që të rritet efica dha dhe të sigurohet funksionimi i qëndrueshëm i shërbimit të furnizimit me ujë për qytetarët. Përveç ndërhyrjeve në bashkitë e mëdha, cilësia e shërbimit (cilësia dhe sasia e ujit, mbulimi i trajtimit, etj.) mbetet e dobët dhe e pamjaftueshme për të përmirësuar gjendjen e të ardhurave të ndërmarrjeve. *Masa urgjente duhet të merren për të përparuar me transpozimin e Direktivës së Përmbytjeve dhe asaj Detare, të cilat do të çojnë në plane veprimi për adresimin e masave lehtësuese lidhur me urgjencat dhe mbrojtjen civile në zonat e prirura për përmbytje, si dhe për zhvillimin e planeve të Ekonomisë Blu. Gjithashtu, mbështetja për sektorin e Ujësjellësit dhe Kanalizimeve duhet të përqendrohet në zhvillimin*



*e kapaciteteve njerëzore dhe digjitalizimin e të dhënave dhe asetëve për rritjen e efikasitetit të punës dhe përmirësimin e cilësisë së ujit dhe shërbimin ndaj qytetarëve.*

Menaxhimi i mbetjeve është një nga sektorët strategjikë, siç është deklaruar nga Qeveria e Shqipërisë, e cila synon ta trajtojë këtë temë në vijimësi. Qeveria shqiptare ka ndërmarrë hapa të mirë në transpozimin e legjislacionit të BE-së dhe posaçërisht në nën-kapitullin e menaxhimit të mbetjeve, megjithatë, zbatimi i këtij legjislacioni ka mangësi në disa pjesë dhe në disa të tjera, është në fazën e tij fillestare. Sfidat kryesore lidhen me zbatimin e parimit 'ndotësi paguan' dhe parimin e 'përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit', zbatimin e hierarkisë së mbetjeve dhe ngritjen e një sistemi të unifikuar për raportimin dhe monitorimin e të dhënave. Përparimi në zbatimin e këtyre koncepteve kryesore do të lejojë Shqipërinë të përmbushë kërkesat e BE-së dhe të sigurojë menaxhimin e duhur të mbetjeve për të arritur standarde më të larta për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut.

Ky raport është shkruar nga një grup i OJQ-ve mjedisore shqiptare, që synojnë të paraqesin opinionin e OJQ-ve mbi progresin e vendit drejt transpozimit të Legjislacionit përkatës të BE-së dhe zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ky proces. Raporti synon institucionet shqiptare dhe ato të BE-së, përgjegjëse për negociatat e vendit për Kapitullin 27, duke synuar mbështetjen e procesit të gatishmërisë së institucioneve shqiptare për fazën e negociatave, duke pasqyruar zërin dhe pozicionin e OJQ-ve.

Ne, përfaqësuesit e lëvizjes shqiptare të mjedisit jemi të vetëdijshëm për sfidat e mëdha me të cilat po përballen qeveria dhe institucionet e tjera përgjegjëse në zbatimin e kërkesave ligjore për një mjedis më të mirë. Ka pasur përparim të mirë në fusha të ndryshme të mjedisit në transpozimin e Direktivave dhe krijimin e institucioneve të reja. Sidoqoftë, ne mbetemi kritikë për shpejtësinë e transpozimit të disa Direktivave të tjera dhe procesin e zbatimit. Ne theksojmë nevojën për adresimin e burimeve të kufizuara të alokuara për këtë proces nga qeveria, si dhe për angazhimin, në mënyrë domethënëse, të publikut dhe OJQ-ve, duke informuar dhe mundësuar hapësirë për pjesëmarrje dhe kontribut.



## METODOLOGJIA

Ky Raport i Opinionit i OSHC-ve është raporti i parë i përgatitur nga rrjeti GREEN 27+ mbi zhvillimet e rëndësishme dhe ndryshimet në mbrojtjen e mjedisit dhe ndryshimet klimatike në Shqipëri. Ai pasqyron angazhimin e Organizatave të Shoqërisë Civile Mjedisore (OSHC) për të kontribuar në proceset e vendit për integrimin në BE me fokus në çështjet e lidhura me mjedisin.

Raporti është një kontribut i përbashkët i organizatave të shoqërisë civile për diskutimin që na presin, mbi mjedisin dhe çështjet e ndryshimeve klimatike.

Rrjeti GREEN 27+ u bashkua në përgjigje të nevojës së vendit për një fazë përgatitje më të shpejtë dhe më cilësore për proceset e integritit në BE. Integrimi evropian është një nga proceset më kërkuese për institucionet dhe shoqërinë shqiptare. Teksa qytetarët e Shqipërisë mbështesin me shumicë anëtarësimin në Bashkimin Evropian, raportet e vlerësimit specifikojnë se Shqipëria dhe institucionet e saj ende kanë nevojë për reforma serioze për të arritur këtë qëllim.

Rrjeti Mjedisor për Integrimin në BE „GREEN 27+“ është një nismë e OSHC-ve mjedisore shqiptare, e cila mbështet zhvillimin e kapaciteteve të anëtarëve të saj dhe komunitetit të OSHC-ve në procesin e integritit në BE përmes ngritjes së burimeve dhe ekspertizës në të gjithë rrjetin.

Raporti po ndjek kuadrin tematik të Raportit të BE-së për Shqipërinë për vitin 2020. Ekziston një devijim në fusha të caktuara tematike, pasi OSHC-të nuk ndiheshin mjaftueshëm të kualifikuara për të bërë vlerësime për temat e mëposhtme: cilësia e ajrit, menaxhimi i kimikateve, zhurmat dhe mbrojtja civile. Ne shpresojmë të forcojmë kapacitetet tona për t'u marrë me këto fusha të politikave në të ardhmen, dhe të kemi më shumë organizata që të na bashkohen në këtë rrugëtim. Për më tepër, ne paraqesim zhvillimet dhe sfidat kryesore dhe japim rekomandime se si të ecim përpara.

Në hartimin e këtij raporti, GREEN 27+ ka përdorur raportet e botuara dhe informacionin e ndarë në takime dhe konferenca të ndryshme për progresin e



vendit deri në Dhjetor 2020. Dy raunde të konsultimeve të OShC-ve dhe tetë aktivitete janë organizuar në periudhën Dhjetor 2020 - Shkurt 2021, me rreth 38 OShC në rajone të ndryshme të Shqipërisë, ku organizatat partnere pasuruan procesin me raste të shumta studimesh vendore dhe shqetësime mjedisore në nivelin vendor.

Në këtë mënyrë, në shprehim gatishmërinë tonë për t'u përfshirë në mënyrë aktive në procesin e negociatave dhe për të ofruar ekspertizën dhe kapacitetet tona në mënyrë që të sigurojmë rezultate sa më të mira.

# 1 LEGI SLACIONI HORIZONTAL



## 1.1 HYRJE

Legjislati Horizontal (LH) përfaqëson atë pjesë të Legjislatit të BE-së që parashikon metoda dhe mekanizma që synojnë përmirësimin e vendimmarrjes dhe zhvillimin dhe zbatimin e legjislatit, dhe është pikërisht ky fokus që e bën atë shumë të rëndësishëm për një qeverisje pjesëmarrëse dhe të përgjegjshme, duke kontribuar për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm. Këto çështje të legjislatit kanë një qasje më tepër procedurale se sa thjesht me qëllim për të rregulluar një fushë specifike. Si i tillë, sektori Horizontal prek tema të ndryshme mjedisore si natyra, uji, mbetjet, ajri etj., për të siguruar zbatimin ligjor dhe politik të niveleve më të mira të demokracisë, të të drejtave të njeriut dhe mbrojtjes së mjedisit.

Megjithatë përfaqëson një fushë të sapo-zhvilluar të legjislatit, ai ka tërhequr vëmendjen e Qeverisë Shqiptare dhe është në një nivel mesatar transpozimi. Forcat kryesore shtytëse deri më tani janë angazhimi i vendit për pranimin në BE dhe advokimi qytetar. Zbatimi dhe kuadri institucional mbeten një sfidë.

Siç theksohet në raport-progresin e BE-së për Shqipërinë për vitin 2020 - „..... masat e menjëhershme për të rishikuar dhe përmirësuar vlerësimet e ndikimit mjedisor dhe strategjik... përgjegjësitë për zbatimin e legjislatit mjedisor duhet të qartësohen dhe zbatimi duhet të përforcohet me shpejtësi, veçanërisht për të adresuar në mënyrë efektive krimet mjedisore ...” - pengesat në zbatimin e ligjit vendosin pikëpyetje mbi progresin e transpozimit.

Nuk ka asnjë Strategji Kombëtare që merret me çështjet horizontale dhe legjislati kombëtar udhëheq sektorin. Ligji kryesor kuadër është ligji „Për Mbrojtjen e Mjedisit” duke rregulluar më pas proceset specifike nëpërmjet ligjeve për „Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, „Vlerësimin Strategjik të Mjedisit”, „Për njoftimin dhe konsultimin publik” dhe „Për të drejtën e informacionit”. Gjithashtu, janë miratuar disa akte dhe rregullore normative.

Përpjekjet e para drejt një pakete të strukturuar Horizontale në Shqipëri, filluan në vitin 2001 me ratifikimin e Konventës së Aarhusit, e cila mundësoi dhe forcoi hapësirën qytetare në mjedis. Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC) dhe ministria përgjegjëse për mjedisin janë rritur së bashku në kuptimin dhe përmirësimin e këtyre çështjeve ligjore. Në ditët e sotme, sektori horizontal nuk vuan nga mungesa e të kuptuarit, dhe aq më pak nga angazhimi për transpozim, por vuan sepse është shumë pak funksional për

shkak të procedurave fiktive, mungesës së kontrollit cilësor, sepse konsiderohet si hapi më pak i rëndësishëm në zinxhirin vendimmarrës dhe si një barrë në terma kohorë. Sfida më e madhe për shqyrtimin / zbatimin e duhur të akteve ligjore horizontale i atribuohet interesit ekonomik që mbizotëron ndaj mbrojtjes së mjedisit.

Zbatimi i paketës horizontale lidhet me vullnetin dhe kapacitetet politike, mbështetjen financiare dhe për më tepër me njerëzit e arsimuar dhe të vetëdijshëm. OSHC-të aktive dhe prezantimi i tematikës në kurrikulën mësimore në një fazë të hershme luan një rol të rëndësishëm.

Qeveria shqiptare ka ndërmarrë vazhdimisht nisma dhe angazhime reale në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar si një mbështetje shtesë për Legjislacionin Horizontal, veçanërisht për të forcuar zërin e qytetarëve. Përmendim këtu Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut, Konventën e Aarhusit, Partneritetin për Qeverisje të Hapur etj.

Legjislacioni i BE-së në këtë sektor mbulon 7 Direktiva dhe 1 Rekomandim:

Direktiva e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM)

Direktiva e Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM)

Direktiva e Të Drejtës për të Marrë Informacion

Direktiva e Pjesëmarrjes Publike

Direktiva e Përgjegjësisë Mjedisore

Rekomandimi 2001/331/EC që parashikon kriteret minimale për inspektimet mjedisore (RMCEI)

Direktiva e Infrastrukturës për Informacionin Hapësinor (INSPIRE)

























Direktiva e Krimit Mjedisor

Transpozimi dhe zbatimi i plotë i Direktivave të Legjislacionit Horizontal do të forcojë një shoqëri demokratike në Shqipëri. Do të ulë nivelet e shkatërrimit të burimeve natyrore, biodiversitetit dhe peizazhit natyror. Do të krijojë besim midis qytetarëve dhe institucioneve qeveritare, dhe në të njëjtën kohë do të rrisë bashkëpunimin ndërinstytucional dhe do të përmirësojë transparencën. Do të sigurojë progres në zhvillimin e vendit sipas përparësive kombëtare duke përfshirë investimet, sigurimin e qëndrueshmërisë së tyre si dhe do të mbështesë ekonominë vendore dhe të brishta. Zbatimi i Legjislacionit Horizontal është një mjet mbështetës edhe për reformën e Decentralizimit në Shqipëri.



## 1.2 VLERËSIM I SHPEJTË I PROGRESIT

Ne kemi nevojë për më shumë fytyra të gjelbra të buzëqeshura për paketën e Legjislacionit Horizontal, në nivelet e kuadrit institucional dhe zbatimit të tij.

Nënkapitujt/direktiva	Vlerësimi		
	Transpozimi	Kuadri Institucional	Zbatimi
Legjislacioni horizontal			
Direktiva e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM)			
Direktiva e Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM)			
E drejta për të marrë Informacion			
Pjesëmarrja Publike			
Përgjegjësia Mjedisore			
Kriteret minimale për inspektimet mjedisore (RMCEI)			
Infrastruktura për Informacion Hapësinor (INSPIRE)			
Krimi Mjedisor			

*Tabela 1: Vlerësim i shpejtë i Legjislacionit Horizontal*

## 1.3 VLERËSIM I HOLLËSISHËM I NËNKAPITULLIT – PROGRESI I DERITANISHËM

### Direktiva e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM)

Direktiva e BE-së mbi „Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” përcakton parimet e përgjithshme të vlerësimit të efekteve mjedisore të projekteve publike dhe private që ka të ngjarë të kenë efekte të konsiderueshme në mjedis.

### Transpozimi

Direktiva nuk është transpozuar plotësisht, por është në një nivel të përparuar transpozimi. Është transpozuar pjesërisht në ligjet për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM)<sup>1</sup>, Mbrojtjen e Mjedisit<sup>2</sup>, Konventën e Aarhusit<sup>3</sup>, Avokatën e Popullit<sup>4</sup> dhe në tre vendime të këshillit të ministrave (VKM)<sup>5</sup> që kanë të bëjnë me shumë me rregullat dhe procedurat gjatë përgatitjes së VNM-ve dhe konsultimeve publike në këtë drejtim.

Të katër ligjet kanë kaluar nëpër procedura ndryshimesh, kryesisht për shkak të ndryshimeve administrative në institucionet qeveritare dhe më pak për shkak të pengesave dhe sfidave në lidhje me zbatimin, të cilat vazhdojnë të jenë të pranishme. Një çështje e rëndësishme për t'u ngritur në transpozim është „fuqia” e pakët që ligji shqiptar për VNM-të i jep Deklaratës Mjedisore. Sipas ligjit shqiptar, Deklarata Mjedisore nuk përfaqëson një vendim të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit (MTM) dhe Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM) për të lejuar zhvilluesin të vazhdojë ose jo me projektin, por ajo i referohet një formati sugjerimi / dokumenti orientues për autoritetet e tjera të planifikimit në zinxhirin e vendimmarrjes për të lëshuar ose jo një leje të nevojshme, si leja mjedisore, leja e ndërtimit etj.

Transpozimi ekzistues mbulon pjesët më të rëndësishme të Direktivës. Megjithatë, Direktiva kërkon transpozim të plotë dhe të menjëhershëm sepse në një situatë të

1 Ligji nr. 10440, datë 7.7.2011, i ndryshuar

2 Ligji nr. 10431, datë 9.6.2011, i ndryshuar

3 Ligji nr. 8672, datë 26.10.2000

4 Ligji 8454, datë 4.2.1999

5 VKM nr. 686 i datës 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisve e të afatave për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklarates mjedisore”, i ndryshuar; VKM 247 i datës 30.04.2014 “Për përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”; VKM nr. 598, 01.07.2015 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin e ndikimit në mjedisin ndërkufitar”

prioritizimit të projekteve të zhvillimit në turizëm, energji, infrastrukturë, etj., kjo direktivë bëhet e një rëndësie të jashtëzakonshme, veçanërisht kur merret parasysh se është e lidhur drejtpërdrejt me lejet mjedisore dhe zërin e komunitetit vendor.

### **Kuadri institucional**

Autoritetet kryesore përgjegjëse për zbatimin e kësaj pakete ligjore janë MTM dhe AKM me drejtoritë e saj rajonale (DRM). Ndërkohë, teksa MTM-ja ka më shumë kompetenca në hartimin e politikave, AKM-ja është autoriteti operativ, i cili ndjek rregullat dhe rregulloret dhe bashkërendon të gjithë procedurën e përgatitjes dhe aplikimit të VNM-ve, duke siguruar informacionin dhe konsultimin e duhur me publikun. Në fund, ata hartojnë Deklaratën Mjedisore (DM), e cila nënshkruhet nga drejtori i AKM-së dhe Ministri. Brenda organigramës së AKM-së, me VNM-të merret vetëm një sektor brenda Drejtorisë së Vlerësimit të Ndikimit dhe Licencave. Mungojnë kapacitetet njerëzore si në numër ashtu edhe në ekspertizë.

Për të përmbushur detyrat e saj në lidhje me VNM-të, AKM-ja bashkëpunon me Ministrinë e linjës dhe njësitë e qeverisjes vendore (NJQV). Bashkëpunimi ndërinstitucional AKM – NJQV, për informimin dhe konsultimin me publikun është një detyrim ligjor. NJQV-të kanë përgjegjësi të informojnë dhe të marrin pjesë aktive në organizimin e dëgjësave publike dhe konsultimeve. DRM-të merren më shumë me raportimin dhe monitorimin e procesit. Ky bashkëpunim tripalësh, AKM-NJQV-DRM është një forcë për zbatimin e VNM-ve për të siguruar angazhimin institucional dhe qasjen pjesëmarrëse. Ata duhet të angazhohen për të zgjeruar stafin dhe për të zhvilluar kapacitetet e tyre.

Më shumë në kuadrin institucional, roli i Avokatit të Popullit ka të bëjë me mbikëqyrjen dhe zbatimin e të drejtave civile, përfshirë të drejtat për informacionin mjedisor, pjesëmarrjen në vendimmarrjen mjedisore etj. Roli i Avokatit të Popullit dhe prania e tij në procesin e VNM-ve duhet të jenë më specifike dhe proaktive. Do të duhen kapacitete shtesë njerëzore për institucionin. Shembujt nga vendi ynë kanë treguar që kjo do të ishte e dobishme, sidomos kur u referohemi komuniteteve vendore të prekura.

### **Zbatimi**

Për të arritur një nivel të dëshirueshëm të zbatimit të akteve ligjore që mbulojnë Direktivën e VNM-ve, nevojitet staf, aftësi dhe kapacitete bashkërenduese, respektim i kornizës kohore të procedurës, mjete dhe kanale të zhvilluara të komunikimit dhe kontroll me cilësi të lartë. Kjo paketë ligjore ende mbetet një nga më të kontestuarat për sa i përket zbatimit.

Procedura e informacionit publik, si për VNM-në e integruar ashtu edhe për VNM-në e thjeshtë, është përmirësuar me kalimin e viteve, por gjithsesi i mungon afati kohor për shpërndarjen pasive të njoftimeve, dokumenteve dhe llojeve të dokumenteve të ndara. Publikut i sigurohet më pak kohë dhe më pak materiale, sesa nevojitet për informacionin e duhur. Kërkesat që zhvilluesit paraqesin në AKM për t'u nënshtruar një procedure VNM-je, përfshijnë të njëjtin nivel dhe lloj informacioni, por nuk respektohet i njëjti format. Në shumicën e rasteve nuk ka asnjë dokument shoqëruar të kërkesës, siç kërkohet në VKM<sup>6</sup> mbi rregullat dhe përgjegjësitë për procesin e VNM-ve. Data kur aprovohet kërkesa mungon. Një informacion i tillë është i vështirë për t'u gjetur në faqet e internetit të NJQV-ve ose nuk konsiderohet me vlerë për t'u botuar.

Konsultimet dhe dëgjimet publike duhet të përmirësohen. Atyre u mungon cilësia që nga fillimi i procesit, si pasojë e procedurave të dobëta të informimit publik, që u shpjegua më lart. Për më tepër, në dëgjimet publike mungon pjesëmarrja përfaqësuese e komuniteteve të prekura dhe palëve të interesit si nga numri ashtu edhe nga mjedisi shoqëror. Rezultati i përgjithshëm është dëgjesa të shpejta, formale dhe fiktive të publikut. Mund të përmendim dy çështje mjedisore<sup>7</sup> të paraqitura në gjykatë kundër MTM-së, AKM-së dhe Ministrive të linjës duke përdorur si argument kryesor ligjor konsultat publike fiktive gjatë procedurave të VNM-ve, dhe njëra prej tyre fitoi çështjen gjyqësore.

Modele të mira të informacionit dhe konsultimit me publikun gjatë VNM-ve zbatohen veçanërisht kur përfshihen institucione ndërkombëtare financiare publike si BERZH, IFC, KfW, BB, apo edhe në projekte me përfshirjen e kompanive të huaja, si p.sh. projekti Trans Adriatic Pipeline etj.

AKM, DRM dhe NJQV nuk e kanë përcaktuar ende procedurën e komunikimit të rezultateve pjesëmarrëse dhe dhënien e shpjegimeve se pse disa nga rekomandimet ose të gjitha nuk pasqyrohen në vendimin përfundimtar. Kjo ka qenë një praktikë e

6 VKM nr. 686 i datës 29.07.2015

7 1) Rasti i komunitetit të fshatit Kurth dhe EcoAlbania kundër digave në lumin Vjosë. Konsultimet publike u mbajtën në Bashkinë e Fierit me pjesëmarrës që nuk përfaqësonin fare komunitetin e prekur dhe nuk ndiqnin kufijtë ligjorë të kohës. Komuniteti vendor fitoi çështjen gjyqësore. Për më shumë: <https://www.historia.me/arte-drejtat-e-njeriut/banoret-dhe-aktivistet-fillojne-gyqin-kunder-ndertimit-te-hidrocentralit-te-pocemit/> 2) Komuniteti vendor i Drago-bisë dhe QJQ Toka kundër digave në parkun kombëtar Valbona. Persona të vdekur rezultojnë si nënshkruar në listën e pjesëmarrësve për konsultime publike. Ata e humbën çështjen gjyqësore. Për më shumë: <https://citizens-channel.com/2019/02/15/hec-et-ne-valbone-shoqata-toka-padit-akm-che-ministrine-e-mjedist/>



mirë nga Drejtoria e Informacionit në ish-Ministrinë e Mjedisit. Tani që kjo Ministri është ristrukturuar në MTM, kjo praktikë është hequr nga organigrama dhe praktika të tilla të mira nuk ekzistojnë më. Raportet përfundimtare të VNM-ve botohen në faqen e AKM-së, por të gjithëve u mungon informacioni kur është mbajtur konsultimi publik dhe dëgjesa publike, lista e pjesëmarrësve dhe procesverbalet e takimeve (veçanërisht për VNM-në e integruar për të cilën procesi është i detyrueshëm). Ky informacion nuk përfshihet as në DM, si detyrim me ligj. Në këtë drejtim, AKM-ja duhet të përmirësojë shpërndarjen e informacionit për publikun në dëgjesat dhe konsultimet publike. Mënyra e deritanishme e bën shumë të vështirë monitorimin e procesit në Shqipëri, dhe mund të shihet gjithashtu si mungesë transparence mbi vendimin përfundimtar.

DM-ja publikohet në faqen zyrtare të AKM-së. Përmbajtja ka nevojë për përmirësim sepse është shumë e përgjithshme dhe mbështetet shpesh në besimin dhe mendimin se zhvilluesi do të respektojë procedurat, në vend që të sigurohet për këtë gjë. Do të ishte lehtësuese dhe ndihmuese për lexuesin nëse AKM-ja do të ngarkonte dokumentin e DM-së në të njëjtën pjesë të faqes në internet ku paraqitet kërkesa nga zhvilluesi, raporti përfundimtar i VNM-së dhe procesi i konsultimit. Kjo do ta bënte më të lehtë për ne, publikun, të ndërldhim vendimin me kërkesën dhe raportin e VNM-së, pa humbur shumë kohë në lundrim. E njëjta gjë vlen edhe për vendimet e komisionit për aplikim të thjeshtë ose të integruar të VNM-së, të cilat jo vetëm që gjenden në një seksion tjetër të faqes në internet, por në të shumtën e rasteve, atyre të fundit u mungon edhe data. Duhet që faqja e internetit e AKM-së të jetë më miqësore për përdoruesit.

Monitorimi bëhet vetëm në rastin e raportit të integruar të VNM-së përmes monitorimit të kushteve në dokumentin e DM (i cili në vetvete është i paqartë) dhe Lejes Mjedisore. Procesi i monitorimit është përgjegjësi që është ngarkuar vetëm zhvilluesit (privat ose publik) i cili dorëzon raporte në AKM/ DRM. Raportet e monitorimit nuk janë botuar në faqen e internetit të AKM-së dhe kështu publiku nuk mund të ushtrojë hapur të drejtën e tij ligjore për të komentuar mbi të dhënat e publikuara, siç përshkruhet në nenin 1.4 të VKM-së për pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore. Vetë-monitorimi i ndikimit në mjedis, edhe pse diktohet nga Direktiva e BE-së, ka treguar të jetë problematik në Shqipëri. Komunitetet vendore ankohen për nivelin e lartë të ndotjes nga fabrikat dhe industritë që operojnë në sektorë si prodhimi i naftës, çimentos, çelikut, fabrikave të lëkurës, etj., ndërkohë që raportet e monitorimit tregojnë për përmbushjen e kushteve mjedisore. Mungesa e licencave të certifikimit të laboratorëve të institucioneve shtetërore për të ndërmarrë monitorim mjedisor me standardet e BE-së e bëjnë të vështirë mbështetjen e ankesave të njerëzve dhe kontrollin e dyfishtë

të rezultateve të vetë-monitorimit. Kjo situatë po përmirësohet. Shembull: AKM-ja është e certifikuar për monitorimin e ndotjes së ujit dhe ajrit.

Analizat e dobëta të VNM-ve dhe raportet e dobëta të VNM-ve janë një çështje problematike e madhe. Kontrolli i cilësisë së raporteve të VNM-ve mungon dhe ngrihet shpesh si problem nga shoqëria civile mjedisore. Raportet kanë mungesë të përputhshmërisë me ligjin për strukturën dhe informacionin e përmbajtjes, shpesh paraqesin dhe përdorin të dhëna të vjetruara, interpretim dhe analiza sipërfaqësore të të dhënave, dhe në një numër të konsiderueshëm rastesh, përmbajnë apo janë një material i kopjuar nga projekte të ndryshme. Kur bëhet fjalë për strukturën e vendimarrjes në lidhje me procedurën e integruar ose të thjeshtë të VNM-ve, nuk është e qartë për publikun se kush bën kontrollin e cilësisë së raporteve. Për të shmangur korrupsionin, ne e kuptojmë plotësisht vendimin për të mos bërë publik emrat, por do të vlerësohej që të kuptonim qartë mbi përvojën e ekspertizës së anëtarëve dhe mënyrën e funksionimit të tyre.

### **Direktiva e Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM)**

Direktiva e BE-së mbi „Vlerësimin Strategjik Mjedisor“ parashikon një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe kontribuon në integrimin e konsideratave mjedisore në përgatitjen e planeve dhe programeve (jo politikave) me qëllim promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm.

### **Transpozimi**

Direktiva është transpozuar plotësisht në ligjin kuadër për Vlerësimin e Ndikimit Strategjik<sup>8</sup> i cili rregullohet nga dy VKM<sup>9</sup> që kanë të bëjnë me rregullat dhe procedurat për konsultimet dhe dëgjesat publike, përfshirë edhe kontekstin ndërkufitar. Deri diku, elementi i paqartë i kësaj pakete ligjore është se nuk i referohet kornizës ligjore përkatëse, në mënyrën se si duhet të organizohen detyrimet e informacionit dhe konsultimit. Ai vë theks të madh në kufijtë kohorë të procesit dhe duket se ua lë institucioneve të zgjedhin mënyrën e informimit dhe pjesëmarrjes publike. Ky pozicion e bën më të vështirë vlerësimin nëse këto dy procese janë ndërmarrë siç duhet apo jo.

<sup>8</sup> Ligji nr. 91/2013, datë 28.2.2013

<sup>9</sup> VKM 219, datë 11.03.2015 “Për përcaktimin e rregullave e të procedurave për konsultimin me grupet e interesit dhe publikun, si dhe dëgjesën publike gjatë procesit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor”; dhe VKM Nr. 520 i datës 07.07.2015 “Për miratimin e rregullave, përgjegjësisë dhe procedurave të detajuara për Vlerësimin Strategjik Mjedisor në kontekstin ndërkufitar”

## Kuadri institucional

Autoriteti përgjegjës vendimmarrës për procedurën e VSM-së në Shqipëri është MTM, qw jo vetëm lëshon Deklaratën e Ministrit në fund të procedurës së VSM-së, por përfshihet që në fillim për të konfirmuar ose jo nëse një plan ose program i nënshtrohet procedurës së VSM-së. Nëse çështja është po, atëherë është përgjegjësi e të gjitha institucioneve publike përgjegjëse për hartimin e planit / programeve për të koordinuar dhe për të kryer procedurën e VSM-së. Ligji cakton Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT) si institucionin në të cilin MTM-ja depoziton kopjet e çdo vendimi në lidhje me procedurën e VSM-së. Nuk është e qartë se cili është roli i saktë i AKPT-së në të gjithë procesin. Autoritetet propozuese - institucionet publike të cilat propozojnë planin dhe / ose programet - janë gjithashtu përgjegjëse për zbatimin e kësaj pakete ligjore. Roli i tyre është vendimtar në koordinimin dhe organizimin e konsultimeve dhe dëgjësive publike për raportin e VSM-së.

Kuadri institucional në legjislacion është shumë i përgjithshëm dhe duket se i gjithë procesi do të rregullohet së brendshmi nga secili institucion publik i përfshirë. Legjislacioni nuk i referohet një kontakti ose direktive specifike për të koordinuar të gjithë procesin, por udhëzon vetëm përmes hapave.

Procedura e VSM-së nuk konsiderohet kërkuese për sa i përket kapaciteteve njerëzore dhe logjistikës. Si e tillë, ne e konsiderojmë lirinë ekzistuese të vetë-organizimit brenda autoriteteve propozuese të përshtatshme si një kuadër institucional. Megjithatë, ne e konsiderojmë shumë të rëndësishme nevojën për zhvillim të shpeshtë të kapaciteteve për të avancuar kuptimin dhe përditësimin e procedurave të VSM-ve.

## Zbatimi

Është e rëndësishme të theksohet se procesi i VSM-ve është një proces shumë i ri në Shqipëri dhe deri më tani është zbatuar me sukses për planifikimin e territorit përkatësisht në Planin e Përgjithshëm Kombëtar dhe në 61 Planet e Përgjithshme Vendore. AKPT-ja ka koordinuar në një nivel të mirë të gjithë procesin dhe po njësoj kanë bërë NJQV-të. Në faqen e internetit të AKPT-së ka një pasqyrim të qartë të procesit dhe rezultateve, dhe publiku ka qasje në secilin dokument të lidhur, përfshirë raportin e VSM-ve. Seancat dëgjimore publike pasqyrohen si lajme në faqen e internetit dhe nuk japin informacion shtesë për komentet, reflektimin e tyre, shpjegimin për refuzimin e ndonjë komenti, listën e pjesëmarrësve etj. Duke pasur parasysh që ligji nuk është specifik për mënyrën se si duhet të ndiqen konsultimet, çdo mënyrë mund



të konsiderohet e saktë. Bashkitë gjithashtu janë angazhuar në proces edhe pse jo të gjitha kanë reflektuar procesin në faqet e tyre të internetit. Një shembull tjetër pozitiv i procedurës së VSM-ve mund të konsiderohet Plani Sektorial Kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta, por është e vështirë të gjejmë në faqen e internetit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë ndonjë dokument shtesë përveç planit. Shkurtimisht, është e vështirë të monitorohet zbatimi i VSM-ve për shkak të treguesve të paqartë për proceset e informacionit dhe konsultimit, por në të njëjtën kohë, edhe sepse informacioni është pjesërisht i disponueshëm ose mungon për publikun përmes faqeve të internetit. Për më tepër, MTM-ja është autoriteti përgjegjës me ligj për të raportuar çdo vit mbi zbatimin e ligjit kuadër për VSM-të dhe për ta publikuar atë në faqen e saj të internetit. Një raport i tillë nuk është publik dhe nuk kemi tregues nëse është bërë. Në të njëjtën kohë, MTM-ja, si institucioni që koordinon zbatimin, nuk nxit zbatimin e tij. Ekzistojnë dy shembuj jo të mirë të procesit të VSM-ve, të tilla si në rastin e Strategjisë për Menaxhimin e Burimeve Ujore dhe të Masterplanit Kombëtar për Infrastrukturën e Gazit që tregojnë se MTM-ja mund të përmirësojë rolin e saj në nxitjen e një procesi të duhur. Në të dy rastet, procesi i VSM-ve ka filluar pasi kishin mbaruar dokumentet kryesore (Strategjia dhe Masterplani).

### **Direktiva e Të Drejtës për të drejtën e informimit**

Kjo direktivë është në përputhje me kërkesat e shtyllës së parë të Konventës së Aarhusit. Ajo garanton të drejtën për të marrë informacion mjedisor nga /ose për autoritetet publike me kërkesë (shpërndarje pasive) dhe për shpërndarjen progresive të informacionit mjedisor që ata kanë (shpërndarje aktive).

### **Transpozimi**

Direktiva e të Drejtës për të Marrë Informacion Mjedisor është transpozuar plotësisht në Shqipëri në ligjet për Mbrojtjen e Mjedisit <sup>10</sup>, të Drejtën e Informimit <sup>11</sup> dhe Kodin e Procedurave Administrative <sup>12</sup>. Gjithashtu është rregulluar nga VKM-të që kanë të bëjnë me të Drejtën e Publikut për të Marrë Informacion Mjedisor <sup>13</sup> dhe Pjesëmarrjen e Publikut në Vendimmarrjen Mjedisore<sup>14</sup>

10 Nr.10431 datë 9.6.2011

11 Nr.119 datë 18.9.2014

12 Nr.44 datë 30.04.2015

13 Nr.16, datë 4.1.2012

14 Nr.247 datë 30.04.2014



## Kuadri Institucional

Institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtyre bazave ligjore janë MTM, AKM, NJQV dhe në një shkallë më të gjerë të gjitha autoritetet publike në Republikën e Shqipërisë, duke i detyruar ata që në hapin e parë të caktojnë koordinatorin për të drejtën e marrjes së informacionit. Koordinatorët janë shumë të rëndësishëm për zbatimin e të drejtës për marrjen e informacionit pasi ata janë kontakti i parë me secilin institucion kur zbatohet kjo e drejtë. Ata janë përgjithësisht të përgjegjshëm ndaj kërkesave, por ka nevojë për të forcuar këtë pozicion duke caktuar një staf të plotë të përkushtuar vetëm për këtë detyrë. Situata aktuale është se, koordinatorët kanë disa përgjegjësi të ndryshme brenda institucionit publik, shpesh ata janë të mbingarkuar dhe vihen nën presion dhe i japin përparësi punëve të tjera. Pra, shpesh koordinimi për shpërndarjen e informacionit mbetet puna më pak e rëndësishme. Në të vërtetë ekziston një zinxhir komunikimi me të njëjtat institucione për të siguruar informacionin e kërkuar. Kjo duhet të bëhet përmes bashkëpunimit të ndërsjellë nga secila drejtori për t'i dhënë informacionin në kohë koordinatorit dhe më tej publikut.

Megjithatë, prania e koordinatorit ka përmirësuar shumë transparencën dhe komunikimin e drejtpërdrejtë / të shpejtë me publikun. Ne mbështesim përpjekjet e tyre dhe kërkojmë më shumë fokus për të përmirësuar rolin dhe shërbimet e tyre në drejtim të kapaciteteve njerëzore dhe pajisjeve të teknologjisë së informacionit. Kjo situatë bëhet më urgjente për institucionet mjedisore të cilat duhet të veprojnë nën një mori ligjesh dhe aktesh nënligjore për të rregulluar strukturën e tyre operacionale dhe për të siguruar zbatimin e duhur.

Ky ligj ka ndihmuar në përmirësimin në mënyrë radikale të faqeve të internetit të bashkive, në krijimin dhe përmirësimin e tyre. Siç është vërejtur nga BIRN në raportin e tyre, të gjitha bashkitë kanë krijuar një faqe në internet (krahasuar me vitin 2017), por përsëri këto faqe kanë nevojë për mirëmbajtje për të punuar mirë dhe për të qenë miqësore në përdorim për publikun.

Për më tepër, miratimi i ligjit për informacionin publik i jep institucionit të Komisionerit për Informimin dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KIMDP) fuqinë për të kryer kontrollin të hetimit administrativ për zbatimin e të drejtës për informacion. Si i tillë, ai luan një rol të rëndësishëm në nxitjen dhe sigurimin e zbatimit të ligjit. Ajo që duhet të theksohet për rolin e komisionerit, është se ai nuk ka vetëm një rol monitorues.

## Zbatimi

Zbatimi i ligjit për të drejtën e informimit ka marrë shumë ndihmë nga krijimi i platformës në internet [www.pyetshtetin.al](http://www.pyetshtetin.al) në vitin 2015. Duke miratuar VKM-në për krijimin e regjistrit elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve për të drejtën e informimit<sup>15</sup> numri i institucioneve prej të cilave mund të kërkohet informacion është rritur në 59 deri më sot, nga shtatë që ishin në momentin e parë që u krijua regjistri elektronik. Platforma është e strukturuar shumë mirë, të gjithë, OJQ-të, si dhe individët mund të kenë qasje të lehtë në të, përmes një regjistrimi të thjeshtë të të dhënave kryesore personale. Kjo përmirëson transparencën e procesit, ndihmon koordinatorin për të menaxhuar më mirë detyrat e tij dhe komisioneri i referohet një komunikimi të ruajtur në sistem midis atij që kërkon informacionin dhe institucioneve përgjegjëse dhe nuk ka mundësi të humbasë asnjë komunikim. Ende ekziston nevoja për të rritur ndërgjegjësimin e publikut për platformën, për t'u njohur më shumë me shërbimin e ofruar prej saj, i cili është lehtësisht i arritshëm dhe praktik.

Krahasuar me VKM-në për të drejtën e publikut për të marrë informacion mjedisor<sup>16</sup>, ligji për të drejtën e informimit parashikon kohë më të shkurtër për të marrë informacionin (10 ditë në krahasim me 30 ditë) për aplikuesin dhe nuk i përmbahet VKM-së por zbaton procedurat që duhen ndjekur. Kur procedurat e VKM-së nuk ndiqen, nuk ka një organ përgjegjës që kërkon zbatimin e tij. Sidoqoftë, ky hap sigurohet nga ligji për të drejtën e informimit, kur roli i komisionerit është shumë specifik dhe shumë i rëndësishëm për nxitjen e zbatimit të ligjit nga secili institucion përgjegjës. Në këtë kuptim, ligji ka përmirësuar procedurën që duhet të ndiqet në lidhje me përfshirjen e publikut në informacion për çështjet mjedisore.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale publikon një raport vjetor. Sipas raportit të vitit 2019, 786 ankesa iu drejtuan komisionerit, 553 prej tyre u zgjidhën pas ndërhyrjes së Zyrës së Komisionerit tek autoritetet publike dhe Komisioneri mori vendime në lidhje me 18 ankesa. Ky numër i lartë i ankesave drejtuar komisionerit tregon se roli i tij është shumë i rëndësishëm dhe se publiku e njihë rëndësinë e tij dhe rolin që ai ka për zgjidhjen e boshllëqeve në procesin e të drejtës së publikut për marrje informacioni. Po ashtu, numri i lartë tregon se megjithëse ligji ekziston, ende ka vend për përmirësim për zbatimin e tij.

<sup>15</sup> VKM nr. 145, datë 13.3.2018

<sup>16</sup> VKM nr.247, datë 30.04.2014

## Direktiva për Pjesëmarrjen Publike

Kjo Direktivë parashikon pjesëmarrjen e publikut gjatë hartimit të disa planeve dhe programeve në lidhje me mjedisin dhe ndryshimet e tyre, në lidhje me pjesëmarrjen e publikut dhe qasjen në drejtësi. Përputhet me kërkesat e shtyllës së dytë dhe të tretë të Konventës së Aarhusit.

### Transpozimi

Direktiva është transpozuar plotësisht në vend nga ligjet „Për njoftimin dhe konsultimin publik“<sup>17</sup>, dhe „Për mbrojtjen e mjedisit“<sup>18</sup>. Gjithashtu përmes VKM-ve “Për përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”<sup>19</sup> dhe “Për pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”<sup>20</sup>. Ligji për njoftimin dhe konsultimin publik siguron parimet e pjesëmarrjes në një spektër më të gjerë sesa parimet mjedisore, por nuk është i plotësuar me aktet nënligjore normative, të cilët, në anën e tyre, përfaqësojnë pjesën kryesore të kuadrit ligjor që ndikon drejtpërdrejt në të drejtat e qytetarëve dhe palëve të interesit.

### Kuadri Institucional

Institucionet përgjegjëse për zbatimin e kësaj baze ligjore janë Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Drejtoritë Rajonale të Mjedisit, njësitë e qeverisjes vendore, autoritetet publike në Republikën Shqiptare, Zyra e Komisionerit të Informacionit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit e cila është e angazhuar në ngritjen dhe funksionimin e Regjistrit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike dhe luan rol në zhvillimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK), Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, qw ka rolin parësor në mbikëqyrjen dhe monitorimin e zbatimit të këtij ligji. Çdo institucion vendimmarrës dhe legjislativ ka përgjegjësinë për të publikuar në regjistrin elektronik dokumentet që do të konsultohen me grupet e tyre të interesit.

### Zbatimi

Është krijuar një Regjistër Elektronik për Njoftimin dhe Konsultimin Publik <https://konsultimipublik.gov.al/>. Publiku mund të ketë qasje të lehtë për të komentuar në internet dokumentet, por nuk ekziston një komunikim aktiv për të dhënë arsyet e pranimit ose të mospranimit të komenteve dhe sugjerimeve për dokumentet e konsultuara. Është e nevojshme të zhvillohet një fushatë në internet për të promovuar këtë platformë, për

17 Nr. 146 datë 30.10.2014

18 Nr. 10431 datë 9.6.2011

19 Nr.994 datë 02.07.2008

20 Nr.247 datë 30.04.2014



t'i bërë njerëzit të vetëdijshëm për rolin e tyre për të qenë aktiv në platformë përmes komenteve / sugjerimeve për dokumentet e konsultuara. Përveç platformës në internet, duhet të jetë edhe mundësia që dokumenti të konsultohet fizikisht dhe jo vetëm në internet, pasi qasja në internet nuk është në dispozicion për të gjithë.

Koordinatorët për njoftimin dhe konsultimin publik e kanë këtë detyrë së bashku me shumë detyra të tjera që ata i konsiderojnë më të rëndësishme dhe me përparësi më të lartë. Për më tepër, për të përmbushur detyrën, ata mbështeten në koordinimin e brendshëm dhe të jashtëm institucional, i cili në vetvete nuk funksionon si duhet. Koordinatori ka nevojë për trajnim specifik për ngritjen e kapaciteteve të tij në lidhje me përdorimin e platformës elektronike të konsultimit publik. Në shumë raste ata nuk e kanë të qartë përgjegjësinë e tyre dhe nuk e kuptojnë plotësisht rolin e tyre. Zakonisht publiku nuk është i qartë kur fillon dhe mbaron periudha e konsultimit; dhe nuk i jepet koha e mjaftueshme siç tregohet nga ligji specifik për të hartuar dhe paraqitur komente. Procedurat e konsultimit publik zbatohen pro-forma (autoritetet përgjegjëse i kushtojnë vëmendje vetëm konformitetit zyrtar në lidhje me pikat e neneve të ligjit, duke mos marrë parasysh nevojat reale të publikut në fjalë). Kjo nuk ndodh as zyrtarisht. Pika më e dobët e zbatimit të ligjit është „mungesa e komunikimit”, në lidhje me marrjen në konsideratë apo jo të komenteve publike në versionin përfundimtar të dokumentit. Kjo pjesë është pika më e dobët në procedurën e konsultimeve publike, sepse praktika tregon të kundërtën (nuk ndodh as zyrtarisht). Kjo ndikon të gjithë rëndësinë e procesit. Posta elektronike është forma më e përdorur e njoftimit dhe marrjes së komenteve publike, shumë rrallë publikimi shfaqet në sallat e institucioneve, dhe madje edhe më pak për mediat. Por kjo formë (përmes postës elektronike) çon vetëm në konsultime të palëve të interesuara dhe jo me publikun e gjerë që në këtë mënyrë përjashtohet nga procesi. Faqet e internetit të institucioneve nuk janë miqësore për përdoruesit dhe është e vështirë të gesh informacione specifike në to. Ka mungesë të informacionit të duhur dhe angazhimit real të publikut prej institucioneve përgjegjëse. Niveli i interesit për një çështje të caktuar në këto rrethana është vështirë të vlerësohet. Pra, ka mungesë të mekanizmave për të ftuar dhe angazhuar publikun në procesin e vendimmarrjes. Nuk ka asnjë plan vjetor të MTM-së që tregon dokumentet që do të shkojnë për konsultim publik dhe kur ato janë planifikuar të ndodhin.

Versioni përfundimtar i ligjit të miratuar në parlament ka marrë parasysh vetëm një pjesë të vogël të rekomandimeve dhe nuk është publikuar një përmbledhje e arsyeve për të mos pranuar pjesën tjetër të rekomandimeve.

Një raport monitorimi mbi zbatimin e këtij ligji duhet të publikohet, por duhet të sqarohet se cili organ është përgjegjës për hartimin e raportit dhe si i tillë asnjë raport zbatimi nuk është ende publik.

Dy shembuj pozitivë institucionesh, ku ky ligj po zbatohet në nivele të mira janë:

a) Parlamenti shqiptar, i cili boton një raport vjetor mbi pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje. Raporti thekson se OIQ-të janë grupi më aktiv në aktivitetet e konsultimit të parlamentit dhe për shkak të ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik, parlamenti ka rritur numrin e takimeve të konsultimit dhe po thekson rëndësinë e kontributit të OIQ-ve në procesin e konsultimit.

b) Ministria e Drejtësisë. Qeveria shqiptare ka miratuar planin e veprimit 2020 - 2022 për partneritete të hapura dhe qeverisje, i cili është një mjet i rëndësishëm për promovimin e transparencës së qeverisë në nivel botëror, për të rritur pjesëmarrjen qytetare në jetën publike dhe shtyn përdorimin e teknologjive të reja për të përmirësuar punën e administratës dhe luftuar korrupsionin. Dokumenti i planit të veprimit u konsultua gjerësisht në takime të ndryshme të organizuara nga Ministria e Drejtësisë dhe konsultimepublike.org ishte platforma kryesore për njoftimin dhe konsultimin publik të këtij plani të rëndësishëm të veprimit.

### Direktiva e Krimit Mjedisor

Direktiva e BE-së mbi „Krimin Mjedisor“ përcakton kërkesat minimale në lidhje me ligjet penale në Shtetet Anëtare në mënyrë që të sigurohet mbrojtje më e mirë e mjedisit.

### Transpozimi

Direktiva është transpozuar pjesërisht në Shqipëri në një shpërndarje mjaft horizontale në gjashtë ligje, duke përfshirë: ligjin për Kodin Penal<sup>21</sup>, për Përgjegjësinë Penale<sup>22</sup>, për Zonat e Mbrojtura<sup>23</sup>, për Mbrojtjen e Faunës së Egër<sup>24</sup>, për Korventën për Tregtinë

21 Ligji Nr. 7895, datë 27.1.1995

22 Ligji Nr. 9754, datë 14.06.2007

23 Ligji Nr.81, datë 4.5.2017

24 Ligji Nr. 10006, datë 23.10.2008, i ndryshuar

Ndërkombëtare të Specieve të Rrezikuara të Florës dhe Faunës së Egër (CITES)<sup>25</sup>, për rregullat dhe procedurat për CITES<sup>26</sup>; në një VKM<sup>27</sup> për miratimin e llojeve të habitateve, florës dhe faunës me interes të Komunitetit dhe në dy urdhra<sup>28</sup> që lidhen me CITES dhe listën e zogjve të cenueshëm.

Duke marrë parasysh që krimet mjedisore shënuan një rritje vjetore me 7,69% në vitin 2019 dhe duke ditur se vijuan të "lulëzojnë" edhe në vitin 2020, sidomos në kushtet e kufizimeve globale për shkak të pandemisë Covid-19, bëhet një emergjencë për të shpejtuar transpozimin e Direktivës së Krimit Mjedisor, sepse mungesa e kuadrit të duhur ligjor dhe institucional është arsyeja kryesore e rritjes së nivelit të krimeve mjedisore.

### **Kuadri Institucional**

Kuadri ligjor aktual nxit dhe kërkon rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional për të luftuar krimin mjedisor duke përfshirë MTM-në, Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit (ISHMPUT), Prokurorinë e Përgjithshme, Policinë e Shtetit Shqiptar, si edhe konsultimin e ngushtë me njësi të kërkimore në sektorin e akademisë për CITES, dhe, natyrisht, NJQV-të.

Transpozimi i pjesshëm i Direktivës, aktet ligjore ekzistuese të parregulluara dhe aktet e vjetra ligjore në fuqi e bëjnë shumë të vështirë bashkëpunimin efektiv ndërinstitucional kur bëhet fjalë për Krimin Mjedisor. Ekziston vullneti dhe motivimi shumë i mirë për ta shtyrë sektorin përpara, por ka shumë nevojë për arsimim dhe ngritjen e kapaciteteve institucionale dhe ekspertizës mbi kompleksitetin e krimit mjedisor. Më shumë sesa nxitja për bashkëpunim, struktura ekzistuese institucionale është një model i mbivendosjes institucionale të kompetencave.

Për të mbështetur zhvillimin e kapaciteteve dhe bashkëpunimin ndërinstitucional dhe shmangur nënvlerësimin e Krimit Mjedisor, me mbështetjen dhe nismën e OSBE-së në Shqipëri është formuar Grupi Ndërinstitucional kundër Krimit Mjedisor (GNKM). Ai është i përbërë nga 11 subjekte dhe 12 ekspertë për të shkëmbyer informacion, për të organizuar aktivitete të përbashkëta, inspektime dhe për të propozuar ndryshime ligjore.

25 Ligji Nr. 9021, datë 6.3.2003

26 Ligji Nr. 9867, datë 31.1.2008, i ndryshuar

27 VKM Nr. 866, datë 10.12.2014 "Për miratimin e listave të llojeve të habitateve natyrore, bimëve, kafshëve dhe shpendëve, me interes për bashkimin evropian"

28 Urdhër i Ministrisë së Mjedisit Nr. 62 i datës 04.04.2016 "Miratimi i listës së llojeve të shpendëve të egër, veçanërisht vulnerabel"; Urdhër i Ministrisë së Mjedisit Nr. 726 i datës 26.10.2015 "Për miratimin e formatit të dokumenteve standard në përputhje me dispozitat ligjore për begtinë ndërkombëtare të llojeve të rrezikuara të faunës dhe florës së egër"

## Zbatimi

Sipas të dhënave të marra nga Prokuroria e Përgjithshme për rastet e krimit mjedisor në Shqipëri, për një periudhë prej 9 muajsh, vihet re se viti 2020 ka shënuar një rritje të numrit të krimit mjedisor, me 254 çështje të trajtuara dhe 146 raste të pakonsideruara, ndërsa dënimi mbetet në nivele shumë të ulëta me vetëm gati 5% të çështjeve të referuara në prokurori. Nga numri i përgjithshëm i çështjeve të trajtuara, 39 çështje penale kanë përfunduar me dënime. Ashtu siç tregojnë edhe shifrat, realiteti është edhe më keq.

Rastet e ndëshkuara nuk paraqesin realitetin e një numri të problemeve të vëzhguara në terren nga organizatat e shoqërisë civile, aktivistët e mjedisit dhe media lokale dhe kombëtare. Ka shumë më tepër raste krimesh mjedisore të raportuara nga organizata mjedisore të cilat nuk janë pasqyruar në statistikën e Prokurorisë. Prandaj është e nevojshme të nxiten hetimet nga prokuroria kur çështjet e krimit mjedisor bëhen publike nga organizatat e shoqërisë civile përmes rrjeteve të tyre të komunikimit. Gazetarët që raportojnë krimin mjedisor raportojnë se një numër ankesash pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale po refuzohen.

Grupi Konsultativ i Organizatave të Shoqërisë Civile (GKKM) është krijuar në fund të vitit 2019, me nismën dhe mbështetjen e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri. GKKM është një organizatë e pavarur dhe vullnetare e ekspertëve të mjedisit, organizatave të shoqërisë civile dhe gazetarëve që synojnë të rrisin ndërgjegjësimin në nivelin qendror dhe vendor për të ndihmuar në zhvillimin e programit të qeverisë për krimin mjedisor duke bashkëpunuar me autoritetet përgjegjëse dhe komunitetet vendore për të rritur shkallën e bashkëpunimit dhe raportimin e veprave penale.

## Direktiva të tjera

- *Direktiva e përgjegjësisë mjedisore* ndjek një qasje të përgjegjësisë administrative mbi dëmtimin e mjedisit (natyra, uji, toka). Është transpozuar në nivele të dobëta dhe autoritetet kryesore kompetente janë MTM, AKM dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE). Mungesa e të dhënave për sektorin na kufizon të reflektojmë më shumë mbi këtë Direktivë në legjislacionin shqiptar.

- *Rekomandimi 2001/331/EC* që parashikon kritere minimale për inspektimet mjedisore (RMCEI). Meqenëse Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe



Turizmit (ISHMPUT) po riorganizohet që prej korrikut 2019, kompetencat e tij tani ndahen midis AKM-së dhe Inspektoratit Kombëtar për Mbrojtjen e Territorit. Megjithatë, këto ndryshime nuk janë pasqyruar në kuadrin ekzistues ligjor. Si i tillë, ai paraqet një pikëpyetje të madhe për zbatimin dhe transpozimin e mëtejshëm të Direktivës. Përgjegjësitë për legjislacionin mjedisor duhet të sqarohen dhe zbatimi vetë duhet të forcohet shpejt, veçanërisht për të adresuar në mënyrë efektive krimet mjedisore.

- **Direktiva e Infrastrukturës për Informacionin Hapësinor (INSPIRE)** – përcakton një kuadër të përgjithshëm për një infrastrukturë të të Dhënave Hapësinore për qëllimet e politikave mjedisore të Komunitetit Evropian dhe politikave ose aktiviteteve që mund të ndikojnë në mjedis. Kjo Direktivë është në një nivel të përparuar të transpozimit në Shqipëri. Autoriteti kryesor kompetent është Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeo-hapësinor (ASIG) dhe më pas kompetencat ndahen midis një numri të madh të institucioneve të tjera. Politikat e Qeverisjes për Sektorin e Informacionit Gjeo-hapësinor në Shqipëri, 2020-2030 janë përgatitur për të përcaktuar drejtimet e politikave të qeverisjes për 10 vitet e ardhshme deri në vitin 2030. Gjeo-portali Kombëtar i administruar nga ASIG siguron të dhëna gjeo-hapësinore (në formatin GIS) përmes shërbimeve të rrjeteve. Aktualisht, 215 shtresa gjeo-informacionesh janë botuar në Gjeo-portalin Kombëtar me metadata (informacion i fshehur në fotografi) përkatëse, për grupe të të dhënave gjeo-hapësinore. 215 shërbime online për informacionin gjeo-hapësinor të gjetur në Gjeo-portal janë publikuar në menunë e „shërbimeve” të Gjeo-portalit Kombëtar nga 17 institucione.



## RAST STUDIMOR

### Rasti: GURORET DHE REHABILITIMI I DËMIT MJEDISOR

**Përmbledhje:** Parku Kombëtar i Malit të Tomorrit është një ekosistem interesant natyror. Zona promovohet „keq” për shkak të dëmit të shkaktuar nga prania e të paktën 22 guroreve. Kufijtë e parkut janë zgjeruar në vitin 2018 nga një VKM, me synimin për të rritur ruajtjen e zonës së mbrojtur. Si rezultat, 12 gurore u përfshinë brenda kufijve të rinj të zgjeruar të parkut dhe MTM, pas inspektimeve dhe monitorimeve të shpeshta, revokoi lejet mjedisore për 12 ndërmarrjet përkatëse. Ndërkohë, të gjitha guroret që operojnë për më shumë se 20 vite në zonë kanë leje shfrytëzimi minierash për 25-35 vite. Shumë nga kompanitë e guroreve e kanë rinovuar këtë leje shfrytëzimi, shumë të tjerë e kanë marrë së fundmi. Para procesit të marrjes së lejes së shfrytëzimit, kompanitë e guroreve janë të detyruara të marrin lejen mjedisore. Kompanitë nuk ishin të kënaqura me MTM dhe u ankuan se kjo nuk është e drejtë.

### SI PO NDIQET:

- Kompanitë paditën MTM-në për veprimin kundër ligjit dhe ata fituan gjyqin. Argumenti kryesor i gjykatës ishte: MTM nuk kaloi nëpër konsultime dhe seanca dëgjimore para se të propozonte dhe miratonte VKM-në e re e cila zgjeroi kufijtë e parkut. Konsultimi publik është një kërkesë ligjore nga VKM-ja për përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore.<sup>29</sup> *Kjo ngre çështjen e konsultimeve publike që po injorohen edhe nga vetë MTM.*
- Baza ligjore mjedisore thekson fuqimisht parimin „Ndotësi paguan” dhe detyron rikuperimin e kostos për të kryer rehabilitimin e dëmit mjedisor. Sidoqoftë, aktet nënligjore specifikisht për të orientuar dhe specifikuar zbatimin e këtij parimi në gurore, por edhe në përgjithësi për shfrytëzimin e minierave nuk janë plotësuar dhe udhëzimet / urdhërat lënë hapësirë për zbatim dhe interpretim të paqartë. *Kjo çon në krim të pandëshkuar mjedisor dhe mbivendosje ndërinstucionale.*
- AKM nuk posedon asnjë plan rehabilitimi për aktivitetin e këtyre guroreve, siç kërkohet me ligj. AKBN luan një rol të rëndësishëm në përcaktimin e sipërfaqes së shfrytëzimit dhe teknikës së përdorur, dhe është „mbajtësi” i fondit të depozituar nga njësia ekonomike çdo vit për të siguruar rehabilitimin. Sidoqoftë, kjo agjenci

<sup>29</sup> VKM nr 994, datë 02.07.2008.

deklaron se llogaritja e këtyre taksave vjetore dhe koeficientit të tyre është shumë më e vogël se kostoja e mbulimit të dëmtimit të mjedisit dhe sigurimi i rehabilitimit. *Ky është tregues për procedura të dobëta mjedisore, veçanërisht VNM, e cila nuk merr parasysh aspektet e rehabilitimit. Në të njëjtën kohë kjo çon në justifikimin e një krimi mjedisor si „të ligjshëm“.*


- Institucionet përgjegjëse për inspektimin dhe sigurimin e rehabilitimit të zonës janë të vetëdijshme për mungesën e rehabilitimit, por nuk janë në gjendje të përcaktojnë rolin e tyre specifik në këtë procedurë. **Pa kompetenca të qarta.**

Vullneti politik është pozitiv drejt forcimit të zbatimit të praktikave rehabilituese. Sidoqoftë, bashkëveprimi dhe koordinimi ndërinstytucional është shumë i dobët. Ka mungesë aftësish dhe detyra të mbivendosura midis institucioneve mjedisore dhe institucioneve që mbikëqyrin aktivitetet minerare.



2

MBETJET



## 2.1 HYRJE

Menaxhimi i mbetjeve është një nga përparësitë kryesore të deklaruara nga Qeveria e Shqipërisë<sup>30</sup>, e cila synon të vijojë ta trajtojë këtë temë edhe në vitet e ardhshme. Në këtë drejtim, Shqipëria ka ndërmarrë hapa të mirë në transpozimin e legjislacionit të BE-së dhe posaçërisht në nënkapitullin e menaxhimit të mbetjeve, ku niveli i transpozimit të akteve ligjore është rreth 53,5%<sup>31</sup>, por megjithatë, zbatimi i këtij legjislacioni është i mangët në disa komponentë, ndërsa në disa të tjerë, është ende në fazën fillestare.

Në kuadër të përgatitjes për hapjen e negociatave të anëtarësimit, në vijim të urdhrimit të Kryeministrit Nr. 94, datë 20 Maj 2019, „Për Ngritjen, Përbërjen dhe Funksionimin e Grupeve Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian”<sup>32</sup>, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është institucioni drejtues për negociatat mbi Kapitullin 27 - Mjedisit dhe Ndryshimet Klimatike, ku përfshihet edhe sektori i menaxhimit të mbetjeve.

### Situata aktuale

Pavarësisht se Shqipëria ka përmirësuar legjislacionin e saj dhe shumica e tij është e përafuar me legjislacionin e BE-së, sektori i menaxhimit të mbetjeve mbetet ende një sfidë.

Problemet lidhen kryesisht me shtrirjen e pjesshme të shërbimit në territor, grumbullimin dhe depozitimin e parrjaftueshëm të mbetjeve, sasinë e kufizuar që depozitohet dhe trajtohet në vend depozitime, praninë e një numri të madh të lëndfilleve (të autorizuar dhe të paautorizuara) të cilat janë jashtë standardeve higjienike dhe inxhinierike, numri i kufizuar dhe cilësia e dobët e pajisjeve për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve, mungesa e ndarjes së mbetjeve në burim dhe përqindja e ulët e riciklimit, mungesa e infrastrukturës për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

Ministria e linjës ka miratuar kohët e fundit dy dokumente kryesore „Dokumenti i Politikave Strategjike të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve dhe Plani Kombëtar 2020-2035”<sup>33</sup> (Dokumenti i Politikave Strategjike) dhe „Plani Kombëtar Sektorial

30 Siç përcaktohet nga ligji 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

31 “Raporti përgatitor i vlerësimit”, përgatitur në kuadër të projektit SANE27.

32 Nr. 94, datë 20 Maj 2019

33 Miratuar me VKM Nr. 418, datë 27.05.2020

për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta”<sup>34</sup> (Plani Sektorial), i cili përcakton objektivat strategjike, synimet dhe infrastrukturën kryesore të nevojshme për menaxhimin e integruar të mbetjeve. Këto dokumente shënojnë një moment të rëndësishëm në përmirësimin e sektorit, por ato duhet të ndiqen nga plane rajonale dhe vendore të menaxhimit të mbetjeve dhe investimeve për ndërtimin e infrastrukturës të magazinimit të përkohshëm (stationet e transferimit) dhe lëndfilleve sanitare në mënyrë që të arrihet një gjendje e mirë mjedisore.

Referuar të dhënave nga Instituti i Statistikave (INSTAT)<sup>35</sup> për vitin 2019, shërbimi është ofruar për 87,9% të popullsisë, ose për 2.508.834 banorë, nga totali i popullsisë së vendit prej 2.854.191 banorësh, ndërsa në vitin 2018 për vetëm 65,7% të popullsisë. Bazuar në këto statistika, rritja e mbulimit të grumbullimit të mbetjeve me 22,2% në vitin 2019 në krahasim me vitin 2018 është një arritje e madhe në përmirësimin e shërbimit, megjithëse ende mbetet shumë për t’u bërë, pasi një sasi e konsiderueshme mbetjesh përfundojnë të pakontrolluara në mjedis, kryesisht përgjatë rrugëve, vijave ujore dhe lumenjve.

Të dhënat nga INSTAT raportojnë se rreth 18,7% e mbetjeve totale të gjeneruara në vitin 2019 janë ricikluar, ndërsa SHRSH<sup>36</sup> raporton se niveli i riciklimit në Shqipëri është rreth 10%, megjithëse askush nga informuesit nuk specifikon burimin e mbetjeve të ricikluara, nëse ato janë të ndara nga mbetjet e gjeneruara në vend, apo nëse kjo sasi përfshin mbetje të riciklueshme të importuara, veçanërisht skrape metali.

Hierarkia e mbetjeve nuk zbatohet dhe bashkitë nuk kanë të ngritur një sistem për grumbullimin e mbetjeve në 4 rryma: letër / karton; metal; plastikë dhe qelq; ashtu siç parashikohet nga ligji.

Dokumenti i ri i Politikave Strategjike dhe Plani Kombëtar 2020-2035 kanë vendosur objektivat e mëposhtëm për riciklimin e katër rrymave kryesore të mbetjeve.

34 Miratuar nga Këshilli Kombëtar Teritorial me Vendim Nr. 1 datë 13.01.2020

35 <http://www.instat.gov.al/media/7500/alb-mbetjet-e-ngurta-urbane-ne-shqiperi-2019.pdf>

36 Shoqata e Ricikluesve Shqiptarë



Llojet e mbetjeve (nga pesha totale e llojeve të mbetjeve)	Vili / Synimet e zvogëlimit të mbetjeve		
	2023	2028	2033
<b>Letër/karton</b>	10%	30%	60%
<b>Metal</b>	10%	30%	50%
<b>Plastikë</b>	6%	12%	23%
<b>Qelq</b>	10%	30%	60%
<b>Drru</b>	5%	10%	15%

*Tabela 2: Synimet për zvogëlimin e Mbetjeve të Ngurtë të Bashkive, bazuar në Politikat Strategjike dhe Planin Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurtë, 2020 - 2035*

Riciklimi në Shqipëri mbetet në fillimet e tij dhe procesi i ndarjes së mbetjeve në burim ende nuk është kthyer në praktikë. Prezantimi i sistemeve të ndarjes në burim duhet të marrë parasysh ndikimin e mundshëm social tek grumbulluesit jozyrtar të mbetjeve, veçanërisht nga komuniteti Rom dhe Egjiptian.

Aktualisht në Shqipëri ekzistojnë 4 lëndfille sanitare funksionale: Bushati në bashkinë Vau i Dejës, Sharra në bashkinë e Tiranës, Maliqi në bashkinë Maliq dhe Bajkaj në bashkinë e Sarandës. Këto janë të gjitha lëndfille sanitare, të cilat përputhen me standardet e vendosura për ndërtimin dhe funksionimin e një lëndfilli. Në Shqipëri ekzistojnë gjithashtu 199 lëndfille të paligjshme, disa prej të cilave përdoren momentalisht nga bashkitë për depozitimin e mbetjeve pa trajtim ose me trajtim minimal.

#### ***Nuk ka lëndfille për mbetje të rrezikshme dhe për mbetje inerte.***

Direktivat për: "Automjetet në fund të ciklit të jetës", "Mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike", "Përdorimi i Lumlrave në Bujqësi", "Bateritë", "Difenilet poliklorur (PCB) dhe Terfenilet poliklorur (PCT)", "Mbetjet e Minerave", janë në fazat e hershme të zbatimit. Këto lloje specifike të rymave të mbetjeve ose shumica e tyre janë nën përgjegjësinë e zgjeruar të prodhuesit, gjë që i detyron operatorët, prodhuesit, importuesit e produkteve dhe pajisjeve të krijojnë sisteme për grumbullimin, riciklimin dhe trajtimin e mbetjeve që vijnë nga këto produkte. Në situatën aktuale, nuk ekzistojnë sisteme të tilla. Ka disa operatorë që merren kryesisht me bateritë, PCB-të/PCT-të, automjetet në fund të ciklit të jetës, por ato nuk veprojnë në një mënyrë të integruar

dhe nevojitet më shumë për të zbatuar më mirë legjislacionin në fuqi.

Monitorimi dhe raportimi i të dhënave është një tjetër problem që e karakterizon këtë sektor. Ende nuk ka një platformë të unifikuar për raportimin e të dhënave nga prodhuesit, importuesit, bashkitë dhe çdo operator tjetër që gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij gjeneron mbetje të çdo lloji. Strukturat dhe mjetet e monitorimit për të gjitha subjektet që gjenerojnë mbetje në territorin e vendit janë të pakta në numër.

Në mënyrë që të transpozohet dhe zbatohet plotësisht direktiva e BE-së është e nevojshme të rriten dhe forcohen kapacitetet e burimeve njerëzore të dedikuara për procesin e transpozimit dhe autoritetet kombëtare të dedikuara për zbatimin dhe monitorimin e legjislacionit në fuqi. Nevojitet një qasje e integruar për të përmbushur kërkesat e BE-së me përfshirje aktive dhe bashkëpunim midis autoriteteve kombëtare dhe OJQ-ve, institucioneve akademike, kompanive të riciklimit, prodhuesve dhe shitësve me pakicë, në mënyrë që të përfshihen të gjithë palët e interesuara në proces.

## 2.2 VLERËSIM I SHPEJTË I PROGRESIT

Ky kapitull i raportit të opinionit të shoqërisë civile thekson statusin e menaxhimit të mbetjeve në Shqipëri sipas tre komponentëve: (I) niveli i transpozimit të legjislacionit, (II) kuadri institucional, dhe (III) zbatimi.

Niveli i transpozimit të legjislacionit paraqitet sipas „Raportit të vlerësimit paraprak të shqyrtimit analitik të legjislacionit”, të hartuar në kuadër të projektit SANEZ7.

Ky kapitull mbi sektorin e menaxhimit të mbetjeve mbulon kryesisht mbetjet bashkiake dhe direktivat përkatëse: ligji „Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar, VKM „Për ambalazhet dhe mbetjet e ambalazheve” dhe VKM „Për Lendfilllet”, zënë pjesën më të madhe të analizës pasi ka më shumë të dhëna dhe zbatimimi i tyre është në një fazë më të përparuar.

Për më tepër, raporti përfshin gjithashtu kategori të tjera të mbetjeve dhe direktivat përkatëse: “Mbetjet e minierave”, “Automjetet në fund të ciklit të jetës”, “Mbetjet nga



pajisjet elektrike dhe elektronike", "Bateritë", "PCB/PCT", "Lumrat"; megjithatë, për shkak të të dhënave dhe informacionit të kufizuar në dispozicion nga autoritetet qeveritare dhe gjendjen fillestare të zbatimit të direktivave, vlerësimi i këtyre kategorive është më i shkurtër.

Më poshtë është një listë e të gjitha direktivave që duhet të transpozohen në Nënkapitullin - Menaxhimi i Mbetjeve, të Kapitullit 27 <sup>37</sup>- Mjedis dhe Ndryshimi i Klimës:

Direktiva 'për Mbetjet' është direktiva kryesore, e cila vendos kuadrin për të gjithë nënkapitullin, për menaxhimin e mbetjeve.

- Direktiva "Për ambalazhet dhe mbetjet e ambalazheve" <sup>38</sup>
- Direktiva "Për bateritë dhe akumulatorët dhe mbetjet e tyre" <sup>39</sup>
- Direktiva "Për automjetet në fund të ciklit të jetës" <sup>40</sup>
- Direktiva "Për mbetjet e pajisjeve elektrike dhe elektronike" <sup>41</sup>
- Direktiva "Për menaxhimin e mbetjeve nga industritë nxjerrëse" <sup>42</sup>
- Direktiva "Për mbrojtjen e mjedisit nga lumrat e ujërave të zeza" <sup>43</sup>
- Direktiva "Për Lëndfillet" <sup>44</sup>
- Direktiva "Për heqjen e PCB/PCT" <sup>45</sup>

37 2008/98/KE

38 94/62/KE

39 2006/66/KE

40 2000/53/KE

41 2012/19/BE

42 2006/21/KE

43 86/278/EKE

44 1999/31/KE

45 96/59/KE




























Nën-kapitulli /direktiva	Vlerësimi		
	Transpozimi	Kuadri institucional	Zbatimi
<b>Menaxhimi i mbetjeve</b>			
2008/98/KE Kuadri i Mbetjeve			
1999/31/KE Për Lëndëfillet			
94/62/KE Ambalazhet			
2006/21/KE Mbetjet e Minierave			
86/278/EKE Llumrat e Ujërave të Zeza			
2006/66/KE Bateritë			
96/59/KE PCB/PCT			
2000/53/KE Automjetet në fund të ciklit të jetës			
2012/19/KE Mbetjet e pajisjeve elektrike dhe elektronike			

Tabela 3. Vlerësim i shpejtë i Mbetjeve

## 2.3 VLERËSIM I HOLLËSISHËM I NËNKAPITULLIT – PROGRESI I DERITANISHËM

### ••••• **Direktiva Kuadër e Mbetjeve**

#### **Transpozimi**

Direktiva 'për Mbetjet' është direktiva kryesore, e cila vendos kuadrin për të gjithë nënkapitullin, për menaxhimin e mbetjeve. Kjo direktivë përcakton kuadrin ligjor, i cili synon mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut, duke theksuar rëndësinë e menaxhimit të duhur të mbetjeve. Kjo direktivë prezanton disa parime të menaxhimit të mbetjeve, të tilla si 'parimi ndotësi paguan' apo 'përgjegjësia e zgjeruar e prodhuesit', e cila zbatohet për lloje të ndryshme të rymave të mbetjeve. Në të përcaktohet hierarkia e dokumenteve të planifikimit që kanë të bëjnë me menaxhimin e mbetjeve, hierarkia e mbetjeve, teknikat e përpunimit dhe riciklimit për të zvogëluar ndikimin e mbetjeve në ujë, ajër, tokë, florë dhe faunë. Gjithashtu ajo parashikon menaxhimin e sigurt, grumbullimin, ruajtjen dhe trajtimin e mbetjeve të ndërtimit dhe shembjeve, mbetjeve të rrezikshme, mbetjet e vajrave dhe baterive dhe akumulatorëve.

Direktiva 'për Mbetjet' është transpozuar pjesërisht në ligjin "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"<sup>46</sup> i ndryshuar me Ligjin nr. 156, datë 10.10.2013. Ligji synon të mbrojë mjedisin dhe shëndetin e njeriut dhe të sigurojë menaxhimin e duhur mjedisor të mbetjeve përmes parandalimit dhe zvogëllimit të mbetjeve, duke përmirësuar eficiencën e përdorimit të tyre dhe duke ulur ndikimin e përgjithshëm negativ në përdorimin eficient të burimeve.

Kjo direktivë është një nga direktivat më problematike për t'u transpozuar, sepse është e lidhur me nën-direktiva të tjera brenda nënkapitullit të mbetjeve. Menaxhimi i mbetjeve është një fushë me qasje ndërsektoriale, duke përfshirë disa ministri dhe agjenci të pavarura, të cilat ushtrojnë autoritetin e tyre në fushën mjedisore dhe në nënfusha të tjera respektive. Të gjitha detyrimet e raportimit, planifikimi i politikave, strategjitë dhe monitorimi i zbatimit të tyre koordinohen nga MTM-ja, si institucioni drejtues për këtë fushë, ndërsa MIE menaxhon planifikimin dhe zbatimin e investimeve. Një

<sup>46</sup> Nr. 10463, datë 22.9.2011

nga sfidat që vjen nga legjislacioni është zbatimi i tij në tërësi. Mungesa e zbatimit vjen gjithashtu për shkak të mbivendosjes së kompetencave të institucioneve qendrore dhe vendore. Ka edhe raste kur disa detyra nuk janë mbuluar nga asnjë prej institucioneve.

Transpozimi i direktivës kërkon për rishikim të ligjit ekzistues 'Për menaxhimin e integruar të mbetjeve', për të sqaruar dhe forcuar përgjegjësitë si në vija vertikale ashtu edhe horizontale, për të përmendur miratimin dhe forcimin e qasjes së qeverisjes dhe niveleve ndër-sektoriale.

Një version paraprak i Ligjit „Për menaxhimin e integruar të mbetjeve“ i ndryshuar, është aktualisht në fazën e konsultimit. Projektligji i ndryshuar zëvendëson planet rajonale të menaxhimit të mbetjeve me plane zonale të integruara të menaxhimit të mbetjeve dhe shqyrton procedurat e miratimit dhe raportimit për planet zonale dhe vendore të menaxhimit të mbetjeve. Sipas këtij projektligji, planet vendore të menaxhimit të mbetjeve do të hyjnë në fuqi vetëm pas miratimit nga këshilli bashkiak dhe siç nënshkruhet nga MTM-ja, ndërsa MIE dhe MTM duhet të harmonizojnë veprimet e tyre në lidhje me planifikimin dhe investimet në nivelin zonal, dhe bashkitë të raportojnë çdo vit si tek MTM-ja ashtu edhe tek MIE-ja.

Çështje të tjera të rëndësishme që nevojiten për të siguruar zbatimin e plotë të kësaj direktive, lidhen me zbatimin e hierarkisë së mbetjeve nëpërmjet përditësimit dhe përmirësimeve të legjislacionit, për të ofruar dhe lehtësuar zgjidhje praktike, të cilat çojnë drejt përputhshmërisë me synimet strategjike të ripërdorimit, zvogëlimit dhe riciklimit, siç përcaktohet në Dokumentin e Politikave Strategjike dhe në këtë direktivë. Tre synimet kryesore të Dokumentit të Politikave Strategjike kërkojnë zbatimin e parimit 'ndotësi paguan', parimin e 'përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit' dhe raportimin e të dhënave. Arritja e këtyre synimeve duhet të mbështetet nga akte nënligjore dhe rregullore të reja dhe të përditësuara, mungesa e të cilave pengon zgjidhjet praktike dhe të zbatueshme.

## **Kuadri institucional**

Përgjegjësitë për menaxhimin e mbetjeve të ngurta në Shqipëri janë të ndara midis niveleve kombëtare, rajonale dhe vendore. Ligji „Për menaxhimin e integruar të mbetjeve“ është kuadri ligjor kryesor që përcakton përgjegjësitë institucionale në fushën e menaxhimit të mbetjeve për organet e qeverisjes qendrore, përfshirë Ministrinë e

Turizmit dhe Mjedisit (MTM) dhe agjencitë në varësi të saj si Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM); dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE). Detyra specifike u janë caktuar këtyre ministrive përmes Vendimeve të veçanta të Këshillit të Ministrave (VKM), ku mund të përmendim VKM-në më të fundit që i cakton një rol specifik për menaxhimin e mbetjeve Agjencisë Kombëtare të Ujësjellësit dhe Mbetjeve (AKUM), një agjenci në varësi të MIE.

Në nivelin vendor, përgjegjësitë janë të ndara midis Këshillave Rajonale (KR) dhe Bashkive. Funkzioni i KR-ve është të hartojnë dhe zbatojnë politikat rajonale dhe t'i harmonizojë ato me politikat kombëtare. Sipas ligjit aktual „Për menaxhimin e integruar të mbeturinave”, KR-të hartojnë dhe miratojnë planet rajonale për menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe raportojnë çdo vit në MTM për zbatimin e tyre.

Ligji „Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” nuk është shumë specifik në lidhje me përgjegjësitë e Bashkive në lidhje me menaxhimin e mbetjeve, megjithëse ligji „Për vetëqeverisjen lokale”<sup>47</sup> e përcakton menaxhimin e mbetjeve të ngurta bashkiake si një funksion të Bashkive. Sipas këtij përkufizimi, bashkitë kanë të drejtën dhe përgjegjësinë për të menaxhuar ofrimin e shërbimeve në një mënyrë që i përshtatet më së miri kushteve të tyre specifike dhe për të bashkëpunuar me bashki të tjera në vendosjen e tarifave të shërbimeve dhe një mekanizëm të grumbullimit të të ardhurave, ndërtimin dhe administrimin e impianteve të trajtimit të mbetjeve. Në praktikë, bashkitë ende i referohen Ligjit “Për largimin publik të mbetjeve”<sup>48</sup>, në lidhje me kontraktimin e palëve të treta për grumbullimin, transportimin dhe trajtimin e mbetjeve, ku standardet moderne mbeten për t'u zbatuar nga të gjitha bashkitë.

## Sfidat e zbatimit

Këto përgjegjësi funksionale janë nën rishikim brenda politikave kryesore që janë përcaktuar në kuadrin e Dokumentit të Politikave Strategjike dhe ndryshimeve të propozuara për Ligjin „Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”.

Ndryshimet dhe përmirësimet kryesore të kuadrit ligjor duhet të sigurojnë që një hierarki e planifikimit linear dhe e harmonizuar të fillojë me Planin Sektorial (1) të aprovuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT). Planet për Zonat e Menaxhimit

47 139/2015

48 Nr. 8094, date 21.03.1996



të Mbetjeve (10, ZMM) gjithashtu të aprovuara nga KKT, dhe Planet Bashkiake të Menaxhimit të Mbetjeve (61) siç janë miratuar nga këshillat bashkiakë; të gjitha të ndërlidhura, harmonizuara dhe transpozuar me Objektivat Strategjike, siç përcaktohet në Dokumentin e Politikave Strategjike dhe Planin Sektorial.

Parimi kryesor i menaxhimit të mbetjeve në Shqipëri, „hierarkia e mbetjeve”, është në përputhje me parimet e përcaktuara në Direktivën Kuadër Evropiane të Mbetjeve. Ky parim synon të rendisë opsionet e menaxhimit të mbetjeve sipas asaj që është më e mira për mjedisin, dhe për kalimin në një ekonomi qarkulluese, në mënyrë që të ulët sasia e mbetjeve për depozitim ose për t'u djegur.



**Figura 1**  
Hierarkia e mbetjeve,  
(tëri 3. Direktiva Kuadër  
2008/98 e KKT-së).

Shqipëria ende është mbrapa në zbatimin e kësaj hierarkie. Midis shumë parimeve, ato kryesoret ku vlen të përqendrohemi, në të dy modelet, ligjore, rregullatore dhe praktike për zbatimin nënkuptojnë parimet e „Ndotësi paguan”, „Përgjegjësi e zgjeruar e prodhuesit” dhe „Ndarja në Burim dhe grumbullimi i diferencuar”.

Dokumenti i Politikës Strategjike është dokumenti kryesor i planifikimit, i cili rregullon menaxhimin e mbetjeve bashkiakë, jo-bashkiakë dhe ato bashkiakë të rrezikshme. Dokumenti aktual është versioni i përditësuar i dokumentit i hartuar për herë të parë në vitin 2010.

**Dokumenti i Politikës Strategjike** merr në konsideratë zhvillimet e planifikimit dhe infrastrukturës në sektorin e mbetjeve, si në nivelin e qeverisjes qendrore dhe vendore, përfshirjen e konsiderueshme të biznesit privat dhe investime të shumta të ndërmarra në nivelin e grumbullimit, transferimit dhe veçanërisht trajtimit të mbetjeve. Dokumenti i rishikuar i Politikave Strategjike është zhvilluar mbi vizionin ose parimin e konceptit

„zero mbetje”, në mënyrë që mbetjet të grumbullohen dhe trajtohen si lëndë e parë dhe menaxhimi të bëhet në përputhje me konceptin dhe parimet e sistemit të ekonomisë qarkulluese. Qëllimi kryesor i Dokumentit të Politikave Strategjike është të sigurojë udhëzime strategjike. Objektivat specifike të Dokumentit të Politikave Strategjike kanë si qëllim të ofrojnë zgjidhje praktike për:

- Adresimin e problemeve të sistemit të menaxhimit.
- Zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi.
- Përbushjen e detyrimeve specifike të legjislacionit të BE-së për menaxhimin e mbetjeve, përfshirë objektivat ambiciozë të Paketës së ekonomisë qarkulluese.

Arritja e këtyre objektivave përmirëson cilësinë e mjedisit dhe shëndetin e qytetarëve, duke i dhënë një shtysë tjetër zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit, si dhe duke hapur rrugën drejt integrimit evropian.

Dokumenti i Politikave Strategjike, i cili është niveli më i lartë i planifikimit në fushën e menaxhimit të mbetjeve, është një dokument veprimi për të ardhmen, ku bazohen strategjitë dhe planet, dhe rregullohen ndërveprimet dhe burimet. Ky dokument është në përdorim për: politikëbërësit, për të drejtuar procesin e tyre të vendimmarrjes në lidhje me menaxhimin e mirë të mbetjeve; përcakton objektiva të vërtetë strategjike dhe synime të arritshme që synojnë të arrijnë nivelet e përcaktuara nga direktiva e BE-së në drejtim të planifikimit horizontal.

Sidoqoftë, arritja e objektivave strategjike varet fuqimisht nga zbatimi dhe monitorimi vjetor i planit të veprimit dhe alokimi i burimeve siç përcaktohet në Masterplanin kombëtar.

**Plani Sektorial** përfaqëson dokumentin e nivelit të dytë të planifikimit për menaxhimin e mbetjeve, i cili përcakton kuadrin e planifikimit në lidhje me investimet kombëtare dhe rajonale të infrastrukturës, zgjedhja e vendeve për vendosjen e infrastrukturës dhe alokimi i investimeve për infrastrukturën përkatëse.

Ky dokument ndan vendin, për qëllimet e menaxhimit të mbetjeve, në **“10 zona të menaxhimit të mbetjeve”**, të cilat marrin parasysh infrastrukturën aktuale të menaxhimit të mbetjeve, tipologjinë e terrenit, afërsinë dhe përballimin e kostos nga bashkitë. Ky dokument u shërben autoriteteve përgjegjëse për të identifikuar dhe përcaktuar metodologjinë dhe teknologjinë për investimet e ardhshme në trajtimin e mbetjeve, duke përfshirë pajisjet për grumbullimin e mbetjeve, kompostimin,

riciklimin, djegien për gjenerimin e energjisë dhe bazën e depozitimit; gjithashtu shërben si bazë për planifikimin në nivelin e zonave të menaxhimit të mbetjeve, deri në nivelin e planeve bashkiake.

Me mbështetjen e BE-së përmes fondeve IPA, aktualisht janë hartuar 3 nga 10 Planet për Zonat e Menaxhimit të Mbetjeve të Kukësit, Gjirokastrës dhe Vlorës, të shoqëruara me Studimet e Fizibilitetit. Nga ana tjetër, Plani për ZMM e Korçës është hartuar me mbështetjen e KfW-së dhe është në proces hartimi Plani rajonal për ZMM-në e Beratit. Teksa, Plani i ZMM-së së Korçës është aprovuar dhe funksional, tre dokumentet e tjera janë në pritje të miratimit nga autoriteti kompetent. Nga ana tjetër, përmes mbështetjes së Qeverisë Zvicerane, rreth 14 bashki kanë hartuar dhe aprovuar Planet e tyre Vendore të Menaxhimit të Mbetjeve (Planet Vendore).

E gjithë hierarkia e planifikimit në menaxhimin e mbetjeve varet nga sa shpejt planet për 10 ZMM-të do të përgatiten dhe miratohen nga autoritetet përgjegjëse, dhe ky është një moment kyç për të matur përpjekjet dhe suksesin e Shqipërisë për të përballuar kërkesat dhe synimet e transpozimit të legjislacionit dhe zbatimi i direktivës.

Aktualisht **hierarkia e mbetjeve** nuk zbatohet në Shqipëri. Shumica e bashkive në vend nuk kanë Plane Vendore. Pavarësisht disa tentativave, vendosja e një sistemi eficient të ndarjes në burim dhe grumbullimit të diferencuar të mbetjeve të ngurta bashkiake, ka pasur mangësi; nuk është arritur të sigurohet një sistem i rregulluar dhe ndërtuar mirë, që të kombinojë dhe ndërlihtë fuqishëm infrastrukturën - pajisjet - sistemin e grumbullimit - kapacitetet njerëzore - rregulloret kontraktuale - destinacionin përfundimtar - ndërgjegjësimin dhe edukimin.

Grumbullimi i mbetjeve të riciklueshme mbetet joformal, zakonisht kryhet nga mbledhësit joformalë të mbetjeve dhe dorëzohen direkt në bizneset përkatëse të përpunimit të riciklimit.

Për këtë arsye, kur projektojmë zvogëlimin e mbetjeve përmes riciklimit dhe kompostimit, ne do të mbajmë referencë objektivat e përcaktuara në Dokumentin e Politikave Strategjike, siç tregohet në Tabelën 1 më lart.

Shërbimi nga bashkitë ofrohet përmes operatorëve privatë të licencuar nga MTM ose nga sektorët e shërbimeve brenda organikës së bashkive. Operatorët privatë në shumicën e rasteve nënshkruajnë një kontratë me bashkitë për grumbullimin,

transportin dhe asgjësimin e mbetjeve me një kohëzgjatje prej 5 vitesh.

VITI	POPULLSIA	POPULLSIA ME SHËRBIM TË OFRUAR	SHKALLA E MBULIMIT TË SHËRBIMIT (%)
2018	2.866.375	1.882.919	65,7
2019	2.854.191	2.508.834	87,9

Tabela 4: Shkalla e mbulimit të popullsisë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve të ngurta

Sipas të dhënave nga Instituti i Statistikave (INSTAT) për vitin 2019, shërbimi është ofruar për 87,9% të popullsisë për një popullsi totale prej 2.854.191 banorësh, ndërsa në vitin 2018 shërbimi është ofruar vetëm për 65,7% të popullsisë për një popullsi totale prej 2.866.537 banorësh.

VITI	ZMM TOTAL TË MENAXHUARA	MBETJE TË TJERA	ZMM
VITI	Ton/vit	Kg/banorë/vit	KG/CAP/YEAR
2018	1.325.071	462	383
2019	1.086.692	381	331

Tabela 5: ZMM-të e gjeneruara dhe të menaxhuara, 2018 - 2019

Në vitin 2019, u mbledhën 1.086.692 tonë mbetje, ndërsa në vitin 2018 për një mbulim më të ulët, u mbledhën 1.325.071 ton mbetje. Këto shifra tregojnë se shkalla e gjenerimit për banorët u ul nga 1,2 kg/person/ditë në 1,04 kg/person/ditë. Pavarësisht dyshimeve për saktësinë e tyre, këto shifra, tregojnë se ka një sasi të konsiderueshme mbetjesh, të cilat përfundojnë, të pakontrolluara në mjedis, kryesisht përgjatë rrugëve, vijave të ujit dhe lumenjve.

Bashkitë nuk kanë të vendosur një sistem për grumbullimin e mbetjeve në 4 rryma: letër / karton; metale; plastikë dhe qelq; ashtu siç parashikohet nga ligji. Nga ana tjetër, infrastruktura e grumbullimit është e dobët, pasi numri i kontejnerëve shpesh është i pamjaftueshëm për të përmbushur nevojat e banorëve. Pajisjet e grumbullimit, kontejnerët dhe kamionët, në shumicën e rasteve nuk janë në përputhje me standardet dhe kanë nevojë për mirëmbajtje të vazhdueshme, gjë që çon në ofrimin e një shërbimi joeficient.

Megjithëse financimi i qeverisë vendore rritet çdo vit, veçanërisht pas reformës territoriale dhe administrative (RTA), niveli mesatar i mbledhjes së të ardhurave



nga tarifa e shërbimit është regjistruar në rreth 63%. Bazuar në këtë normë dhe tarifën mesatare të shërbimit prej 1.544 lekë/familje/vit, bashkitë arrijnë të mbulojnë vetëm një mesatare prej 34% të kostos operative dhe të mirëmbajtjes<sup>49</sup>. Duke supozuar një normë grumbullimi prej 90%, bashkitë duhet të rrisin tarifën e shërbimit me një mesatare prej 86%, nga 1.544 lekë/familje/vit në një mesatare prej 2.850 lekë/familje/vit për të mbuluar koston operative dhe të mirëmbajtjes, grumbullimit dhe transportin për standardin aktual të ofrimit të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve.

Çdo zgjerim dhe përmirësim i shërbimit në të ardhmen, duke përfshirë ndarjen në burim dhe trajtimin e avancuar për të nxitur zvogëlimin e mbetjeve, do të ketë nevojë për rritjen e tarifave për shërbimin në popullatë; kjo është gjithashtu një sfidë për t'u përballuar, jo vetëm për bashkitë, por edhe për qeverinë qendrore.

Bashkitë janë të detyruara të raportojnë çdo vit, në Këshillat Rajonale dhe AKM, të dhëna në lidhje me sasinë e mbetjeve dhe llojet e mbetjeve të gjeneruara në territorin e tyre, të cilat AKM-ja i përdor për të prodhuar raporte statistikore në lidhje me grumbullimin, aktivitetet e riciklimit dhe sasinë e mbetjeve të depozituara. I njëjti format raportimi u dërgohet bashkive nga AKM-ja dhe INSTAT-i. Në këtë pikë, kapacitetet e bashkive për të raportuar, sipas standardit të kërkuar, duhet të forcohen më tej nga pikëpamja metodologjike dhe zgjidhjet praktike.

**Menaxhimi i mbetjeve spitalore** është përmirësuar me kalimin e viteve dhe aktualisht këto lloj mbetjesh trajtohen në një mënyrë më të strukturuar. Ka disa kompani të licencuara që kryejnë menaxhimin e mbetjeve spitalore, dhe çdo subjekt si spitalet, klinikat e vogla, ambulancat, klinikat dentare, etj. duhet të lidhin një kontratë me operatorë të licencuar që merren me menaxhimin e mbetjeve spitalore. Të dhënat nga INSTAT tregojnë se për vitin 2019, **11.953 tonë**<sup>50</sup> mbetje spitalore u grumbulluan dhe asgjësuan në mënyrë të sigurt, të cilat përbëjnë 1,1% të sasisë totale prej 1.086.692 tonë të mbetjeve të menaxhuara. Kjo përqindje ka ndryshuar ndjeshëm nga 2013 - 2019 siç raportohet nga INSTAT-i, prandaj, nuk mund të identifikohet ndonjë trend i qartë. Pavarësisht progresit në këtë sektor, mbetet shumë për të bërë në lidhje me vlerësimin e sasisë totale të mbetjeve të gjeneruara në të gjithë vendin dhe sa trajtohen siç parashikohet nga ligji. Shpesh sasia e mbetjeve të krijuara nuk përputhet me sasinë e trajtuara dhe ka pasur raste të identifikuara nga shoqëria civile dhe media, kur

49 Referenca e bërit me vitin 2016, të dhënat siç raportohen në Dokumentin e Politikave Strategjike dhe Planin Kom-bëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, 2020 - 2035.

50 Përqindja e mbetjeve spitalore të menaxhuara në lidhje me mbetjet totale të menaxhuara, 1,1% e mbetjeve spi-talore të menaxhuara nga një total prej 1,086,692



këto mbetje depozitohen në vende të paautorizuara duke u kthyer në një rrezik për shëndetin e njerëzve dhe mjedisin.

**Menaxhimi i vajrave të përdorura**, që nga miratimi i VKM-së „Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura”<sup>51</sup> është përmirësuar, por nevojitet më shumë për të arritur synime më të mira të grumbullimit, riciklimit dhe trajtimit. Të dhënat nga raporti mjedisor i vitit 2019, i përgatitur nga AKM, tregojnë se janë marrë për trajtim 1.057.498 kg vajra të përdorur. Dokumenti i Politikave Strategjike sugjeron se sasia e vajit të prodhuar në nivelin e brendshëm është rreth 1,5 deri 3,9 milion litra në vit, ndërsa nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, sasia e vajrave lubrifikantë të importuar në vendin tonë për vitin 2019 është 889.420.611<sup>52</sup> litra. Janë rreth 15 kompani në vend që kanë licencë për të operuar në fushën e grumbullimit, transportit, trajtimit të ruajtjes dhe riciklimit të vajrave. Të dhënat sugjerojnë se ka një sasi të madhe vajrash të përdorur të depozituar në ambientet ku prodhohet ose janë hedhur në mënyrë të paligjshme në mjedis.

Një ndër gjërat që duhen rregulluar është edhe përmirësimi i saktësisë së të dhënave për sasinë e vajrave të përdorur, sasinë e atyre që trajtohen, ku dhe nga kush, si dhe çfarë ndodh me sasinë e patrajtuar. Për të menaxhuar siç duhet këtë rrjedhë mbetjesh, zbatimi i ligjit dhe rregullorevë duhet të forcohet për të siguruar kontroll të plotë të territorit.

### **Saktësia e të dhënave dhe raportimi**

Një nga problemet kryesore me të dhënat për mbetjet lidhet pjesërisht me numrin e popullsisë që përdoret kur hartohen planet vendore të menaxhimit të mbetjeve. Siç dihet gjerësisht, numri i popullsisë është një nga faktorët kryesorë për të përcaktuar saktësisht sasinë e mbetjeve të gjeneruara, për sektorin e menaxhimit të mbetjeve. Shqipëria ka tre burime kryesore të popullsisë për secilën bashki, të cilat janë INSTAT (Censuri 2011), Regjistri i Gjendjes Civile dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE), që përdor një formulë për të llogaritur popullsinë për transfertat vjetore në njësitë e qeverisjes vendore, që përfaqëson një përpjekje për të afruar ndryshimet midis INSTAT dhe Regjistrit të Gjendjes Civile. Të tre burimet ofrojnë shifra të ndryshme të popullsisë, duke krijuar ide për të dhëna të paqëndrueshme; për të ilustruar këtë

<sup>51</sup> 765 nga 07.11.2012.

<sup>52</sup> Dokumenti Strategjik dhe Plan Kompletar i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, 2020 - 2035.

aspekt, ne do të përmendim faktin se për të njëjtën temë, teksa Dokumenti i Politikave Strategjike referohet me të dhënat e INSTAT-it, Plani Sektorial me të dhënat e MFE-së, duke vendosur kështu dy baza të ndryshme për analizën dhe vlerësimin e nevojave të të njëjtit sektor. Ky është një aspekt thelbësor për t'u adresuar nga autoritetet kompetente për të unifikuar burimin e të dhënave të popullsisë së paku në lidhje me sektorin e mbetjeve, në mënyrë që të përdoret një bazë e njëzuar për llogaritjen dhe vlerësimin e nevojës për investime për sektorin.

Nga ana tjetër, çështjet e raportimit të të dhënave kanë të bëjnë me treguesit e raportuar nga bashkitë, pasi shumica e tyre nuk kryejnë ndarjen e mbetjeve në burim dhe për këtë arsye nuk mund të raportojnë në detaje sasinë e mbetjeve të gjeneruara sipas rrymave përkatëse. Për më tepër, mungesa e infrastrukturës në vend depozitimet josanitare nuk lejojnë gjithmonë peshimin e mbetjeve që depozitohen në to. Në këto kushte, bashkitë raportojnë bazuar në llogaritjet e bëra nga planet vendore të menaxhimit të mbetjeve, për ato bashki që kanë një plan, ose në vlerësimet e bëra nga drejtoritë e shërbimit publik në bashki.

Kjo mënyrë e raportimit sjell shumë konfuzion në lidhje me numrin e popullsisë së mbuluar nga shërbimi, sasinë e mbetjeve të gjeneruara, ricikluara, të depozituara në mënyrë të sigurt dhe ato të hedhura në mjedis, duke dalë në përfundimin se statistikave të sektorit të mbetjeve janë të pasigurta (dhe metodologjitë e mbledhjes së të dhënave kanë nevojë për përmirësim dhe harmonizim).

## ..... Direktiva për Lendfillet

### Transpozimi

Direktiva "Për Lendfillet" siguron masat, procedurat dhe udhëzimet për të parandaluar dhe zvogëluar efektet e mundshme negative në mjedis nga venddepozitimi i mbetjeve. Kjo direktivë përcakton kriteret dhe llojet e mbetjeve që pranojnë të depozitohen në mënyrë që të depozitohet secila rrymë e mbetjeve në mënyrën e duhur.

Kjo Direktivë është transpozuar në VKM „Për lendfillet e mbetjeve“<sup>55</sup>. Transpozimi i akteve ligjore është në një fazë të mirë, por zbatimi është ende në fazën fillestare, kryesisht për shkak të kostove të larta financiare për ndërtimin e venddepozitimeve të mbetjeve dhe objektet e magazinimit të përkohshëm. Plani Sektorial e ndan Shqipërinë

në 10 zona të mbetjeve dhe përcakton infrastrukturën e nevojshme për ruajtjen e përkohshme dhe asgjësimin përfundimtar të sigurt të mbetjeve.

Shqipëria ka transpozuar gjithashtu direktivën „Për djegien e mbetjeve”<sup>54</sup> e cila është transpozuar në VKM-në „Për djegien e mbetjeve”<sup>55</sup>, pas miratimit të VKM-së së përmendur, dhe tre inceneratorë janë projektuar, nga të cilët njëri është funksional (Elbasan) dhe dy prej tyre janë nën ndërtim (Fier dhe Tiranë).

Ne jemi të mendimit se Shqipëria duhet t'i përmbahet në mënyrë rigorozë zbatimit të hierarkisë së mbetjeve siç e përcakton Direktiva e BE-së për Mbetjet. Nëse do të shikojmë sektorin nga ky këndvështrim, ne jemi të mendimit se kapaciteti i projektuar i tre inceneratorëve (Elbasani tashmë i ndërtuar me kapacitet 140 tonë/ditë, ai i Fierit, me kapacitet 240 tonë/ditë dhe Tirana me kapacitetin fillestar prej rreth 920 tonë/ ditë) arrin në rreth 1.310 tonë/ditë, sasi e cila vlerësohet shumë më e lartë se ajo e mbetjeve të djegshme të gjeneruara në secilin zonë përkatëse të mbetjeve që mbulojnë këto subjekte; prandaj kapaciteti i tyre i projektuar është i paplotësuar.

Në këto kushte, rekomandohet që qeveria të rishikojë kapacitetet e projektuara të inceneratorëve, të cilat nuk kanë filluar të ndërtohen dhe të adaptojë ato në funksion dhe mbështetje të zbatimit të politikave të BE-së dhe objektivave për zvogëlimin e mbetjeve, siç përcaktohet në Dokumentin e Politikave Strategjike.

### **Kuadri institucional**

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), së bashku me MTM-në ka rolin kryesor në planifikimin e infrastrukturës për menaxhimin e mbetjeve. Ministria e ushtron veprimtarinë e saj në:

1. pjesën e mbetjeve urbane që lidhen me planifikimin e territorit dhe infrastrukturën e mbetjeve;
2. Koordinimin e politikave për infrastrukturën e mbetjeve urbane në lidhje me hartimin, monitorimin dhe zbatimin e tyre. Përgjegjësi të tjera të kësaj ministrie janë edhe drejtimi, menaxhimi, mbikëqyrja dhe përcaktimi i standardeve teknike të infrastrukturës së vendeve të hedhjes së mbetjeve.

Organi ekzekutiv në këtë fushë është Agjencia Kombëtare e Ujësllës Kanalizimeve

<sup>54</sup> Direktiva 2000/76/E e datës 4 Dhjetor 2000

<sup>55</sup> Nr. 178, datë 06 Mars 2012

dhe Infrastrukturës së Mbetjeve - AKUM<sup>56</sup> përgjegjësia e së cilës në fushën e mbetjeve urbane ka të bëjë me planifikimin e territorit dhe infrastrukturën e mbetjeve, sipas zonës së përgjegjësisë të MIE-së.

Në MIE, ka vetëm një person përgjegjës për të ndjekur planifikimin e mbetjeve dhe AKUM ende nuk ka asnjë person përgjegjës vetëm për menaxhimin e mbetjeve. Burimet aktuale njerëzore të alokuara nga këto institucione për të menaxhuar përgjegjësitë e tyre në menaxhimin e mbetjeve, janë mjaft të kufizuara, pavarësisht nga nevoja për forcimin e mëtejshëm të njohurive teknike dhe ekspozimit të tyre ndaj praktikave të suksesshme në BE dhe vendet në rajon; dhe së bashku me ndarjen e parregulluar të përgjegjësisë dhe bashkërendimin mjaft të vështirë me MTM-në dhe bashkitë, të gjitha së bashku përbëjnë boshllëqet kryesore për sa i përket kuadrit institucional dhe organizimit. Nevojitet një organizim i mirë dhe alokim i mjaftueshëm i burimeve në të dy ministritë, me qëllim të përsheptimit të punës dhe zhvillimit të sektorit pas fazave të zbatimit, siç përcaktohet në Dokumentin e Politikave Strategjike dhe Planin Sektorial; teksa të dy dokumentet duhet të shihen dhe konsiderohen si një politikë qeveritare dhe një plan zbatimi, dhe jo si dy dokumente që i përkasin veçmas përgjegjësisë të secilës prej ministrive.

## Zbatimi

Kuadri ligjor për menaxhimin e integruar të mbetjeve klasifikon lëndfillet në 3

- a. lëndfille për mbetjet e rrezikshme;
- b. lëndfille për mbetjet jo të rrezikshme;
- c. lëndfillet e mbetjeve inerte.

Lëndfillet duhet të ndërtohen duke marrë parasysh konceptin e zonave / rajoneve të mbetjeve të përcaktuara në Dokumentin e Politikave Strategjike, ato gjithashtu duhet të pajisen me një Leje Mjedisi siç kërkohet nga ligji.

VKM-ja mbi Lëndfillet përcakton të gjitha kriteret teknike të nevojshme për ndërtimin e një lëndfilli, si dhe procedurat që duhet të ndiqen nga operatori i lëndfillit, të cilat lidhen me raportimin e sasisë së mbetjeve, llojin e mbetjeve të depozituara, kapjen e gazit metan, etj.

<sup>56</sup> VENDIM Nr. 431, datë 11.7.2018 PËR KRUIJMIN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË KOMBETARE TË UJËSIJELLËS-KANALIZIMEVE DHE INFRASTRUKTURËS SË MBETJEVE



Aktualisht në Shqipëri, ekzistojnë 4 lëndfille sanitare për mbetjet jo të rrezikshme:

- Bushati, në të cilin parashikohet të depozitohen mbetjet bashkitë e rajonit të Shkodrës dhe të Lezhës; deri më tani vetëm disa nga bashkitë depozitojnë mbetjet e tyre në këtë lëndfill. Që disa nga bashkitë e tjera të mund të depozitohen mbetjet e tyre në Bushat, kërkohet ndërtimi i objekteve të tilla si stacionet e transferimit, pavarësisht faktit se standardet e trajtimit, veçanërisht rrjedhjet dhe kontrolli i shkarkimit të gazeve duhet të përmbushet nga operatori dhe të monitorohet nga AKM-ja dhe autoritetet e tjera kompetente;
- Sharra, në të cilën depozitohen mbetjet Bashkia e Tiranës dhe së fundmi bashkia e Durrësit. Lëndfilli i Sharrës dhe inceneratori përcaktohen si një pikë përfundimtare dhe një objekt i trajtimit përfundimtar për asgjësimin e mbetjeve nga të gjitha bashkitë në zonën e mbetjeve të Tiranës, duke përfshirë Durrësin, Kamzën dhe bashkitë e tjera të zonës së grumbullimit;
- Maliqi, në të cilin depozitohen mbetjet 5 nga 6 bashkitë e rajonit të Korçës; dy stacione transferimi janë duke u ndërtuar dhe janë funksionale për të lehtësuar transportimin e mbetjeve nga bashkitë Pogradec dhe Kolonjë.
- Bajkaj, ku depozitohen mbetjet e 5 bashkive të nënzonës së Vlorës Jugore. Lëndfilli përcaktohet si pika dhe impianti përfundimtar i trajtimit të mbetjeve edhe për rajonin e Gjirokastrës. Në mënyrë që kjo të ndodhë, infrastruktura të tjera, të paktën tre stacione transferimi dhe një impiant për trajtimin e mbetjeve duhet të ndërtohen për t'i shërbyer bashkive të rajonit të Gjirokastrës.

Ndërkohë që impiantet e ndërtuara për asgjësimin e sigurt të mbetjeve nuk mbulojnë të gjithë territorin, të dhënat nga MTM-ja dhe Dokumenti i Politikave Strategjike tregojnë se aktualisht ekzistojnë 199 lëndfille të ligjshme funksionale në Shqipëri. Disa nga këto lëndfille të ligjshme përdoren nga bashkitë për të hedhur mbetjet e tyre, sepse nuk kanë infrastrukturën e nevojshme për asgjësimin e tyre të sigurt, por edhe në ato raste kur ata kanë një lëndfill ose incenerator në territorin e rajonit të tyre, ata nuk kanë kapacitetet financiare për kalimin e mbetjeve në këto impiante.

Identifikimi i këtyre zonave të hedhjes së mbetjeve shoqërohet me një vlerësim paraprak të kostos për mbylljen ose rehabilitimin e tyre; megjithëse as qeveria, as bashkitë nuk kanë ende një plan dhe një buxhet të destinuar për të adresuar këtë situatë, e cila është mjaft kritike nga pikëpamja mjedisore.



Në këtë fazë, lëndfilllet për mbetjet e rrezikshme ose lëndfilllet për asgjësimin e mbetjeve inerte nuk janë ndërtuar akoma, gjë që sugjeron se pjesa më e madhe e mbetjeve trajtohet nga operatorë të licencuar në fusha përkatëse ose përfundon e pakontrolluar në mjedis.

## ..... **Direktiva e Ambalazheve dhe Mbetjeve të Ambalazheve**

### **Transpozimi**

Direktiva 94/62/KE mbi „Ambalazhet dhe Mbetjet e Ambalazheve“ ofron udhëzime për konceptet e përmendura në ligjin për menaxhimin e integruar të mbetjeve; ai rregullon përgjegjësinë e prodhuesve për materialin e ambalazhit të të gjitha llojeve dhe mbetjet e ambalazhit të të gjitha llojeve, të përdorura dhe të depozituara nga familjet, bujqësia, industria dhe aktivitetet e tjera tregtare. Kjo direktivë është e transpozuar pjesërisht me VKM nr. 177, datë 6.3.2012 „Për ambalazhet dhe mbetjet e ambalazheve“ i ndryshuar me VKM 232 datë 26.04.2018.

Transpozimi i kësaj direktive është në fazë të mirë, por zbatimimi mungon për shkak të faktit se zbatimimi i kësaj direktive është i lidhur me zbatimin e skemave të Përgjegjësisë të Zgjerruara të Prodhuesit (PZP). Shteti nuk ka qenë në gjendje të zhvillojë një skemë thelbësore dhe të qëndrueshme të PZP-së, prandaj zbatimimi i legjislacionit dhe për pasojë plotësimi i kërkesave të direktivës kanë mbetur prapa. Autoritetet kombëtare duhet të bashkëpunojnë me prodhuesit dhe kompanitë e shitjes me pakicë në mënyrë që të krijojnë skema PZP që përshtaten më mirë me kontekstin e vendit.

### **Kuadri institucional**

MTM është autoriteti kryesor përgjegjës për zbatimin e kësaj direktive. Agjencia Kombëtare e Mjedisit është organi ekzekutiv i MTM-së, i cili ushtron aktivitetin e tij në të gjithë vendin dhe është përgjegjës për sigurimin e performancës mjedisore, monitorimin e zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore dhe mbledhjen e të dhënave për menaxhimin e mbetjeve për të gjitha rrymat e mbetjeve. MTM-ja ka vetëm dy persona që mbikëqyrin procesin e transpozimit, zbatimit të politikave dhe planifikimit. Ndërsa në AKM, nuk ka asnjë staf të drejtpërdrejtë të përfshirë për monitorimin dhe zbatimin e kësaj direktive.

Pavarësisht nivelit të njohurive dhe përvojave, burimet e pamjaftueshme të alokuara si në Ministri ashtu edhe në AKM, nuk i lejojnë ata të ushtrojnë plotësisht detyrat dhe përgjegjësitë e tyre; në këtë mënyrë paraqitet një boshllëk i madh për tu plotësuar, duke pasur parasysh faktin se menaxhimi i mbetjeve përcaktohet si një nga sektorët kryesorë strategjikë për vendin.

Nga ana tjetër, bashkitë gjithashtu kanë një rol të rëndësishëm në zbatimin e kësaj direktive në lidhje me ndarjen në burim të mbetjeve të ambalazhit, por meqenëse hierarkia e mbetjeve nuk zbatohet dhe nuk ka mbledhje të diferencuar të mbetjeve, roli i tyre nuk është efektiv.

Kuptimi i rolit dhe përgjegjësisë së bashkive nga pikëpamja e qeverisë qendrore është një çështje parimore; të gjitha institucionet në nivel qendror, duke përfshirë edhe organizatat ndërkombëtare të donatorëve, duhet të unifikojnë qëndrimin e tyre, duke pasur të njëjtin kuptim për rolin e bashkive siç përcaktohet në ligjin „Për vetëqeverisjen lokale“ në Shqipëri. Mungesa e këtij kuptimi do të përbëjë një pengesë të vazhdueshme për të dy nivelet e qeverisjes, për një bashkëpunim efektiv dhe harmonizim të ndërhyrjeve dhe shpërndarjes së burimeve drejtpërdrejt me objektivat e përcaktuara në Dokumentin e Politikave Strategjike dhe Master Planin.

## Zbatimi

Qëllimi i VKM-së Nr.177/2012 është mbrojtja, ruajtja dhe përmirësimi i cilësisë së mjedisit dhe shëndetit të njeriut duke zvogëluar ndikimet negative të ambalazheve dhe mbetjeve të tyre. Kjo VKM synon të parandalojë gjenerimin e mbetjeve nga ambalazhet, të promovojë grumbullimin e diferencuar të mbetjeve dhe të nxisë ripërdorimin, riciklimin dhe rikuperimin për mbetjet e ambalazheve të të gjitha llojeve në mënyrë që të ulë sa më shumë sasinë e mbetjeve të ambalazheve të depozituara në lëndfille, në fund të këtyre proceseve.

Prodhuesit e materialeve të ambalazheve përgatisin programe të tyre për parandalimin bazuar në programet rajonale dhe kombëtare të parandalimit të mbetjeve. Këto programe miratohen dhe monitorohen nga AKM-ja.

Nën përgjegjësinë e prodhuesit, prodhuesi i ambalazhit dhe mallrave të ambalazhuara marrin masa për të financuar të gjitha kostot që vijnë nga krijimi i sistemeve të kthimit dhe rikuperimit të mbetjeve, individualisht ose në bashkëpunim midis tyre. Ata marrin

masa për të ruajtur cilësinë e mbetjeve të ambalazhit për ripërdorim dhe riciklim, duke siguruar transportin e duhur të diferencuar. Ata peshojnë dhe regjistrojnë të gjitha të dhënat mbi mbetjet e ambalazhit dhe raportojnë çdo vit tek autoritetet e qeverisjes vendore.

Nën përgjegjësinë e prodhuesit, prodhuesit e ambalazheve të zinxhirit të plotë të prodhimit përdorin instrumente ekonomike (sistemin e rimbursimit për ambalazh) për të promovuar:

- a. Grumbullimin e mbetjeve të ambalazheve;
- b. Përdorimi i materialeve të ambalazheve, të cilat nuk përmbajnë substanca të rrezikshme.

**Parimi i përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit** nuk zbatohet në asnjë formë nga prodhuesit e çdo lloj produkti ambalazhi, përfshirë polietilenin (PET), qelqin ose aluminin. Aktivitetet e riciklimit luajnë një rol të rëndësishëm në sektorin e menaxhimit të mbetjeve, të cilat nëse bëhen siç duhet ulin sasinë e mbetjeve të depozituara në lëndfill, por gjithashtu u ofrojnë kompanive të riciklimit një cilësi të mirë të materialit të papërpunuar. Duke iu referuar Dokumentit të Politikave Strategjike, Shqipëria ka një industri të riciklimit të zhvilluar dhe aktive me 32 anëtare të shoqërive në Shoqatën e Ricikluesve të Shqipërisë (SHRSH). SHRSH-ja raporton se kompanitë e riciklimit kanë një kapacitet përpunimi prej 498.480 tonë/vit, por për shkak të mungesës së lëndës së parë, kjo industri ka angazhuar vetëm 26,8% të kapacitetit të saj të prodhimit ose 133.592 ton/vit. Të dhënat nga INSTAT-i raportojnë se rreth 18,7% e mbetjeve totale të gjeneruara në 2019 riciklohen ndërsa SHRSH-ja raporton se niveli i riciklimit në Shqipëri është rreth 10%.

Në këtë fazë, asnjë program ose plan për të përmbushur përgjegjësinë e zgjeruar të prodhuesit nuk është hartuar dhe zbatuar nga prodhuesit e materialeve të ambalazheve ose shitësit me pakicë. Në këto kushte, barra financiare për grumbullimin dhe trajtimin e këtij lloji të mbetjeve bie mbi qytetarët, bashkitë dhe buxhetin e shtetit.

Në datë 03.12.2018 ka hyrë në fuqi ligji Nr. 93/2018 për disa ndryshime në ligjin „Për Taksat Kombëtare<sup>57</sup>” i cili përcakton një tarifë për të gjitha materialet e ambalazheve plastike dhe qelq të importuara dhe ato të prodhuara në vend. Taksa mbledhet nga Drejtoria e Doganave nën Emërtimin e Kombinuar të Mallrave kur importohet dhe

57 Nr. 9975, 28.7.2008

nga administrata tatimore kur prodhohet në vend. Kjo është një masë ekonomike e marrë për të rikuperuar disi kostot për menaxhimin e mbetjeve të ambalazheve.

Në të vërtetë, taksa e produkteve për qelqin dhe produktet plastike i kalon Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, e cila më pas bëhet pjesë e buxhetit të shtetit dhe nuk shkon direkt për të financuar programe mjedisore.

Rekomandimi ynë është që taksa për qelqin dhe produktet plastike të shkojë në Fondin e Mjedisit për rehabilitimin e pikave të nxehta mjedisore, ose për të mbështetur aktivitetet e riciklimit dhe për krijimin dhe mbështetjen e sistemit EPR.

Në korrik 2018, VKM "Për ndryshimet në VKM Nr. 177, datë 6.3.2012"<sup>58</sup> ka hyrë në fuqi dhe të gjithë shitësit e mallrave në Shqipëri duhet t'i taksojnë një tarifë blerësve, për secilin qese plastike të lehtë që ata vendosin në treg. (5 lekë ose 5 cent / € për qese të vogla dhe 10 lekë ose 10 cent / € për qese të mëdha).

Aktualisht nuk ekziston një sistem monitorimi për zbatimin e VKM-së, prandaj të dhënat mbi zvogëlimin e konsumit të qeseve plastike që nga VKM-ja e hyrë në fuqi, nuk janë të disponueshme. Mungon monitorimi në lidhje me prodhimin dhe tregtimin e qeseve plastike me një përdorim të vetëm, madhësia dhe përbërja e të cilave janë përcaktuar nga një VKM e veçantë, prandaj ndikimi i këtyre akteve nënligjore nuk ka qenë i kënaqshëm në krahasim me pritshmëritë fillestare të autoriteteve kompetente. Në lidhje me këtë aspekt, qeveria në njërin anë, duhet të rishikojë VKM-në specifike për qeset plastike me një përdorim, për të përcaktuar masa më kufizuese, dhe në anën tjetër duhet të marrë masa për të siguruar zbatimin e ligjit dhe zbatimin e rregullores përmes rritjes së burimeve dhe kapaciteteve të AKM-së dhe Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujit dhe Turizmit, të dyja në varësi të MTM-së.

## Për menaxhimin e mbetjeve nga industrinë nxjerrëse

### Transpozimi

Direktiva "Për menaxhimin e mbetjeve nga industrinë nxjerrëse" siguron procedurat dhe udhëzimet e masave për të zvogëluar efektet negative në mjedis si rezultat i mbetjeve

<sup>58</sup> Nr. 232, datë 26.4.2018



nga industrinë nxjerrëse. Ligji „Për Sektorin e Minerave në Republikën e Shqipërisë“<sup>59</sup> i ndryshuar, përcakton rregullat për zhvillimin e veprimtarive minerare dhe pas-minerare dhe synon të promovojë aktivitetin minerar në Republikën e Shqipërisë. Ligji synon të sigurojë transparencë dhe konkurrencë të lirë në zhvillimin e kësaj veprimtarie, duke maksimizuar përfitimin publik nga veprimtaria minerare dhe mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetin publik nga mbetjet e minerave dhe industrisë minerare.

Kjo direktivë është në 45% të nivelit të transpozimit, gjë që sugjeron se duhet bërë shumë për të arritur transpozimin e plotë.

### **Kuadri institucional**

MIE është organi përgjegjës për Direktivën e Industrisë Nxjerrëse dhe monitoron aktivitetin e aktiviteteve të lejeve dhe funksionimit të subjekteve të licencuara që veprojnë në këtë fushë. Organi vartës i MIE-së është Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) që ka si objekt zhvillimin, mbikëqyrjen e përdorimit racional të burimeve natyrore, sipas politikës së qeverisë, dhe monitorimin e pas-shfrytëzimit të tyre në miniera, naftë dhe energji.

AKM-ja është institucioni që kontrollon ndikimin që kanë këto industri në mjedis dhe është përgjegjës për mbledhjen e të dhënave për sasinë dhe llojin e ndotjes që ato shkaktojnë.

### **Zbatimi**

Të gjitha kompanitë që operojnë në industrinë nxjerrëse, kur aplikojnë për licencë duhet të plotësojnë kërkesat ligjore. Ligji kërkon që subjekti duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore dhe një Vlerësim të Ndikimit në Mjedis (VNM) për aktivitetin që ata do të kryejnë.

Subjekti duhet gjithashtu të hartojë një Plan të Rehabilitimit të Mjedisit, i cili përmban, ndër të tjera, të gjitha hapat që duhet të ndiqen nga njësia ekonomike për riciklimin, transportin, trajtimin dhe asgjësimin përfundimtar të mbetjeve të krijuara gjatë aktivitetit të saj. Subjekti duhet të raportojë mbi baza vjetore tek autoritetet përkatëse për pasqyrat financiare dhe për tipologjinë e aktivitetit që po zhvillohet dhe sasinë e mbetjeve të

<sup>59</sup> Nr. 10304, datë 15 Korrik 2010.



krijua dhe të trajtuara. Ligji përcakton që nëse njësi ekonomike nuk përmbush detyrimet e saj për rehabilitimin e zonës ku ai ka ushtruar funksionin e tij, atëherë fondet që kjo njësi ekonomike ka lënë si garanci do të përdoren për rehabilitimin e saj. Gjjobat parashikohen nga ligji në rastet kur subjekti nuk i përmbush detyrimet e tij.

Aktualisht në vend, nuk ka asnjë lëndfill për mbetjet e rrezikshme, gjë që sugjeron që këto njësi të trajtojnë dhe asgjësojnë vetë këto mbetje. Ndërkohë që kemi një Plan Sektorial të dedikuar për menaxhimin e ZMM-ve, është e domosdoshme që një dokument i ngjashëm duhet të hartohet në kohën më të shkurtër të mundshme dhe duhet të adresojë në një anë, zgjedhjen e vendit dhe teknologjitë për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të zbatohet brenda një afati kohor të arsyeshëm. Në raportin e AKM-së për vitin 2019 janë paraqitur të dhëna nga 779 subjekte, të cilat kanë kryer vetë-raportim. Këto subjekte operojnë në aktivitete të ndryshme si industria e hidrokarbureve, industria minerare, industria metalike, industria e përpunimit të peshkut, pijet, prodhimi i industrisë së lehtë dhe ushqimore të vajrave vegjetalë etj. Në raportin e vitit 2019, AKM-ja tregon gjithashtu se ka 159 subjekte që merren me transportim të mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme, por në të gjitha rastet nuk tregohet se ku depozitohen këto mbetje.

Dokumenti i Politikave Strategjike parashikon se kërkohet një Master Plan për të krijuar sisteme të veçanta të menaxhimit të mbetjeve për mbetjet specifike. Këto përfshijnë mbetje që do t'i nënshtrohen Përgjegjësisë të Zgjeruar të Prodhuesit dhe rryma të tjera specifike të mbetjeve të rrezikshme.

Për të menaxhuar më mirë të dhënat mbi mbetjet e rrezikshme, kërkohet një sistem mirë funksional i raportimit elektronik, ku kompanitë duhet të raportojnë të dhëna. Në faqen e internetit të AKM-së<sup>60</sup> / MTM-së<sup>61</sup>, ekziston një lidhje që të drejton tek Regjistri i Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve të Mjedist<sup>62</sup>, i cili nuk është i përditësuar.

VKM-ja „Për funksionimin dhe menaxhimin e regjistrit të shkarkimit e të transferimit të ndotësve, miratimin e listës së veprimtarive dhe të ndotësve, që janë subjekt i këtij regjistri, si dhe të formularit të deklarimit të të dhënave për shkarkimet dhe për transferimin e ndotësve nga operatori”<sup>63</sup>. Kjo VKM transpozoi pjesërisht Rregulloren

60 <http://www.akm.gov.al/informacione.htm> lërshtr

61 <http://prr.akm.gov.al/main/welcome.jsf>

62 <http://www.akm.gov.al/assets/regjiloria-pene-prr.pdf>

63 VKM Nr 742, datë 09.09.2015

„Për krijimin e një Regjistri Evropian të Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve”<sup>64</sup>. E-RRSHTN, në formën e një baze të të dhënave publike vjen në një format elektronik për të lehtësuar pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore në mënyrë që të parandalohet dhe zvogëlohet ndotja e mjedisit.”

## **Për mbrojtjen e mjedisit kur llumi i ujërave të zeza përdoret në bujqësi**

### **Transpozimi**

Direktiva „Për mbrojtjen e mjedisit kur llumi i ujërave të ndotura përdoret në bujqësi” me qëllim rregullimin e përdorimit korrekt të llumrave të ujërave të ndotura në bujqësi, duke promovuar ato mënyra që parandalojnë efektet e dëmshme në tokë, bimësi, kafshë dhe njerëz. Kjo Direktivë është transpozuar plotësisht në VKM-në „Për kërkesat e përdorimit të llumrave të ujërave të ndotura në bujqësi”<sup>65</sup>.

Teksa procesi i transpozimit ka përfunduar, zbatimi i kësaj direktive është në fazën e tij fillestare për shkak të impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura që mungojnë, të cilat kryesisht mungojnë për shkak të kostos së lartë të ndërtimit dhe funksionimit të këtyre.

### **Kuadri institucional**

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) është institucioni kryesor që merret me transpozimin e Direktivës „Për mbrojtjen e mjedisit kur llumi i ujërave të ndotura përdoret në bujqësi”<sup>66</sup>. Qendrat e Transferimit të Teknologjisë Bujqësore, QTTB, të cilat janë agjenci vartëse të MBZHR-së, janë përgjegjëse për përcaktimin e kriterëve dhe parametrave specifikues të llumrave që do të përdoren në bujqësi.

Ministri i Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, me urdhër të përbashkët, miratojnë formatin që do të përdoret për përgatitjen e raportit në lidhje me zbatimin e VKM-së.

AKM-ja është organi përgjegjës për miratimin e Vlerësimit të Ndikimeve në Mjedis dhe monitorimin e fazës funksionale të impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura.

64 (EC) Nr 166/2006

65 Nr. 127, datë 11/02/2015

66 86/278/EKE

Autoriteti kompetent (AKM / QTTB) krijon, mirëmban dhe përditëson Regjistrin Kombëtar për përdorimin e llumrave në bujqësi, i cili përfshin të dhëna përkatëse të raportuara nga prodhuesit dhe përdoruesit.

MIE, përmes agjencisë së saj vartëse AKUM, është institucioni kryesor përgjegjës për ndërtimin e impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura në territorin e Shqipërisë.

Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU)<sup>67</sup> është autoriteti kryesor për licencimin e të gjithë personave fizikë dhe juridikë që ofrojnë shërbime e furnizimit me ujë dhe / ose të ujërave të ndotura për publikun dhe rregullon shërbimet tarifore. Përfshirja e dy ministrive dhe agjencive vartëse të tyre krijon konfuzion, se kush bën çfarë, prandaj ekziston nevoja për të sqaruar kompetencat midis institucioneve të përfshira kryesisht midis MTM dhe MBZHR.

### Zbatimi

Zbatimi i kësaj direktive varet shumë nga ndërtimi dhe funksionimi i impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura që do të mbulojnë të gjithë ose pjesën më të madhe të territorit me shërbim. Aktualisht në Shqipëri sipas të dhënave nga ERRU ka 8 impiante të trajtimit të ujërave të ndotura por vetëm 4 janë të licencuara, gjë që tregon se gjysma e impianteve nuk i plotësojnë kërkesat ligjore. Shumica e tyre nuk janë të pajisur me Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor dhe lejet përkatëse mjedisore, ndërsa bashkitë duhet të mbulojnë kostot e këtyre shërbimeve të zgjeruara bazuar në tarifën e aprovuar nga ERRU. Kjo është një çështje që bashkitë nuk mund ta trajtojnë vetë, përveç nëse vendoset një koordinim efektiv midis tyre dhe autoriteteve kompetente, MIE dhe ERRU. Nuk ka të dhëna për sasinë e llumrave të përdorur në bujqësi.

### Direktiva të tjera

Direktivat e mëposhtme paraqiten këtu si një grup pasi ato mbulojnë rrymatë veçanta të mbetjeve dhe sepse të dhënat për zbatimin e tyre zakonisht mungojnë.

<sup>67</sup> Ligji Nr. 8102 datë 28.03.1996 Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe trajtimit të ujërave të ndotura „...” ndryshuar.

## Transpozimi

1. Direktiva „**Për bateritë dhe akumulatorët dhe mbetjet e tyre**“<sup>68</sup>, synon të ndalojë nxjerrjen në treg të baterive dhe akumulatorëve të caktuar që përmbajnë merkur ose kadmium. Direktiva promovon një nivel të lartë të grumbullimit dhe riciklimit të mbetjeve të baterive dhe akumulatorëve dhe përmirësimin e performancës mjedisore të të gjithë operatorëve të përfshirë në ciklin e jetës së baterive dhe akumulatorëve. (Prodhuesit, shpërndarësit dhe përdoruesit e fundit dhe, në veçanti, ata operatorë të përfshirë drejtpërdrejt në trajtimin dhe riciklimin e mbetjeve të baterive dhe akumulatorëve).

Pjesa kryesore e kësaj direktive është transpozuar në Ligjin Nr. 10 463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"<sup>69</sup>, i ndryshuar dhe në VKM "Për bateritë dhe akumulatorët dhe mbetjet e tyre"<sup>70</sup>.

2. Direktiva „**Për heqjen e PCB/PCT**“<sup>71</sup> (PCB / PCT). Qëllimi i kësaj Direktive është të përafrojë ligjet e Shteteve Anëtare për asgjësimin e kontrolluar të PCB-ve, dekontaminimin ose heqjen e pajisjeve që përmbajnë PCB dhe / ose heqjen e PCB-ve të përdorura në mënyrë që t'i eliminojë ato plotësisht në bazë të dispozitave të kësaj direktive.

Pjesa kryesore e kësaj direktive është transpozuar në ligjin "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar dhe VKM "Për rregullat në lidhje me depozitimin e kontrolluar të PCB-ve / PCT-ve, dekontaminimin ose heqjen e pajisjeve që përmbajnë PCB / PCT dhe / ose heqjen e mbetjeve të përdorura PCB/PCT"<sup>72</sup>.

3. Direktiva „**Për automjetet në fund të ciklit të jetës**“<sup>73</sup>. Qëllimi i kësaj direktive është parandalimi i mbetjeve nga automjetet dhe, përveç kësaj, gjatë ripërdorimit, riciklimit dhe formave të tjera të trajtimit të automjeteve në fund të ciklit të jetës dhe përbërësve të tyre në mënyrë që të zvogëlohet depozitimi i mbetjeve, si dhe në përmirësimin e performancës mjedisore të të gjithë operatorëve ekonomikë të përfshirë në ciklin jetësor të automjeteve dhe

68 2006/66/KE

69 Nr. 10 463, datë 22.09.2011

70 Nr. 866

71 96/59/KE

72 Nr. 387, datë 06.05.2015

73 2000/53/KE



veçanërisht operatorëve të përfshirë drejtpërdrejt në trajtimin e automjeteve në fund të ciklit të jetës së tyre.

Kjo direktivë ka një nivel të mirë të transpozimit referuar akteve ligjore dhe është transpozuar në Ligjin "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" i ndryshuar dhe VKM "Për menaxhimin e mbetjeve të automjeteve në fund të ciklit të jetës së tyre"<sup>74</sup> dhe VKM "Për kriteret për të përcaktuar se kur disa lloje skrapesh nuk konsiderohen më mbetje"<sup>75</sup>.

4. Direktiva „Për mbetjet e pajisjeve elektrike dhe elektronike”<sup>76</sup>. Qëllimi i kësaj direktive është të kontribuojë në prodhimin dhe konsumin e qëndrueshëm, parandalimin e mbetjeve nga pajisjet elektrike dhe elektronike dhe, përveç kësaj, nga ripërdorimi, riciklimi dhe format e tjera të përpunimit të mbetjeve të tilla në mënyrë që të zvogëlohet depozitimi i mbetjeve dhe të kontribuojë në përdorimin efikas të burimeve dhe rimarrjen e lëndëve dytësore të patrajtuara të vlefshme. Direktiva, gjithashtu, kërkon të përmirësojë performancën mjedisore të të gjithë operatorëve të përfshirë në ciklin jetësor të pajisjeve elektrike dhe elektronike, në zbatimin e parimit të përgjegjësisë së prodhuesit<sup>77</sup>.

Kjo direktivë është në fazat fillestare të transpozimit, duke iu referuar akteve ligjore dhe është transpozuar në Ligjin "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" i ndryshuar dhe VKM "Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike"<sup>77</sup>.

#### **Përfundim për transpozimin e këtyre direktivave.**

Zbatimi i këtyre direktivave është në fazën fillestare dhe nevojitet më shumë për të arritur objektiva më të mirë për zbatimin e tyre, kryesisht në zbatimin e përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit, mbi barrën financiare që duhet të mbulojnë prodhuesit, trajtimin dhe asgjësimin përfundimtar të këtyre llojeve të mbetjeve dhe procedurat e raportimit.

#### **Kuadri institucional**

Institucioni kryesor për transpozimin e këtyre direktivave është MTM-ja, dhe AKM-ja është organi përgjegjës për procesin e monitorimit dhe zbatimin e këtyre direktivave dhe për ndikimin që kanë operatorët gjatë zbatimit të aktiviteteve të tyre në mjedis.

74 Nr. 705

75 Nr. 117, datë 13 shkurt 2013

76 2012/19/UE

77 Nr. 957, datë 19 Dhjetor 2012

Zbatimi i këtyre direktivave kërkon një bashkëpunim shumë të mirë me institucione të tjera të tilla si Drejtoria e Doganave, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit, Rugor dhe bashkitë.

Dokumenti i Politikave Strategjike përcakton që Planet Sektoriale duhet të hartohen për secilën rrymë të mbetjeve për të përcaktuar qartë përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit, mënyrën e raportimit dhe institucionet përkatëse që duhet të angazhohen në këto zona. Hartimi i këtyre planeve, mund të shoqërohet me ndryshime në legjislacion.

Duke marrë parasysh numrin e vogël të stafit të MIE-së dhe AKM-së të dedikuar për transpozim, monitorimin e zbatimit të legjislacionit në lidhje me menaxhimin e mbetjeve në tërësi, ekziston nevoja për të rritur numrin e punonjësve dhe duhet të zhvillohen trajnime në mënyrë që të rriten kapacitetet e këtyre punonjësve .

## Zbatimi

**1 - VKM „Për bateritë dhe akumulatorët dhe mbetjet e baterive dhe akumulatorëve”** synon të vendosë rregulla për nxjerrjen në treg të baterive dhe akumulatorëve, të ndalojë tregtimin e atyre që përmbajnë substanca të rrezikshme dhe të promovojë riciklimin dhe maksimizimin e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve të baterive dhe akumulatorëve.

Kjo VKM parashikon që të gjithë prodhuesit e baterive dhe akumulatorëve duhet të regjistrohen në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe t'u jepet një leje mjedisore dhe përcakton standardet për produktet që do të vendosen në treg.

VKM-ja parashikon që prodhuesit ose shpërndarësit e baterive dhe akumulatorëve duhet të krijojnë skema për trajtimin e mbetjeve dhe riciklimin e baterive dhe akumulatorëve, duke përdorur teknikat më të mira në dispozicion që mbrojnë shëndetin e njeriut dhe mjedisin.

Në situatën aktuale në vend, nuk ka skema për grumbullimin e baterive dhe akumulatorëve.

Referuar raportit të AKM-së për vitin 2019 ka disa biznese që grumbullojnë dhe trajtojnë mbetjet nga bateritë dhe akumulatorët por nuk ofrohen të dhëna të sakta për sasi të.

**2 - VKM "Miratimin e rregullave për kontrollin e heqjes së PCB-ve/PCTve, çndotjen apo heqjen e pajisjeve që përmbajnë PCB/PCT dhe/ose asgjësimin e mbetjeve të PCB/PCT të përdorura".** Ky vendim synon të rregullojë depozitimin e kontrolluar të PCB-ve, dekontaminimin ose asgjësimin e pajisjeve që përmbajnë PCB dhe / ose asgjësimin e PCB-ve të përdorura, në mënyrë që ato të eliminohen plotësisht.

VKM-ja parashikon që të gjitha pajisjet, materialet dhe lëngjet që përmbajnë PCB dhe PCB të përdorura, në territorin e Republikës së Shqipërisë, duhet të eliminohen brenda vitit 2018. VKM-ja detyron pronarët e pajisjeve, materialeve ose lëngjeve që përmbajnë PCB, për të përbushur vetëdeklarimin dhe për të shkatërruar me procese të asgjësimit parashikuar nga kjo VKM.

VKM-ja parashikon që pronari i këtij materiali duhet / mund të kontraktojë një person fizik / juridik të licencuar për të depozituar ose eksportuar materialin ose mund të digjet në përputhje me dispozitat e ligjit për djegien e mbetjeve.

Në raportin vjetor të AKM-së për statusin e mjedisit për vitin 2019 nuk është raportuar sasia e materialeve PCB / PCT të asgjësuar ose djegura.

Nuk ka të dhëna për sasinë aktualisht në vend dhe sasinë e PCB / PCT të depozituara ose eksportuara në mënyrë të sigurt.

**3 - VKM „Për menaxhimin e mbetjeve për automjetet në fund të ciklit të jetës“** përcakton institucionet që janë përgjegjëse për zbatimin e kësaj VKM-je dhe ato që duhet të raportojnë dhe mbledhin informacione për këto lloj mbetjesh.

VKM-ja përcakton gjithashtu që operatorët ekonomikë që veprojnë në këtë fushë duhet të marrin të gjitha masat për grumbullimin, riciklimin dhe trajtimin e automjeteve. Këta operatorë duhet të pajisen me licencë, e cila dëshmon se plotësojnë të gjitha kërkesat ligjore për të operuar në këtë fushë.

Operatorët duhet të deklarojnë një herë në vit numrin e automjeteve të çaktivizuara që kanë trajtuar dhe si kanë funksionuar me pjesë të veçanta të këtyre automjeteve. Në raportin e AKM-së të vitit 2019 nuk ka të dhëna të raportuara për numrin e automjeteve jashtë përdorimit. Nga ana tjetër, raportohet se janë disa operatorë në Qarkun e Elbasanit dhe Durrësit që operojnë në këtë fushë, por nuk ka asnjë informacion se si e kryejnë rikuperimin, riciklimin dhe trajtimin e këtyre automjeteve.

Ky sektor është prekur nga informaliteti, pasi ka shumë individë / subjekte që merren me shitjen e automjeteve të përdorura, riparimin e tyre dhe përdorin vetëm disa pjesë të këtyre makinave. Pjesa më e madhe e këtyre operatorëve nuk janë të regjistruar ose nuk kanë licencë në këtë sektor.

Teksa raportimi bëhet në bazë të vetëdeklarimit, duhet të merren masa më të forta për të detyruar këto njësi ekonomike të raportojnë në mënyrë periodike dhe të rregullt mbi shumën dhe mënyrën e trajtimit të këtyre aseteve.

Me miratimin e VKM Nr. 154, datë 27.02.2019<sup>78</sup>, pas datës 01.01.2020, për automjetet e përdorura, regjistrimi lejohet për herë të parë vetëm nëse plotësojnë kategorinë mjedisore EURO 4 dhe më lart, ndërsa automjetet me kilometrazhin 0 duhet të plotësojnë kategorinë mjedisore EURO 5 dhe EURO 6 (sipas kriterëve të VKM Nr. 633).

**4 - VKM „Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike“<sup>79</sup>** synon parandalimin e mbetjeve nga pajisjet elektrike dhe elektronike, promovimin e ripërdorimit, riciklimit dhe mënyrave të tjera të përpunimit, në mënyrë që të ulët sasia që do të hidhet përfundimisht si mbetje dhe të përmirësohet performanca mjedisore e operatorëve, prodhuesve, shpërndarësve dhe konsumatorëve të përfshirë në ciklin jetësor të pajisjeve të tilla.

VKM-ja parashikon që të gjithë prodhuesit ose importuesit e pajisjeve të tilla duhet të regjistrohen në Qendrën Kombëtare të Licencimit, në mënyrë që të veprojnë në territorin e Shqipërisë. VKM-ja gjithashtu siguron një sërë masash që duhet të merren nga këta operatorë siç janë etiketimi i produkteve, mënyra se si ata do të përmbushin detyrimet e tyre për grumbullimin e produkteve, adresën e njësisë ekonomike etj.

Operatorët që operojnë në këtë fushë duhet të krijojnë një sistem për rikuperimin e grumbullimit, riciklimin dhe trajtimin e këtyre pajisjeve në territorin e Shqipërisë në përputhje me teknikat më të mira në dispozicion.

VKM-ja parashikon gjithashtu synime që duhen arritur në drejtim të rikuperimit, riciklimit dhe trajtimit të këtyre pajisjeve. Njësitë e qeverisjes vendore ngarkohen me detyrimin për të llogaritur peshën totale të hyrjeve dhe daljeve në territorin nën juridiksionin e tyre dhe

<sup>78</sup> Për masat kundër ndotjes së ajrit nga shkarkimet nga automjete: motorike dhe zvogëlimin e shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe të ngurtë nga motorët me ndeje pozitive dhe ato me ndeje me kompresim që djegin gaz natyror ose të lëngshëm për përdorim në automjete.

<sup>79</sup> Nr. 957, datë 19 Dhjetor 2012.



raportimin e këtyre të dhënave në AKM, e cila ruan dhe llogarit sasinë totale të pajisjeve elektronike dhe elektrike të futura në vend dhe shumën e trajtuar si mbetje në vend.

Aktualisht nuk ka një sistem për mbledhjen e mbetjeve të tilla në vend, NJQV-të për shkak të mungesës së kapacitetit dhe mjeteve nuk llogaritin sasinë e pajisjeve elektronike dhe elektrike që hyjnë në territorin e tyre dhe sasinë e këtyre mbetjeve të prodhuara në territorin e tyre. Si pasojë, të dhënat për këto lloje të mbetjeve janë jo të plota ose mungojnë në shumicën e rasteve.

Siç parashikohet nga Dokumenti i Politikave Strategjike, këto produkte i nënshtrohen Përgjegjësisë së Zgjieruar të Prodhuesit dhe për këtë arsye prodhuesit dhe importuesit e këtyre materialeve duhet të vendosin sisteme për mbledhjen e këtyre mbetjeve. Meqenëse kjo VKM përcakton objektivat që duhen arritur, të cilat kanë skaduar, ekziston nevoja për të rishikuar dhe vendosur objektiva të rinj.

Direktiva „Për kufizimin e përdorimit të disa substancave të rrezikshme në pajisjet elektrike dhe elektronike“ RoHS (e rishikuar), nuk është transpozuar ende.

3

UJI



## 3.1 HYRJE

Shqipëria ka burime relativisht të bollshme të ujërave të ëmbla. Ekzistojnë shtatë lumenj kryesorë që e përshkojnë Shqipërinë nga Lindja në Perëndim. Kontributi i derdhjeve të lumenjve në Detin Adriatik është shumë i madh (95%), krahasuar me derdhjet në detin Jon (5%).

Bregdeti mbështet ekosisteme unike dhe siguron burime jetësore dhe rrugët lidhëse për vendin. Bregdeti shqiptar është i gjatë 450 km dhe është i njohur për shumë ekosisteme të rëndësishme në rajonin e Mesdheut si laguna, ligatina, duna me rërë, delta lumore dhe pyje. Bregdeti i Shqipërisë fillon në Veri, në grykën e lumit Buna dhe përfundon në Jug në Kepin e Stillos. Liqenet dhe lumenjtë janë gjithashtu të rëndësishëm për biodiversitetin dhe vlerat e peizazhit. Riviera perëndimore shtrihet përgjatë vijës bregdetare të Adriatikut për rreth 200 km nga Veriu në Jug dhe përshkohet nga lumenjtë e Shkumbinit, Semanit dhe Matit. Ka shumë ligatina dhe zona me rërë, të cilat formojnë plazhe të shkëlqyera si në Shëngjin, Velipojë, Durrës, Karavasta, Godullë, Vain, Kënalë, Divjakë, etj.

Monitorimi i cilësisë së ujit, i ndërmarrë nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, nuk përfshin raportimin për cilësinë e ujit të pijshëm dhe atë të ujërave nëntokësore. Cilësia e ujërave të larjes raportohet pjesërisht me cilësi jo të kënaqshme dhe në disa raste me përkeqësime, ndërsa rreth 40% e stacioneve të monitorimit të cilësisë së ujit bregdetar rezultojnë me cilësi të klasifikuar si të dobët sipas Direktivës së nishkuar të Ujërave të Larjes të BE-së bazuar në të dhënat 2012-2015.

Sektori i Ujit mbetet një nga sektorët me përgjegjësitë institucionale më të shpërndara për sa i përket menaxhimit.

### Sfidat në sektorin e Ujit

Megjithëse ka pak Plane të Menaxhimit të Baseneve Lumore (PMBL) të miratuar ose nën konsultime publike, ekziston një boshllëk i madh në zbatimin e masave për menaxhimin e burimeve ujore. Agjencia e themeluar së fundmi për Menaxhimin e Burimeve Ujore, e mbështetur nga projekti i financuar nga BE, ka bërë përparim të mirë në zhvillimin e metodologjisë së kërkuar për zhvillimin e PMBL-ve. Sidoqoftë, procesi është i ngadaltë dhe strukturat vendore kanë kapacitete dhe burime të kufizuara për të filluar zbatimin e veprimeve të identifikuara. Menaxhimi i trupave ujorë mbetet kaotik dhe kryesisht për shkak të lejeve të nxjerrjes së ujit ose lejeve për investime. Deri më sot nuk është

marrë asnjë masë nga autoritetet vendore për të adresuar ndotjen përgjatë lumenjve, liqeneve dhe bregdetit.

Sektori i Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime (UK) përballet me një numër problemesh, duke filluar me një nivel të ulët të përfrimit me legjislacionin e BE-së për shërbimet e furnizimit me ujë dhe cilësinë e ujit, si dhe grumbullimin, trajtimin dhe depozitimin e ujërave të ndotura, sidomos në zonat urbane. Legjislacioni në lidhje me ujin e pijshëm, trajtimin e ujërave të ndotura urbane dhe aktet nënligjore të ujërave nëntokësore janë, në rastin më të mirë, jo të plota dhe, në disa raste të tjera, ende mungojnë tërësisht.

Presionet kryesore që lidhen me ujërat shqiptare, përfshirë zonat e ujërave të ëmbla, detare dhe bregdetare, përcaktohen më poshtë.

Ndotja është problematike, pasi disa lumenj derdhen në ujërat shqiptare duke ndikuar drejtpërdrejt në cilësinë e tyre. Burimet kryesore të ndotjes janë:

Ndotja nga shkarkimi i ujërave të patrajtuar urbane dhe mbetjeve të ngurta - shkarkimet urbane pa ndonjë trajtim paraprak janë burimi kryesor i ndotjes së ujit.

Ndotja nga shkarkimi i materialeve industriale të ngurta dhe të lëngshme - këto mund të vijnë nga fabrikat e industrisë së lehtë dhe ushqimore, fabrikat e çimentos, përpunimi i lëkurës, qeramika, tekstilet, minierat, metalurgjia, nxjerrja dhe përpunimi i naftës dhe gazit dhe përpunimi i drurit.

Ndotja nga aktivitetet bujqësore: Përdorimi i kimikateve në bujqësi ka qenë i kufizuar përgjatë 20-25 viteve, megjithëse kohët e fundit është në rritje.

Ndotja nga shkarkimi i materialeve të ngurta, kryesisht nga minierat dhe ndërmarrjet e përpunimit - këto kanë të bëjnë me minerale bakri, kromi dhe hekuri-nikeli. Lëndfilllet e tyre shpesh gjenden në brigjet e lumenjve. Sasia e tyre mund të jetë deri në 12,5 x 106 ton, nga të cilët rreth 9 x 106 janë mineral bakri steril me përmbajtje bakri 0,15 - 0,20%. Megjithëse aktivitetet minerare, metalurgjike dhe kimike kanë rënë, pas viteve 1990, shkarkimet masive të tyre ende paraqesin një rrezik për shëndetin e mjedisit dhe të njeriut. Industria e naftës (nxjerrja dhe përpunimi) mbetet një nga burimet kryesore të ndotjes në ujërat e ëmbla dhe bregdetare, më e rëndësishmja për lumenjtë Seman (nga dega e saj Gjanica) dhe Vjosa (lumenj që rrjedhin nëpër zonat e naftës dhe bitumit).



Sipas kushteve vendore, ujërat nëntokësore mbishfrytëzohen shumë përmes puseve, kryesisht në fusha dhe lugina, ose përmes burimeve, më shpesh në zonat kodrinore dhe malore. Por prania dhe përdorimi i këtyre ujërave është mjaft i zakonshëm në të gjithë vendin. Siç ndodh shpesh, dhe veçanërisht kur zonat e mëdha karstike ndikojnë në lëvizjen e ujërave nëntokësore, basenet e lumenjve nuk përkojnë me njësitë e ujërave nëntokësore; megjithatë, në këtë raport, burimet e ujërave nëntokësore do të paraqiten të renditura sipas njësisë së basenit lumor për të mundësuar një krahasim të disponueshmërisë dhe përdorimit.

Fragmentimi i detyrave dhe përgjegjësi, konkurrenca për autoritet midis disa agjencive, kapaciteti i kufizuar i vendimmarrjes dhe menaxhimi i dobët mbeten mbizotëruese në strukturën institucionale dhe organizative dhe ndikojnë në kapacitetin e sektorit për të përmirësuar shërbimet në mënyrë efektive dhe për t'u radhitur në të njëjtën linjë me legjislacionin e BE-së.

## 3.2 VLERËSIM I SHPEJTË I PROGRESIT

Komuniteti i OSHC-ve mjedisore vëren se Direktivat e BE-së për nënkapitullin e Cilësisë së Ujit janë në fazën fillestare të transpozimit dhe zbatimit. Megjithëse disa prej tyre janë transpozuar, mungojnë dukshëm masat e zbatimit. Bazuar në prezantimin zyrtar për progresin e vendit, ekzistojnë katër direktiva që zbatohen pjesërisht, 4 direktiva në fazën fillestare të zbatimit dhe 2 direktiva nuk janë zbatuar fare.

Siç është raportuar, përqindja mesatare e transpozimit është 35%

Direktiva e BE-së	Vlerësimi		
	Transpozimi	Kuadri institucional	Zbatimi
2000/60/KE <b>Direktiva Kuadër e Ujit</b>			
91/271/EKE <b>Direktiva e Trajtimit të Ujit të Ndolur Urban</b>			
2008/56/KE <b>Direktiva e Kuadrit Strategjik Detar</b>			
2010/477/BE/BE <b>Standardet për statusin e mirë mjedisor në ujërat detare</b>			
98/83/KE <b>Direktiva e Ujit të Pijshëm</b>			
91/676/EKE <b>Nitratet</b>			
2006/7/KE <b>Ujërat e larjes</b>			
2006/118/KE <b>Ujërat nëntokësorë</b>			
2008/105/KE <b>Standardet e Cilësisë së Mjedisit për Ujin</b>			
2009/90/KE <b>Sigurimi i cilësisë / Kontrolli i cilësisë</b>			
2007/60/KE <b>Përmbytjet</b>			

Tabela 6: Vlerësim i shpejtë i Ujit

## 3.3 VLERËSIM I HOLLËSISHËM I NËNKAPITULLIT - PROGRESI I DERITANISHËM

### 2000/60/KE: Direktiva Kuadër e Ujit

Mbrojtja e ujit është një nga përparësitë e Komisionit. Politika Europiane e Ujit kërkon pastrimin e ujërave të ndotur dhe të sigurojë që ujërat e pastra të mbahen të pastër. Direktiva Kuadër e Ujit përmban qëllimet kryesore vijuese: zgjerimin e fushës së mbrojtjes së ujit për të gjitha ujërat, ujërat sipërfaqësore dhe ujërat nëntokësore; arritjen e „statusit të mirë” për të gjitha ujërat brenda një afati të caktuar; menaxhimin e ujërave bazuar në basenet e lumenjve; „qasja e kombinuar” e vlerave kufi të shkarkimeve dhe standardeve të cilësisë; vendosja e duhur e çmimeve; përfshirja e qytetarëve nga afër; modernizimin e legjislacionit.

**Direktiva kërkon** që menaxhimi i baseneve lumore të vendosë modelin më të mirë për një sistem të vetëm të menaxhimit të ujit, i cili është menaxhimi sipas basenit lumor - njësi natyrore gjeografike dhe hidrologjike - në vend të kufijve administrativë ose politikë.

Për më tepër, nevojitet koordinimi i objektivave - statusi i mirë për të gjitha ujërat brenda një afati të caktuar. Shqipëria duhet të specifikojë një numër objektivash sipas të cilëve mbrohet cilësia e ujit. Ato kryesoret në nivel evropian janë mbrojtja e përgjithshme e ekologjisë ujore, mbrojtja specifike e habitateve unike dhe të vlefshme, mbrojtja e burimeve të ujit të pijshëm dhe mbrojtja e ujërave të larjes. Të gjitha këto objektiva duhet të integrohen për secilin basen lumor.

Plani i Menaxhimit të Basenit Lumor: Plani është një përmbledhje e hollësishme e mënyrës se si duhet të arrihen objektivat e vendosura për basenin e lumit (statusi ekologjik, statusi sasior, statusi kimik dhe objektivat e zonës së mbrojtur) brenda afatit kohor të kërkuar.

Statusi aktual i raportuar i transpozimit është 41%. Direktiva është transpozuar nga

kuadri ligjor i mëposhtëm: Ligji për menaxhimin e integruar të burimeve ujore dhe disa rregullore<sup>80</sup>.

### **Problemet me transpozimin:**

Problemet e mëposhtme janë vërejtur për transpozimin e kësaj Direktive.

- Megjithëse AMBU-ja ka përparim në zhvillimin e metodologjisë, e cila zbatohet në PMBL-të e lumenjve Ishëm, Erzen dhe Mat, metodologjia është aprovuar vetëm në fund të vitit 2020 nga Qeveria, për ta bërë procedurë të detyrueshme ligjore për zbatim të mëtijshëm në të shtatë basenet lumore të Shqipërisë. Në fund të vitit 2020, Plani i Menaxhimit për Drini-Bunën është aprovuar gjithashtu.
- Mungesa e Planeve të Menaxhimit në përputhje me strukturën dhe kërkesat e Direktivës. Ka përparim në zhvillimin e PMBL-ve përmes një procesi të hollësishtëm të analizave të të dhënave dhe duke përfshirë shumë nga fushat tematike të kërkuara nga Direktiva. Sidoqoftë, përcaktimi i zonave të ndjeshme brenda secilës PMBL mbetet një çështje që ndikon në mbrojtjen dhe masat e ruajtjes së tyre. Ekspertët e mjedisit dhe përfaqësuesit e OSHC-ve kanë shprehur urgjencën për krijimin e zonave të ndjeshme brenda secilit basen lumor, në mënyrë që të përcaktohen masat e ruajtjes dhe mbrojtjes për ruajtjen e natyrës, për ruajtjen e habitateve dhe për rregullimin e përdorimit të ujit.
- Instrumentet dhe Institucionet e Monitorimit të Cilësisë së Ujit duhet të sqarohen në mënyrë institucionale, duke përfshirë kapacitetet dhe burimet e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit. Një plan i monitorimit të cilësisë së ujit duhet të ekzistojë dhe të ndiqet në mënyrë rigorozë për parametrat e kërkuar.

### **Kuadri institucional**

Organet kryesore përgjegjëse për koordinimin, planifikimin, programimin, buxhetimin, financimin dhe monitorimin e çështjeve të ujit përfshijnë Këshillin Kombëtar të Ujit, Agjencinë për Menaxhimin e Burimeve Ujore (AMBU).

<sup>80</sup> Ligji Nr. 111/2012 për menaxhimin e integruar të burimeve ujore.

Ligji Nr. 6/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 111/2012 për menaxhimin e integruar të burimeve ujore.  
Rregullorja 268 datë 6.4.2016 që miraton Rregulloren për funksionimin e Këshillit Kombëtar të Ujit.  
Rregullorja Nr. 342 datë 4.5.2016 që miraton kufijtë teritorialë dhe hidrografikë të baseneve ujore në Republikën e Shqipërisë dhe selinë dhe përfaqësit e këshillave të tyre.

Rregullorja Nr. 524 datë 20.7.2016 për organizimin dhe funksionimin e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit.



Institucionet e tjera të përfshira janë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM), Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

### **Problemet me kuadrin institucional:**

Paqartësia e përgjegjësiave në lidhje me monitorimin e cilësisë së ujit: sipas ligjit AKM-ja është institucioni përgjegjës, megjithëse AMBU-ja po kërkon që të ketë përgjegjësi mbi cilësinë e ujit.

Duke marrë parasysh burimet e nevojshme për këtë proces dhe fondin aktual të alokuar, një lëvizje e tillë e Monitorimit të Cilësisë së Ujit tek AMBU-ja nuk do të garantojë as efikasitet në optimizimin e burimeve, as adresimin e problemit të monitorimit të pamjaftueshëm në planin afatshkurtër.

Këshilli i Ujit në nivelin rajonal duhet të ketë fushëveprim më të gjerë të përgjegjësiave të menaxhimit të ujit, në vend që vetëm të japë leje për përdorimin e ujit, të cilat bëhen të parregulluara për shkak të mungesës së Planeve të Menaxhimit të Baseneve Lumore. Roli aktiv duhet të konsistojë në adresimin e pikave të nxeha të ndotjes përgjatë trupave ujqorë dhe drejtimin e veprimeve në nivel vendor dhe rajonal për të parandaluar erozionin, ndotjen dhe çdo veprimtari të paligjshme që ndikon në cilësinë e ujit.

### **Statusi i zbatimit**

Në përgjithësi, ekziston gjithashtu një kapacitet i dobët administrativ për menaxhimin e ujit. **Menaxhimi i baseneve lumore** është në fazën fillestare, me autoritete të dobëta të baseneve, vetëm dy Plane ekzistuese të Menaxhimit të Basenit Lumor (për lumenjtë Seman dhe Ishëm-Ërzen) dhe tre Plane të Menaxhimit të Basenit Lumor janë në proces zhvillimi (Drini-Buna, Mati dhe Shkumbini).

Ka përparim në punën e AMBU-së, e cila po punon për hartimin e standardeve për Planet e Menaxhimit të Baseneve Lumore, sipas kërkesave të Direktivës. Faza e parë e këtyre planeve do të jetë 2022-2027, për t'u harmonizuar me fazën e dytë të zbatimit të Direktivës. Sidoqoftë, progresi i ngadaltë në zhvillimin e Planeve po dëmton disa nga lumenjtë, ku ndryshimi intensiv i habitateve po ndodh për shkak të nxjerrjes së zhavorrit dhe ndërtimit të HEC-ëve. Komuniteti i OSHC-ve mbetet i shqetësuar për mungesën e VSM-ve dhe VNM-ve të duhura të kryera për më shumë se 530 njësi të vogla hidro-energjetike të planifikuara, në ndërtim ose në veprim në të gjithë vendin.

## 98/83/KE Direktiva e Ujit të Pijshëm

### Kërkesat e Direktivës

Direktiva e ujit të pijshëm (Direktiva e Këshillit 98/83/KE e datës 3 nëntor 1998, mbi cilësinë e ujit për qëllim të konsumit nga njerëzit) ka të bëjë me cilësinë e ujit për qëllim të konsumit nga njerëzit. Qëllimi i saj është të mbrojë shëndetin e njeriut nga efektet e dëmshme nga çdo ndotje e ujit për konsum njerëzor, duke siguruar që ai të jetë i shëndetshëm dhe i pastër. Direktiva e ujit të pijshëm zbatohet për: të gjitha sistemet e shpërndarjes që shërbejnë më shumë se 50 persona ose që furnizojnë më shumë se 10 metër kub ujë në ditë, por gjithashtu edhe sistemet e shpërndarjes që shërbejnë më pak se 50 persona / që furnizojnë më pak se 10 metër kub në ditë, nëse uji furnizohet si pjesë e një aktiviteti ekonomik; ujë të pijshëm nga cistemat; ujë të pijshëm në shishe ose kontejnerë; uji i përdorur në industrinë e përpunimit të ushqimit, përveç nëse autoritetet përgjegjëse kombëtare janë të bindur se cilësia e ujit nuk mund të ndikojë në cilësinë e ushqimit, në formën e tij të fundit.

Direktiva përcakton standardet thelbësore të cilësisë në nivelin e BE-së. Gjithsej 48 parametra mikrobiologjike, kimike dhe tregues duhet të monitorohen dhe testohen rregullisht. Në përgjithësi, udhëzimet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë për ujin e pijshëm dhe mendimi i Komitetit Këshillimor Shkencor të Komisionit përdoren si bazë shkencore për standardet e cilësisë në ujin e pijshëm.

Statusi aktual i raportuar i transpozimit është 100%. Direktiva është transpozuar nga rregullorja për cilësinë e ujit të pijshëm<sup>81</sup>.

### Kuadri institucional

Organet kryesore përgjegjëse për monitorimin e ujit të pijshëm përfshijnë Ministrinë e Shëndetësisë, për vendosjen e standardeve shëndetësore; Institutin e Shëndetit Publik për monitorimin e cilësisë së ujit të pijshëm.

Institucione të tjera të përfshira janë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), për investime në furnizimin me ujë të pijshëm; Agjencia Kombëtare e Ujit të Pijshëm dhe Trajtimit të Ujërave të Zeza dhe infrastruktura e mbetjeve, për zbatimin e infrastrukturës së ujit të pijshëm.

<sup>81</sup> Rregullorja Nr. 379 datë 25.5.2016 aprovim i rregullores mbi cilësinë e ujit të pijshëm

## Statusi i zbatimit

Cilësia e ujit të pijshëm në rrjetet e furnizimit është përgjithësisht e mirë, megjithëse ekziston rreziku i ndotjes nga faktorë të ndryshëm si: gërryerje e tubacionit të amortizuar, ndërhyrje të papërshtatshme në furnizimin me ujë, presioni negativ i formuar nga ndërprerjet e furnizimit me ujë në rrjet dhe kryqëzimet e rrjetit të ujit të pijshëm me rrjetin e ujit të përdorur. Cilësia bakteriologjike e ujit, në disa pika kontrolli, nuk është gjithmonë brenda standardeve të lejuara për konsum nga njerëzit dhe të rrezikut për përhapjen e sëmundjeve që vijnë nga përdorimi i këtij uji, në disa raste. Kjo shkaktohet nga disa faktorë: -Faktorët e lidhur me vetë rrjetin e shpërndarjes. Rrjeti i furnizimit ka nevojë për plotësim me tubacione të përmasave të duhura që të sigurojnë furnizimin me ujë për popullatën. Rrjeti i brendshëm i furnizimit me ujë është më i vjetër, prandaj dëmet dhe humbjet janë të shumta. Amortizimi i linjave, periudhat pa ujë në tubacione, krijon mundësi për ndotjen e ujit të pijshëm. Gjithashtu, një fenomen tjetër që ndikon në cilësinë e ujit të pijshëm është përdorimi i rezervuarëve të ujit nga shumë qytetarë pasi rrjetet e ujit të pijshëm dhe të ujërave të zeza janë mjaft të dëmtuara.

Faktorët që lidhen me urbanizimin e paplanifikuar; Rritja e madhe demografike në qytetet e mëdha shoqërohet me urbanizim të pakontrolluar, me ndërhyrje të pastudiuara në rrjetin e shpërndarjes, dëmtim të kanalizimeve dhe të rrjetit të ujit të pijshëm. Ndërhyrjet në rrjet çojnë në rënien e presionit të ujit, dhe mos-furnizimin e mjaftueshëm me ujë për të përmbushur nevojat e qytetarëve. Gjithashtu, të gjithë këta faktorë shtojnë rrezikun e ndotjes së ujit të pijshëm, përhapjen e sëmundjeve me origjinë hidrike.

Sektorin e UK-së karakterizohet nga kapaciteti i dobët i planifikimit dhe programimit, që rezulton në një nivel të përgjithshëm të ulët të investimeve në furnizimin me ujë dhe sistemet e grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura, krahasuar me kërkesën e madhe të vlerësuar në Strategjinë e UK 2011-2017 (868 milionë EUR për investime kapitale, plus zëvendësimi i menjëhershëm i infrastrukturës me defekte). Ekziston një Kuadër Buxhetor Afatmesëm, që mbulon sektorin e përgjithshëm dhe fondet e alokuara posaçërisht për ministrinë përgjegjëse të linjës. Sidoqoftë, buxhetet për sektorin e ujit janë ose konstante ose në rënie, gjë që nuk përputhet me nevojat për kapacitetin e sektorit në funksion të reformës së ujit, duke përfshirë rritjen e performancës dhe zbatimin e kërkesave ligjore dhe përafrimin progresiv me direktivat e BE-së për ujin. Gjithashtu, financat e disponueshme nuk janë në përputhje me arritjen e synimeve të strategjive kombëtare. Në perspektivën e buxhetit afatmesëm,

një pjesë e konsiderueshme financohet përmes institucioneve financiare të huaja dhe burimeve të donatorëve.

Në lidhje me menaxhimin e shërbimeve të UK-së, vetëm 28 nga 57 ndërmarrjet e ujit të regjistruara pranë Entit Rregullator të Ujit (ERRU) ofrojnë shërbime gjithëpërfshirëse. Shumë ndërmarrje nuk janë në gjendje të mbulojnë kostot e tyre operationale (më pak se 70% të Kostove Operative Direkte (KOD) mesatarisht), edhe për shkak të tarifave të ulëta për furnizimin me ujë dhe kanalizimet, që janë në fuqi për klientët. Kjo pengon progresin drejt rikuperimit të plotë të kostove të shërbimeve të ofruara. Në nivelin e shërbimeve, kapaciteti është i ulët për sa i përket aftësive teknike dhe personelit të kualifikuar, veçanërisht në menaxhimin e përgjithshëm, funksionimin dhe mirëmbajtjen e sistemit dhe menaxhimin e qëndrueshëm të aseteve. Paqëndrueshmëria e lartë e stafit e përkeqëson problemin.

Sipas raportimit të ERRU, në të gjithë vendin për vitin 2019, shërbimet e furnizimit me ujë janë mjaft të pakompletuara, me mbulimin e furnizimit me ujë për zonat urbane dhe rurale në nivelin 77.2% dhe mbulimi me kanalizime në masën 52.9%. Ekziston një numër i madh i lidhjeve të paligjshme të ujit, nivele të ulëta të matësve të ujit (aplikohen tarifa të sheshta vazhdimisht) dhe vazhdimësia e shërbimit të furnizimit me ujë ka qenë mesatarisht në 13.2 orë në ditë në vitin 2019. Për më tepër, humbjet e ujit në sistem kanë qenë 63% dhe shkalla e grumbullimit ka qenë 79% duke mos paraqitur përmirësim të ndjeshëm përgjatë disa viteve rradhazi.

#### **Masat urgjente për zbatim:**

- Në nivel kombëtar, ekziston nevoja për të përditësuar / zgjeruar dokumentet kryesore strategjike të sektorit. Gjithashtu, ekziston nevoja për të zbatuar siç duhet Strategjinë e Integruar të Menaxhimit të Burimeve Ujore 2017-2027, si dhe për të miratuar dhe zbatuar Programin gjithëpërfshirës të Sektorit Kombëtar për Ujin, 2018-2030<sup>82</sup>.
- Nevojiten përpjekje të mëtejshme në lidhje me planifikimin dhe koordinimin e investimeve, rritjen e kapaciteteve të aktorëve kryesorë në nivelet kombëtare dhe vendore, përmirësimin e qeverisjes në të gjitha nivelet, përmirësimin e ndërmarrjeve të ujit për të kontrolluar kostot dhe për të arritur rikuperimin e plotë të kostove operationale, dhe përmirësimin e monitorimit të performancës së sektorit.

<sup>82</sup> Komisioni Europian 2016: Vendimi i zbatimit nga Komisioni, datë 13.12.2016 për miratimin e Programit të Veprimit të Vendit për Shqipërinë



- Për përmirësimin e furnizimit me ujë të pijshëm veprimi i menjëhershëm duhet të ketë lidhje me:
  - Vendosjen dhe respektimin e mbrojtjes sanitare në të gjitha burimet e përdorura për furnizimin e komuniteteve me ujë të pijshëm.
  - Vendosjen e teknologjisë moderne për klorizimin e ujit në të gjitha depot dhe rrjetin e ujësjellësit dhe mbajtja nën kontrolli e përmbajtjes së klorit në rrjetin e shpërndarjes.
  - Ndërtimi i rrjeteve për zonat rurale dhe qytetet për të mbuluar furnizimin me ujë 24 orë.
  - Monitorimi i vazhdueshëm i respektimit të standardeve të ujit të pijshëm.
- Informimi i popullatës për t'u ndier të sigurt për cilësinë e rrjetit të shpërndarjes së ujit.

### 91/271/EKE Direktiva e Trajtimit të Ujit të Ndotur Urban

Direktiva e Këshillit 91/271/EKE në lidhje me trajtimin e ujërave të ndotura urbane u miratua në 21 maj 1991. Objektivi i saj është të mbrojë mjedisin nga efektet negative të shkarkimeve të ujërave të ndotura urbane dhe shkarkimeve nga sektorë të caktuar industrialë dhe ka të bëjë me grumbullimin, trajtimin dhe shkarkimin e; ujërave të zeza shtëpiake; përzierjes së ujërave të ndotura; ujërave të ndotura nga sektorë të caktuar industrialë.

Direktiva kërkon grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura të gjeneruara në të gjitha aglomeratet me madhësi < 2000 popullsi ekuivalente (p.e.); Trajtimin sekondar të të gjitha shkarkimeve nga aglomeratet e > 2000 p.e. dhe trajtim më të thelluar për >10.000 p.e., në zona të caktuara të ndjeshme dhe pellgjet e tyre ujëmbledhëse. Mungesa e kontrollit mbi shkarkimet në ujërat e ndotura, ndikon ndjeshëm në cilësinë e trupave ujqorë. Prandaj, transpozimi dhe zbatimi i kërkesës së Direktivës për autorizimin e hershëm (paraprak) të të gjitha shkarkimeve të ujërave të zeza urbane, të shkarkimeve nga industria e përpunimit të ushqimit dhe të shkarkimeve industriale në sistemet e grumbullimit të ujërave të ndotura urbane, është një masë mjaft urgjente.

Megjithatë masat e zbatimit përmes investimeve kapitale janë thelbësore, kështu mbeten të rëndësishëm edhe monitorimi i performancës së impianteve të trajtimit dhe grumbullimit të ujërave; dhe kontrolli i asgjësimit dhe ripërdorimit të llumrave të ujërave të zeza, dhe ripërdorimi i ujërave të ndotura të trajtuara sa herë që është e përshtatshme.

Statusi aktual i raportuar i transpozimit është 66% dhe Direktiva transpozohet dhe zbatohet përmes Ligjit për Trajtimin Mjedisor të Ujërave të Ndotura dhe disa VKM-ve <sup>83</sup>.

### Kuadri institucional

Institucioni kryesor përgjegjës për trajtimin e ujërave të ndotura përfshin Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), për zhvillimin e politikave dhe investimet në trajtimin e ujërave të ndotura.

Institucione të tjera të përfshira janë Agjencia Kombëtare e Ujësllës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve; Instituti i Shëndetit Publik; Inspektorati Kombëtar i Shëndetësisë; Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

### Statusi i implementimit

Në fushën e Ujësllësit dhe Kanalizimeve (UK), sektori karakterizohet nga **një kapacitet i dobët planifikues dhe programues** duke rezultuar në një nivel të përgjithshëm të ulët investimesh në furnizimin me ujë dhe në sistemet e grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura, krahasuar me kërkesën e madhe të vlerësuar në Strategjinë e UK 2011-2017 (868 milion EUR për investime kapitale, plus zëvendësim të menjëhershëm të infrastrukturës me defekte).

Shërbimet e menaxhimit të ujërave të ndotura janë gjithashtu jo të përshtatshme. Mbulimi i kanalizimeve në zonat urbane ishte 50,2% në vitin 2017 (75,4% për zonat urbane dhe 12,2% për zonat rurale) dhe janë ndërtuar vetëm 8 impiante të trajtimit të ujërave të zeza, nga të cilat shtatë janë operacionale, duke shërbyer vetëm rreth 13% të popullsisë. Katër impiante të trajtimit të ujërave të zeza janë në ndërtim e sipër dhe / ose po rehabilitohen ose zgjerohen.

Në nivel kombëtar, ekziston nevoja për të përditësuar / zgjeruar dokumentet kryesore strategjike të sektorit, siç janë Strategjia e Ujësllësave dhe Kanalizimeve, 2011-2017

<sup>83</sup> Ligji Nr. 9115, datë 24.07.2003 për "Trajtimin mjedisor të Ujërave të Ndotura", i ndryshuar;

Ligji Nr. 111, datë 15.12.2012 për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore", i ndryshuar;

VKM Nr. 127, datë 11.02.2015 për Kërkesat për ripërdorimin e Ujërave të Ndotura në bujqësi";

VKM Nr. 177, datë 31.03.2005 mbi "Kufijtë e Shkarkimit të Ujërave të Ndotura dhe Kriteret e Lokalizimit të Zonave të Ndëshme".

dhe Master Plani për Kanalizimet dhe Ujërat e Ndotura, 2013. Ekziston gjithashtu një nevojë për të zbatuar si duhet Strategjinë e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore, 2017-2027, si dhe për të miratuar dhe zbatuar Programin gjithëpërfshirës të Sektorit Kombëtar për Ujin 2018-2030. Në nivelin rregullator, ekziston nevoja për të harmonizuar më tej ligjet dhe rregulloret me legjislacionin e BE-së në lidhje me Direktivat e Trajtimit të Ujërave të Zeza Urbane, të Ujit të Pijshëm dhe të Ujërave nëntokësore. Sektori gjithashtu duhet të përmirësojë planifikimin dhe programimin e infrastrukturës, si në nivelin kombëtar ashtu edhe në atë vendor, për infrastrukturën UK dhe të përshpejtojë zhvillimin dhe zbatimin në të ardhmen të planeve të menaxhimit të baseneve lumore, së bashku me organet funksionale të zbatimit.

#### **Masat urgjente për zbatim:**

- Zhvillimi i standardeve dhe metodologjisë për grupimin e vendbanimeve, duke synuar kalimin në vendosjen e strategjive të qarta për alternativat e trajtimit të mbetjeve.
- Shpërndarje urgjente e fondeve për objektet e reja në qytetet më të mëdha, të cilët shkarkojnë mbetje të patrajtuara në lumenj dhe liqene.
- Monitorimi dhe hartimi i standardeve për trajtimin, asgjësimin ose ripërdorimin e llumrave.
- Mbështetje financiare dhe me burime të kualifikuara njerëzore për impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura, me qëllim monitorimin e vazhdueshëm dhe garantimin e trajtimit cilësor të ujërave që shkarkohen në trupat ujorë dhe ekosistemet natyrore.
- Vlerësimi i kostove të infrastrukturës të trajtimit të ujërave të ndotura urbane dhe planifikimi i investimeve në kohë dhe në bazë të fondeve.

### **2006/7/KE Ujërat e larjes**

Kjo Direktivë përcakton dispozitat për monitorimin dhe klasifikimin e cilësisë së ujit të larjes; menaxhimin e cilësisë së këtyre ujërave; dhe sigurimin e informacionit për publikun mbi cilësinë e tyre.

Direktiva do të zbatohet për çdo element të ujërave sipërfaqësore, ku autoriteti përgjegjës pret që një numër i madh njerëzish ta përdorin për t'u larë dhe nuk ka vendosur një ndalim të përhershëm të larjes ose lëshuar këshilla të përhershme kundër

larjes (këtu e tutje ujërat e larjes). Ai nuk zbatohet për pishinat, ujërat e mbyllura që i nënshtrohen trajtimit ose përdoren për qëllime terapeutike dhe ujërat e mbyllur të krijuar artificialisht nga ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore.

Statusi aktual i raportuar i transpozimit është 100%.

### **Kuadri institucional**

Institucioni kryesor përgjegjës për trajtimin e ujërave të larjes përfshin Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Institutin e Shëndetit Publik.

### **Statusi i zbatimit**

Në vitin 2019, Shqipëria raportoi 119 stacione ose afërsisht 0,5% të të gjitha stacioneve të plazheve në Europë. Prej tyre, 111 janë në zonën bregdetare dhe 8 në ujërat tokësore, kryesisht liqeni i Ohrit në Pogradec. Cilësia matet në dy parametra mikrobiologjikë (*Escherichia coli* dhe *Enterococcus*) sipas Direktivës së Ujërave të Larjes. AKM-ja raporton përmirësim të cilësisë së ujërave të larjes, megjithatë çështjet që lidhen me ndotjen vazhdojnë. Ka zona bregdetare problematike, ku uji i patrajtuar urban shkarkohet nga hidrocentralet. Në qershor të vitit 2020, Agjencia Europiane e Mjedisit dhe Komisioni Europian publikuan vlerësimin europian të cilësisë së ujit të plazheve. Shqipëria renditet në fund me 58,8% të ujërave me cilësi të shkëlqyeshme. Duke marrë parasysh Raportin e Gjendjes së Mjedisit 2019, të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, cilësia e zonave të larjes mbetet një shqetësim midis komuniteteve. Monitorimi nuk është i vazhdueshëm dhe nuk pasqyron realitetin, thonë shumë aktivistë të OSHC-ve për gjirin e Vlorës, Shëngjinit, Durrësit, etj.

### **Masat urgjente për zbatim:**

- Përmirësimi i sistemit të monitorimit për mbulimin e gjithë sezonit të plazhit në baza mujore në të gjitha stacionet.
- Rritja e burimeve financiare dhe njerëzore për monitorimin (marrjen e mostrave) në përputhje me kërkesat e Direktivës.

Disa Direktiva të këtij nën-kapitulli nuk janë transpozuar ende. Deri më sot, puna për transpozimin dhe zbatimin nuk ka filluar fare në direktivat e mëposhtme.



## 2008/56/KE Strategjia Detare

Statusi aktual i raportuar i transpozimit është 0%.

### **Kuadri institucional**

Institucionet kryesore përgjegjëse për Strategjinë Detare nuk janë sqaruar, por ato përfshijnë AMBU-në dhe Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit. Institucione të tjera të përfshira janë Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura; Agjencia Kombëtare e Zonave Bregdetare

### **Masat urgjente për zbatim:**

Ndër masat më prioritare është hartimi i Planit Hapësinor Detar.

## 2006/118/KE Ujërat nëntokësorë

Statusi aktual i raportuar i transpozimit është 0%.

### **Kuadri institucional**

Institucioni kryesor përgjegjës për ujërat nëntokësore përfshin Agjencinë për Menaxhimin e Burimeve Ujore. Institucione të tjera të përfshira janë Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH).

### **Masat urgjente për zbatim:**

Masa urgjente për transpozim me ligj specifik dhe përfshirjen e SHGJSH në monitorim

## 2007/60/KE Përmbytjet

Statusi aktual i raportuar i transpozimit është 10%.

### **Kuadri institucional**

Institucioni kryesor përgjegjës për trajtimin e ujërave të larjes përfshin Ministrinë e Mbrojtjes; Ministria e Bujqësisë dhe Mbrojtjes së Konsumatorit. Institucion tjetër i përfshirë është Agjencia për Mbrojtjen Qytetare.

### **Masat urgjente për zbatim:**

Masa urgjente të transpozimit, për shkak të nevojës prioritare që ka vendi, ngaqë shumë zona janë të prirura ndaj përmbytjeve për shkak të ndryshimit të klimës dhe ndryshimit të terrenit.

# 4 RUAJTJA E NATYRES



## 4.1 HYRJE

Shqipëria konsiderohet si një zonë e rëndësishme e biodiversitetit në Europë. Sidoqoftë, një biodiversitet i tillë, i jashtëzakonshëm, dhe burimet e çmuara natyrore po përballen me sfida të vështira. Ashtu si vendet e tjera në zhvillim, Shqipëria po përballlet me një zhvillim të shpejtë. Rrugë dhe infrastruktura të reja, diga, hidrocentrale, rezervuarë naftë dhe infrastrukturë masive e turizmit kanë për qëllim të rrisin ekonominë e vendit, teksa paraqesin një kërcënim serioz për ruajtjen e mjedisit.

Gjatë dekadave të fundit, Shqipëria ka bërë disa përparime drejt politikave për zhvillimin e mjedisit, duke përfshirë ruajtjen e natyrës. Në janar të vitit 2016, vendi ka miratuar Dokumentin e Politikave Kombëtare të Biodiversitetit, të përditësuar dhe një Plan Veprimi për periudhën 2015-2020, duke identifikuar qartë fushat kryesore të punës, të cilat ndër të tjera përfshijnë:

- Rritjen e mbulimit të Zonave të Mbrojtura (ZM) deri në 20% në ZM tokësore dhe 10% në ZM në zonat ujore (detare dhe në ujëra të ëmbla).
- Përgatitjen e kuadrit ligjor në linjë me legjislacionin e BE-së për natyrën dhe mjedisin, në përputhje me Direktivat e Shpendëve dhe Habiteteve.
- Forcimi i zbatueshmërisë së ligjit me anë të përmirësimit të kuadrit ligjor dhe ngritjes së kapaciteteve institucionale.

Të gjitha këto çështje përfshihen edhe në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim për periudhën 2014-2020. Duke synuar anëtarësimin në BE, Shqipëria po punon për të vënë në linjë përpjekjet e saj për ruajtjen e natyrës me kërkesat e BE-së, veçanërisht duke siguruar zbatimin e Direktivave të Shpendëve dhe Habiteteve.

Raporti i fundit nga Komisioni European mbi progresin e Shqipërisë në procesin e anëtarësimit në Bashkimin European konstaton se përafrimi me legjislacionin në fushën e ruajtjes së natyrës, në veçanti të Direktivave të Habiteteve dhe Shpendëve, ka përparuar mjaft mirë. Por Ligji i Investimeve Strategjike (2016) përbën shkak për shqetësime në lidhje me ruajtjen e biodiversitetit, pasi ai lejon investime të mëdha turistike dhe industriale në zona të mbrojtura, në kundërshtim me ligjet ekzistuese kombëtare dhe konventat ndërkombëtare për ruajtjen e biodiversitetit që Shqipëria ka ratifikuar.

Për më tepër, raporti i progresit vëren se zbatimi i ligjeve duhet të garantohet në rast të krimeve mjedisore (p.sh., shpyllëzimi dhe prerja e pyjeve) dhe fajtorët duhet të ndiqen penalisht. Investimet në hidrocentrale duhet të jenë në përputhje me detyrimet kombëtare dhe ndërkombëtare të ruajtjes së natyrës dhe administrimit të ujërave, të sigurojnë pjesëmarrjen dhe konsultimin me publikun, dhe të garantojnë raporte të VNM-ve me cilësi të lartë që përfshijnë vlerësime të ndikimit në natyrë dhe biodiversitet. Sa i përket institucioneve përkatëse për ruajtjen e natyrës, raporti i progresit thekson se kapacitetet dhe instrumentet financiare për Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura mbeten shumë të kufizuara.

Pjesë e Kapitullit 27: mjedisi dhe ndryshimet klimatike, nën-kapitulli mbi ruajtjen e natyrës përfshin 10 direktiva/rregullore të BE-së, të cilat kanë si synim të përbashkët mbrojtjen e vlerave natyrore. Sidoqoftë, fusha specifike e secilës direktivë/rregullore ndryshon nga ruajtja e habitateve dhe llojeve në përgjithësi, tek mbrojtja e elementeve specifike të biodiversitetit.



## 4.2. VLERËSIM I SHPEJTË I PROGRESIT

Tabela e mëposhtme jep një përmbledhje të progresit të deritanishëm (dhjetor 2020) mbi nivelin e transpozimit dhe zbatimit, si dhe zhvillimit të kuadrit institucional të lidhura me direktivat dhe rregulloret brenda nënkapitullit të Mbrojtjes së Natyrës të Kapitullit 27: Mjedisit dhe ndryshimet klimatike, të procesit të negociatave të aderimit në BE.































Direktiva/ rregullorja	Niveli i transpozimit	Kuadri institucional	Niveli i zbatimit	Të vlerësuara në këtë raport
2009/147/EKE Shpendët e egër				Po
92/43/EKE Habitatet				Po
1999/22/KE Kopshtet zoologjike				Po
EKE/3254/91 Çarqet e leqet				Jo
KE/338/97 Konventa CITES				Jo
2173/2005 FLEGT				Jo
995/2010 EUTR				Jo
Rregullorja 511/2014 ABS				Jo
Rregullorja 1007/2009 Produktet e fokave				Po
Direktiva 83/129 Lëkurat e fokave				Po

Tabela 7: Vlerësim i shpejtë i Natyrës

Vlerësimi i përgjithshëm tregon se ka progres të konsiderueshëm në transpozimin e Direktivave të Shpendëve dhe Habitateteve, ndërsa ka pak ose aspak progres në transpozimin e direktivave dhe rregulloreve të tjera brenda nënkapitullit të natyrës. Në përgjithësi, institucionet përkatëse janë ngritur, por kapacitetet e tyre janë të dobëta si në numër ashtu edhe në aftësitë e nevojshme për zbatimin e direktivave dhe rregulloreve të BE-së. Veçanërisht kapacitetet në lidhje me monitorimin, forcimin

e ligjit dhe zbatimin e masave të mbrojtjes duhet të zhvillohen më tej. Zbatimi është kryesisht në një fazë fillestare. Sidoqoftë, zbatimi i duhur kërkon transpozimin e plotë të kërkesave të katër direktivave dhe rregulloreve në legjislacionin kombëtar.

## 4.3. VLERËSIM I HOLLËSISHËM I NËNKAPITULLIT - PROGRESI I DERITANISHËM

Duke marrë parasysh burimet e kufizuara njerëzore në dispozicion dhe sasinë e konsiderueshme të informacionit që duhet grumbulluar dhe analizuar, ky raport i parë përqendrohet vetëm në vlerësimin e nivelit të transpozimit dhe zbatimit të direktivave të nën-kapitullit të ruajtjes së natyrës për Kapitullin 27. Nën-kapitulli për ruajtjen e natyrës përfshin katër direktiva si më poshtë:

- 2009/147/EKE **Shpendët e Egër**: Direktiva 2009/147/KE e Parlamentit Europian dhe Këshillit të datës 30 Nëntor 2009 mbi ruajtjen e shpendëve të egër
- 92/43/EKE **Habitatet**: Direktiva e Këshillit 92/43/EKE më 21 Maj 1992 mbi ruajtjen e habitateve natyrore dhe florës dhe faunës së egër,
- 1999/22/KE **Kopshtet Zoologjike**: Direktiva e Këshillit 1999/22/KE më 29 Mars 1999 që ka të bëjë me mbajtjen e kafshëve të egra në kopshte zoologjike.
- 83/129/EKE **Të vegjëlit e fokave**: Direktiva 83/129/EKE që lidhet me importimin e lëkurave të disa të vegjëlve të fokave.
- 1007/2009 **Produkte nga fokat**: Rregullore (KE) Nr. 1007/2009 mbi tregtinë e produkteve nga fokat dhe Rregullore 2015/1850 të 13 tetorit 2015 që përcakton rregullat e hollësishme për zbatimin e Rregullores (KE) Nr. 1007/2009 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit mbi tregtinë e produkteve nga fokat.

Duke marrë parasysh që rregullorja për produktet nga fokat ka të njëjtin qëllim dhe kërkon një kuadër të ngjashëm ligjor dhe institucional, niveli i saj i transpozimit dhe zbatimit vlerësohet së bashku me direktivën për të vegjëlit e fokave.

Më poshtë është një analizë më e detajuar e statusit të transpozimit dhe zbatimit të katër direktivave dhe një rregulloreje për nën-kapitullin e ruajtjes së natyrës të Kapitullit 27: Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike.

Për secilën direktivë / rregullore, analiza ofron një shpjegim të kërkesave kryesore, statusin e transpozimit dhe zbatimit, kapacitetet institucionale dhe identifikimin e boshllëqeve kryesore për të arritur zbatimin e plotë. Analiza përfshin disa komente dhe rekomandime specifike mbi rolin dhe pozicionin e Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC) në mbështetjen e zbatimit të plotë të këtyre direktivave.

Duke marrë parasysh që disa direktiva dhe / ose rregullore janë të ngjashme përsa i përket fushëveprimit dhe zbatimit, ato janë analizuar në grupe, si për shembull Direktivat e Shpendëve të Egër dhe Habitaveve ose Rregullore dhe Direktiva e Lëkurës së Fokave dhe të vegjëleve të tyre.

## Direktiva e Shpendëve të Egër dhe Habitaveve



Direktivat për Shpendët e Egër dhe Habitatet janë thelbi i përpjekjeve europiane për ruajtjen e natyrës. Këto direktiva shumë të rëndësishme rregullojnë mbrojtjen e llojeve dhe habitateve përmes krijimit dhe menaxhimit të duhur të një rrjeti të zonave të përcaktuara për ruajtjen e habitateve dhe llojeve të rëndësishme, të njohur si rrjeti Natura 2000.

Direktiva e Habitaveve kërkon përcaktimin e Zonave të Veçanta të Ruajtjes (ZVR) që përfshijnë zonat e habitateve natyrore (Shtojca I) dhe habitatet e llojeve (Shtojca II), për të kontribuar në krijimin e Natura 2000 (rrjeti ekologjik europian). Lista e zonave që duhen ruajtur përgatitet duke marrë parasysh rezultatet e monitorimit. Prioritetet në përcaktimin e ZVR-ve duhet të përcaktohen në përputhje me rëndësinë e zonës për mirëmbajtjen ose restaurimin e habitateve dhe/ose llojeve, në koherencë me Natura 2000 dhe kërcënimet e degradimit / shkatërrimit. Nevojitet që Shtetet Anëtare të vendosin masat e nevojshme të ruajtjes për ZVR-të, duke përfshirë, kur është e nevojshme, planet e duhura të menaxhimit dhe masat e duhura ligjore, dhe administrative. Duhet të ndërmerren hapat e duhur për të shmangur përkeqësimin dhe/ose shqetësimin e habitateve natyrore dhe habitateve të llojeve në ZVR. Çdo plan ose projekt që nuk është i lidhur drejtpërdrejt ose i nevojshëm për menaxhimin e zonës, por ka të ngjarë të ketë një efekt të rëndësishëm në atë zonë, duhet t'i nënshtrohet një vlerësimi të duhur të implikimeve të tij për ruajtjen e zonës.

Direktiva e Shpendëve të Egër kërkon ruajtjen e shpendëve të egër përfshirë zogjtë, vezët e tyre, foletë dhe habitatat, në vendet anëtare të BE-së, nga aktivitetet e dëmshme njerëzore duke përfshirë shkatërrimin dhe ndotjen e habitateve, kapjen e paligjshme, vrasjen dhe tregtimin e shpendëve të egër. Direktiva synon mbrojtjen dhe menaxhimin afatgjatë të burimeve natyrore, ruajtjen, mirëmbajtjen ose restaurimin, në nivel të mjaftueshëm të larmisë dhe zonave të habitateve si thelbësore për ruajtjen e të gjitha llojeve të shpendëve. Disa lloje shpendësh kanë nevojë për masa të veçanta ruajtjeje në lidhje me habitatat e tyre për të siguruar mbijetesën dhe riprodhimin e tyre në zonën e shpërndarjes. Përveç kësaj, lloje të caktuara të shpendëve të egër mund të gjuhen në nivele të pranueshme shfrytëzimi, kur kjo është në përputhje me mirëmbajtjen e popullatës së atyre llojeve në nivele të kënaqshme.

Duhet të ndërmerret një mbikëqyrje e statusit të ruajtjes së habitateve natyrore dhe llojeve, veçanërisht mbi habitatat dhe llojet prioritare. Shtetet anëtare duhet të nxisin kërkimin e nevojshëm dhe punën shkencore për të arritur objektivat e Direktivave. Gjithashtu, Shtetet Anëtare duhet të promovojnë edukimin dhe informacionin e përgjithshëm mbi nevojën për të mbrojtur llojet e faunës dhe florës së egër dhe për të ruajtur habitatat e tyre.

### Statusi i transpozimit

Transpozimi i direktivave të Habitave dhe Shpendëve është në një fazë të mirë. Direktiva e Habitave është në një nivel të përparuar të transpozimit me disa ligje që transpozojnë shumicën e kërkesave.

Për të përfunduar transpozimin e kërkesave të Direktivës së Habitave, legjislativi duhet të zhvillohet për të siguruar vlerësimin e duhur të çdo plani dhe/ose projekti që mund të ketë një efekt të rëndësishëm në zonat e ruajtjes, dhe duhet të merren të gjitha masat e nevojshme kompensuese për të siguruar koherencën e përgjithshme të rregullit Natura 2000. Për më tepër, legjislativi duhet të zhvillohet për të siguruar që nuk merren masa që përkeqësojnë zonat e ruajtjes dhe për të nxitur menaxhimin e tipareve të peizazhit me rëndësi të madhe për faunën dhe florën e egër (ato që janë thelbësore për migrimin, shpërndarjen dhe shkëmbimin gjenetik të llojeve të egra).

Sa i përket Direktivës së Shpendëve, transpozimi duhet të plotësohet në lidhje me masat e nevojshme për të ruajtur popullatën e llojeve dhe habitatat e tyre në një nivel



që korrespondon me kërkesat ekologjike, shkencore dhe kulturore dhe për të ruajtur, mirëmbajtur ose rivendosur larmi dhe zona të mjaftueshme për të gjitha llojet e shpendëve të përmendur në Nenin 1.

Megjithëse një moratorium i gjuetisë është ende në fuqi në Shqipëri (moratoriumi përfundon në vitin 2021), është e nevojshme të zhvillohet një legjislacion i ri për të siguruar që praktika e gjuetisë (kur dhe ku lejohet ligjërisht) të jetë në përputhje me parimet e përdorimit të qëndrueshëm dhe kontrollit të ekuilibruar ekologjikisht të llojeve të shpendëve në fjalë dhe se kjo praktikë është në përputhje me qëllimet e mirëmbajtjes së popullatës së këtyre llojeve, në veçanti atyre migratore, me masat që rezultojnë nga Neni 2.

### Kuadri institucional

Institucioni kryesor përgjegjës për zbatimin e Direktivave të Shpendëve dhe Habitaveve është Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM), më përkatësisht Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Mjedisore - Drejtoria e Politikave dhe Strategjive Mjedisore. Sidoqoftë, institucionet e tjera përkatëse të MTM-së kanë një rol të rëndësishëm në zbatimin e tyre si:

- Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura e cila ka përgjegjësinë e menaxhimit të zonave të mbrojtura në Shqipëri.
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit që është institucioni kryesor përgjegjës për monitorimin e biodiversitetit dhe vlerësimin dhe licensimin e aktiviteteve që ndodhin në zona natyrore dhe/ose ndikojnë në vlerat e biodiversitetit.
- Inspektorati Shtetëror për Mbrojtjen e Territorit që është përgjegjës për mbikëqyrjen, inspektimin dhe zbatimin në përgjithësi të ligjit për çështje që lidhen me ruajtjen e natyrës.

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM) konsiderohet si institucioni më i rëndësishëm për zbatimin e kërkesave të Direktivave të Shpendëve dhe Habitaveve. AKZM ka 274 punonjës, nga të cilët 24 janë të vendosur në selinë qendrore në Tiranë dhe pjesa tjetër është e organizuar në 12 drejtori rajonale. Çdo Administratë Rajonale e Zonave të Mbrojtura (AdZM) ka një seksion monitorimi dhe menaxhimi me një numër të ndryshëm specialistësh. Numri i përgjithshëm përfshin 108 rojtarë (rangers), të cilët janë të shpërndarë nëpër ZM dhe janë drejtpërdrejt përgjegjës për monitorimin dhe mbikëqyrjen e zonës së tyre.

Vlerësimet e mëparshme mbi kapacitetet e stafit të AKZM-së kanë treguar disa probleme të rëndësishme. Selia qendrore ka personel të kufizuar, të specializuar në fushën e biologjisë / ruajtjes së mjedisit, të aftë për të adresuar në mënyrën e duhur çështjet në lidhje me monitorimin e biodiversitetit dhe zbatimin e masave të ruajtjes së habitateve dhe llojeve. Mosha mesatare e stafit është afro 50 vjeç. Në shumicën e rasteve, stafi ka një përvojë të përgjithshme mbi 15 vjeçare, por kanë mesatarisht vetëm 5 vite që punojnë me zonat e mbrojtura. Shumica e personelit janë caktuar në zonat e mbrojtura në vitin 2015, duke ardhur kryesisht nga një përvojë me punën për pyjet. Për sa i përket formimit dhe arsimit, shumica e drejtuesve kanë një diplomë universitare, kryesisht në pylltari. Rojtarët në përgjithësi kanë një nivel arsimor të shkollës së mesme. Numri i rojtarëve në secilën Zonë të Mbrojtur është mjaft i kufizuar dhe ata duhet të përshkojnë distanca mjaft të gjata për të arritur dhe për të mbuluar Zonën e Mbrojtur. Situata është e ngjashme me kapacitetet e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit. AKM-ja është ligjërisht e ngarkuar për drejtimin dhe mbikëqyrjen e monitorimit të biodiversitetit në Shqipëri në bashkëpunim të ngushtë me institucionet akademike dhe qendrat kërkimore. Sidoqoftë, AKM-ja ka dështuar të përfundojë programet e monitorimit të biodiversitetit në vitet e fundit për shkak të mungesës së kapaciteteve. Krijimi i Agjencisë së re Kombëtare të Pyjeve ka shteruar më tej kapacitetet e AKM-së për monitorimin e biodiversitetit, duke qenë se disa prej pjesëtarëve të personelit janë transferuar në agjencinë e re. Nuk është ende e qartë se cilat do të jenë përgjegjësitë e agjencisë së re pyjore në drejtim të monitorimit të biodiversitetit.

Përgjegjësitë për zbatimin e ligjit për çështjet e mbrojtjes së natyrës kanë qenë kryesisht nën Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit. Kohët e fundit (2020), kjo strukturë u reformua dhe u transferua në Inspektoratin Shtetëror për Mbrojtjen e Territorit, pjesë e Policisë së Shtetit, nën Ministrinë e Brendshme. Inspektorati ka vuajtur në mënyrë kronike nga numri i kufizuar i stafit dhe kapacitetet e papërshtatshme për të përpunuar dhe ndjekur siç duhet krimet dhe shkeljet në lidhje me mbrojtjen e natyrës. Ka raportime për korrupsion midis personelit të inspektoratit. Në përgjithësi, ka pak interes nga sistemi gjyqësor për të ndjekur penalisht çështjet në lidhje me mbrojtjen e natyrës.

Me një vlerësim të përgjithshëm, përfundimi është se institucionet përkatëse janë ngritur, por kapacitetet e tyre janë të dobëta si në numër ashtu edhe në aftësitë e kërkuara për zbatimin e direktivave dhe rregulloreve të BE-së. Veçanërisht kapacitetet në lidhje me monitorimin, zbatimin e ligjit dhe zbatimin e masave të ruajtjes duhet të zhvillohen më tej.

Zbatimi i këtyre direktivave kërkon bashkëpunim të ngushtë me akademinë/universitetet dhe organizatat e shoqërisë civile. Duhet të zhvillohen mekanizmat e duhur për të garantuar përfshirjen e tyre dhe kontributin shkencor në procesin e zbatimit.

Deri më tani, aktivitetet për ruajtjen e natyrës financohen kryesisht nga kontributet e donatorëve dhe ka shumë të ngjarë që ky do të jetë burimi kryesor i financimit për të mbështetur masat e ruajtjes së natyrës edhe në të ardhmen. Sidoqoftë, është e rëndësishme që përqindja e mbështetjes financiare nga buxheti i shtetit të rritet ndjeshëm për të siguruar forcimin e strukturës institucionale për ruajtjen e natyrës, duke siguruar fonde të përshtatshme për stafin dhe zbatimin e vazhdueshëm të aktiviteteve të ngritjes të kapaciteteve. Financimi shtesë qeveritar duhet të rrisë aftësinë e institucioneve qeveritare për të përthithur mbështetjen ndërkombëtare të donatorëve dhe një pjesë e tij, në madhësinë e nevojshme, të përdoret në ruajtjen e natyrës, duke plotësuar kushtet e bashkëfinansimit për projekte të ndryshme.

### **Statusi i zbatimit, boshllëqet e identifikuar dhe veprimet.**

Zbatimi i duhur i Direktivave të Shpendëve dhe Habitaveve kërkon fillimisht transpozimin e plotë të kërkesave të tyre në legjislacionin kombëtar.

Lista e habitaveve dhe llojeve me interes të Komunitetit që ndodhen në Shqipëri është miratuar, edhe pse ekspertët mendojnë se mund të përmirësohet. Për më tepër, ekspertët kanë identifikuar disa korrigjime/shtesa në listën e llojeve dhe habitaveve me interes të komunitetit në Shqipëri, por lista e llojeve dhe habitaveve në anekse nuk është ende e plotë për zbatimin e duhur të Direktivave. Është e nevojshme të mbështetet hulumtimi i mëtejshëm për plotësimin e listës si dhe të kryhen konsultime me ekspertët e interpretimit të habitaveve Natura 2000.

Ka informacion të kufizuar mbi popullatat e llojeve të shpendëve të pranishëm në Shqipëri. Përpjekje të mëtejshme duhet t'i kushtohen inventarizimit dhe monitorimit të llojeve të shpendëve. Nuk ka një vlerësim të plotë të llojeve të shpendëve të Aneksit I (Direktiva e Shpendëve) dhe llojeve migratore që gjenden rregullisht në Shqipëri.

Lista paraprake e Zonave me Interes të Komunitetit e zhvilluar nga projekti NaturAL përfshin 44 zona që mbulojnë zonat ekzistuese të mbrojtura si dhe zonat që nuk janë ende nën mbrojtje.



Lista është e bazuar në rjetin Emerald, njohuritë e ekspertëve dhe të dhëna të kufizuara ekzistuese. Lista përfshin të gjitha zonat e njohura ndërkombëtarisht (zona Ramsar, Zonat e Trashëgimisë Botërore, Rezervat e Biosferës, IBA) në Shqipëri. Disa nga zonat janë tashmë pjesë e zonave të mbrojtura. Sidoqoftë, jo të gjitha ZRK-të e propozuara janë të përcaktuara mirë për sa i përket kufijve, pasi kërkohet një hartëzim më i hollësishëm i habitateve brenda zonave. Përcaktimi i duhur i kufijve të ZRK-ve të propozuara kërkon që ekspertët kombëtarë (kryesisht nga universitetet) të angazhohen në aktivitetet e hartëzimit së habitateve dhe zonave të shpërndarjes së llojeve në secilën nga zonat e propozuara. Ka vetëm dy zona në listën e propozuar që mbulojnë zonën detare, megjithëse Shqipëria ka një vijë bregdetare të rëndësishme dhe viera të rëndësishme të biodiversitetit detar. Asnjë nga zonat e propozuara nuk është shpallur ende si zonë e Natura 2000.

Hartat e detajuara të habitateve që mbulojnë të gjithë vendin mungojnë. Njohuritë rreth zonave të shpërndarjes së llojeve (të cilat mund të kërkojnë përcaktimin e zonës) janë të kufizuara dhe/ose të shpërndara. Hendeku i njohurive është më i madh për biodiversitetin detar. Jorruazorët janë grupi më pak i njohur i llojeve me hendekun më të madh të të dhënave për praninë dhe/ose shpërndarjen e tyre. Duhet të ndërmerret një fushatë e gjerë për mbledhjen e të dhënave për të përmirësuar njohuritë mbi habitatet dhe shpërndarjen e llojeve në të gjithë vendin.

Nuk ka masa specifike për të siguruar që popullatat e shpendëve të mirëmbahen në nivele të përshtatshme, si brenda dhe jashtë ZM-ve. Është e nevojshme të zhvillohet plani

i menaxhimit të zonave/habitatave dhe / ose planet e veprimit specifik për ruajtjen e llojeve që përcaktojnë masat mbrojtëse dhe listën e masave të duhura të ruajtjes. Është gjithashtu e rëndësishme të mbështetet zbatimin e masave të tilla në zona të përzgjedhura. Ende nuk ka një sistem për monitorimin e statusit të ruajtjes së habitateve dhe llojeve.

### **Rast studimor: Fushata kundër planeve të zhvillimit në Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta**

Fushata kundër planeve të zhvillimit në Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta është me siguri beteja më e shkëlqyer dhe e suksesshme e organizatave të shoqërisë civile që synojnë të ruajnë bastionin e pasur dhe të larmishëm të biodiversitetit të Shqipërisë nga zhvillimi i paqëndrueshëm turistik.

Një numër i madh i OShC-ve formuan një koalicion jozyrtar për të mbrojtur Divjakë-Karavastanë. Koalicioni i madh i OJO-ve bashkoi të gjitha pikat e forta dhe ndërtoi sinerji me organizata të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare, duke e bërë kauzën më të fortë.

Të qenit krijues, i dukshëm, me zë të lartë, i hapur në media dhe shumë aktiv në rrjetet sociale duke synuar institucione të larta vendimmarrëse, të qenit i përqëndruar dhe ofrimi i argumenteve të forta ishin të gjithë faktorë që kontribuan në bindjen e qeverisë për të ndaluar zhvillimin e planifikuar.



Programi kombëtar i monitorimit të biodiversitetit nuk zbatohet rregullisht dhe nuk është në përputhje me nevojat reale të habitateve dhe kërkesave të monitorimit të llojeve. Ka pak studime, kryesisht të mbështetura nga donatorët, që kanë analizuar statusin e disa habitateve ose llojeve. Prandaj, është e nevojshme të zhvillohet një sistem i përshtatshëm monitorimi për statusin e ruajtjes së habitateve dhe llojeve. Është e nevojshme të forcohen kapacitetet e institucioneve përkatëse (AKZM, AKM) për të zbatuar sistemin e duhur të monitorimit dhe mbledhjes së të dhënave dhe për të siguruar raportimin e duhur.

Financimi për masat e ruajtjes, nga buxheti i shtetit është mjaft i kufizuar. Është e nevojshme të eksploroohen mundësitë dhe të zhvillohen mekanizma gjenerues fondesh për të mbështetur zbatimin e masave të ruajtjes në të gjitha zonat.

Dispozitat ligjore për krijimin e një sistemi të rreptë mbrojtjeje për llojet janë në fuqi, por zbatimi është i dobët për shkak të kapaciteteve të kufizuara. Është e nevojshme të forcohen kapacitetet e autoriteteve të mbikëqyrjes dhe zbatimit (AKZM & IKMT) për të zbatuar një sistem të rreptë të mbrojtjes. Bashkëpunimi dhe koordinimi me sistemin gjyqësor do të ndihmonte në ngritjen e nivelit të vëmendjes që i kushtohet ndjekjes penale të krimeve mjedisore.

Dispozitat ligjore për VNM-të kërkojnë konsultime publike. Sidoqoftë, proceset e konsultimit publik kryhen kryesisht formalisht, pa ofruar informacione reale dhe pa mbledhur reagime nga të gjithë palët e interesuara, veçanërisht komunitetet vendore dhe/ose grupet e përdoruesve të burimeve të natyrore. Është e nevojshme të eksploroohen metodologjitë ekzistuese dhe të miratohen dhe promovohen përdorimi i mekanizmave të duhur për të siguruar konsultimin publik para se të bien dakord për projekte që mund të ndikojnë në ZRK.

Puna kërkimore për mbrojtjen, menaxhimin dhe përdorimin e llojeve dhe habitateve të egra që gjenden natyrshëm në territorin kombëtar është ende në fazën fillestare. Një sasi e vogël e fondeve sigurohet nga Ministria për institucionet kërkimore, për mbledhjen dhe sigurimin e të dhënave për jetën e egër. Pjesa më e madhe e financimit vjen nga burime të jashtme, siç janë projektet e mbështetura nga BE dhe Shtetet Anëtare të BE-së. Agjencia për Kërkim dhe Inovacion po mbështet programe kërkimore edhe pse në një shkallë të kufizuar. Sidoqoftë, ekzistojnë kapacitete të kufizuara shkencore në fusha të specializuara (ornitologjia, jorruazorët, biodiversiteti detar) midis institucioneve shtetërore kërkimore. Kërkimi mbështetet gjithashtu nga OSHC-të.

Projektet e financuara nga donatorët kanë zhvilluar disa aktivitete edukuese mbi Natura 2000. Për më tepër, OSHC të ndryshme kanë kryer gjithashtu aktivitete që synojnë përmirësimin e njohurive të publikut mbi procesin dhe konceptet e Natura 2000. Sidoqoftë, duke marrë parasysh njohuritë e kufizuara mbi konceptin, përfitimet dhe detyrimet e Natura 2000, është e nevojshme të zhvillohet një fushatë promovuese dhe sensibilizuese në shkallë të gjerë që përfshin OSHC-të dhe universitetet/shkollat për të promovuar edukimin.

### **Pozicioni i OSHC-ve dhe pritshmëritë mbi çfarë duhet ndryshuar/përmirësuar.**

Procesi i përcaktimit të rrejtit Natura 2000 në Shqipëri është në një fazë fillestare. Duke u mbështetur në parimin e kujdesit paraprak, mund të dalim në përfundime se lista e propozuar e zonave Natura 2000 mund të jetë e pamjaftueshme. Deri më tani, ka boshllëqe të mëdha të të dhënave për shpërndarjen e habitateve dhe llojeve me rëndësi për BE-në. Nivelit i njohurive dhe të dhënave ekzistuese e bën të vështirë vlerësimin e koherencës dhe nivelit të plotësisimit të listës së propozuar të zonave Natura 2000. Është disi e pamundur të vlerësohet përshtatshmëria dhe mjaftueshmëria e zonave të propozuara, bazuar në rregullin 20% -60% të zbatuar nga KE, në procesin e vlerësimit të vendit përkatës.

Lista e zonave të propozuara përfshin vetëm një zonë të propozuar si ZVM (Direktiva e Shpendëve) dhe si ZRK/ZVR (Direktiva e Habitaveve), ndërsa të gjitha zonat e tjera propozohen vetëm si ZRK/ZVR, megjithëse disa nga zonat e propozuara janë të rëndësishme edhe për llojet e shpendëve. Zonat e propozuara kanë kufij të përafërt dhe kërkojnë hartëzim më të hollësishëm të habitateve dhe përcaktim të përparësive të menaxhimit.

OSHC-të mund të kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme në përfundimin e punës kërkimore për mbrojtjen, menaxhimin dhe përdorimin e llojeve dhe habitateve të egra që gjenden në territorin kombëtar. Ekzistojnë disa OSHC të specializuara që kanë përvojë dhe njohuri të mira (të dhëna) mbi habitate dhe grupe të ndryshme të llojeve. Do të ishte e arsyeshme të mobilizohen OSHC të tilla për të mbështetur procesin e anëtarësimit në BE duke zhvilluar aktivitete që mund të plotësojnë boshllëkun e njohurive mbi llojet dhe shpërndarjen e habitateve në të gjithë vendin.

Direktivat kërkojnë që të ndërmerren hapat e duhur për të shmangur përkeqësimin dhe/ose shqetësimin e habitateve natyrore dhe habitateve të llojeve në ZVR edhe para shpalljes të tyre zyrtare. OSHC-të duhet të jenë gjithmonë të vetëdijshme dhe të ngrenë zërin e tyre me shqetësim, nëse ka ndonjë plan ose projekt që mund të ketë një efekt të rëndësishëm në atë zonë. Projekte/plane të tilla duhet t'i nënshtrohen një vlerësimi të duhur të ndikimeve të tyre në ruajtjen e zonës.

Moratoriumi i gjuetisë, i miratuar për të siguruar rikuperimin e faunës së egër dhe llojeve të gjahut, duke i lejuar qeverisë kohë të mjaftueshme për të përgatitur legjislacionin e nevojshëm dhe planet e menaxhimit të llojeve të gjahut, në mënyrë që praktika e gjuetisë të jetë në përputhje me parimet e përdorimit të mençur dhe kontrollit të ekuilibruar ekologjikisht të llojeve të botës së egër, nuk po funksionon si duhet. Gjuetia ende ndodh në rajone të ndryshme të vendit, madje edhe brenda disa zonave të mbrojtura. Autoritetet e zbatimit të ligjit (Inspektorati, Policia e Shtetit) nuk kryejnë inspektim dhe mbikëqyrje të përshtatshme dhe rastet e gjuetisë së paligjshme nuk ndiqen siç duhet. Korrupsioni dhe presioni politik janë ndër çështjet që ndikojnë në tolerancën ndaj gjuetisë pa leje.

OSHC-të duhet gjithashtu të kontribuojnë në zhvillimin e aktiviteteve edukuese që synojnë përmirësimin e njohurive dhe perceptimit të publikut mbi procesin dhe konceptet, përfitimet dhe detyrimet e Natura 2000.

## Lëkura e fokave dhe të vegjëlit e fokave

Direktiva dhe rregullorja e përfshirë në këtë seksion rregullon importin/eksportin dhe tregtimin e produkteve me origjinë nga fokat. Direktiva 83/129/KEE për të vegjëlit e fokave kërkon që Shtetet Anëtare të marrin dhe ushtrojnë mbajnë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që produktet e lëkurës së të vegjëlve të fokave të mos importohen dhe tregtohen në territoret e tyre. Rregullorja 1007/2009 për tregtinë e produkteve të fokave rregullon vendosjen në treg dhe/ose importin e produkteve të tyre. Shtetet Anëtare nuk do të pengojnë vendosjen në treg të produkteve të fokave, të cilat janë në përputhje me këtë Rregullore. Shtetet Anëtare do të përcaktojnë rregullat për ndëshkimet e zbatueshme për shkeljet e kësaj rregulloreje dhe do të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që ato të zbatohen. Dënimet e parashikuara duhet të jenë efektive, proporcionale dhe dekurajuese.

### **Niveli i transpozimit**

Kërkesat e direktivës për lëkurët e fokave dhe rregulloret përkatëse nuk janë transpozuar aspak në legjislacionin kombëtar. Meqenëse nuk ka legjislacion specifik, nuk ka autoritet kompetent të përcaktuar për zbatimin e kërkesave, duke përfshirë verifikimin, kontrollin dhe mbajtjen e regjistrave. Nuk ka asnjë legjislacion që përcakton termat e referencës për krijimin ose delegimin e një autoriteti përgjegjës për të zhvilluar dhe zbatuar masat e duhura duke siguruar që produktet e listuara të mos importohen.

### **Kuadri institucional**

Institucioni kryesor përgjegjës për zbatimin e këtyre rregulloreve është Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Mjedisore - Drejtoria e Politikave dhe Strategjive Mjedisore). Sidoqoftë, institucionet e tjera përkatëse të MTM-së kanë një rol të rëndësishëm në zbatim, të tilla si Inspektorati Shtetëror i Mbrojtjes së Territorit.

Edhe pse qëllimi kryesor është ruajtja e botës së egër, këto rregullore kërkojnë kontroll të doganave dhe/ose tregjeve, që do të thotë një bashkëpunim më i ngushtë me institucionet e tjera (Ministria e Ekonomisë, Drejtoria e Doganave, etj.) Në këtë drejtim, duhet të zhvillohen dhe zbatohen procedura të qarta dhe marrëveshje bashkëpunimi ndër-institucional. Përgjegjësia kryesore duhet të mbetet tek Drejtoria e Doganave. Sidoqoftë, ata nuk janë të përgatitur për të kryer këtë detyrë. Nuk ka masa të vendosura për të siguruar që produktet e renditura në aneksin e direktivës nuk importohen në vend.

### **Statusi i zbatimit, boshllëqet e identifikuar dhe veprimet**

Duke marrë parasysh që direktiva dhe rregullorja nuk janë transpozuar aspak, është e pavend të flitet për zbatim. Së pari, zbatimi kërkon transpozimin e plotë të kërkesave të këtyre rregulloreve në legjislacionin kombëtar.

Nuk ekziston asnjë sistem monitorimi për të siguruar që është e ndaluar dhe nuk ndodh importimi dhe vendosja në treg e produkteve të fokave dhe se zyrat doganore në pikat kufitare ndjekin procedurat e duhura të importit. Personeli në zyrat doganore nuk është në nivele të përshtatshme dhe nuk ka pasur ndonjë trajnim specifik për oficerët doganorë, për t'i lejuar ata të inspektojnë këto lloj mallrash.



Nuk ka rregulla të përcaktuara për gjobat dhe nuk ka masa të nevojshme për të siguruar që rregullat për gjobat të zbatohen. Është e nevojshme të zhvillohen një sërë rregullash për ndëshkimet për shkelje, si dhe mekanizmat e duhur për zbatimin e këtyre dënimeve.

Publiku nuk është i informuar mirë në lidhje me dispozitat që rregullojnë tregtinë dhe lëvizjen e individëve të botës së egër ose produkteve me origjinë nga llojet e botës së egër. Është e nevojshme të zhvillohet një fushatë informuese me tabelat e duhura të informacionit të vendosura në pikat e kalimit kufitar.

**Pozicioni i OSHC-ve mbi pritshmëritë se çfarë duhet ndryshuar / përmirësuar**  
Direktiva dhe rregullorja për produktet e fokave nuk konsiderohen përparësi nga institucionet qeveritare në Shqipëri.

Sipas mendimit tonë, edhe me transpozim të plotë, zbatimi do të pengohet nga mungesa e kapaciteteve dhe vullneti i ulët i autoriteteve ligj-zbatuese për të kryer inspektime të hollësishme dhe për të ndjekur penalisht shkeljet.

OSHC-të mund të ndihmojnë për zhvillimin dhe zbatimin e fushatave edukuese dhe informuese mbi rregullat për tregtinë dhe lëvizjen e individëve të kafshëve të egra ose produkteve me origjinë nga llojet e botës së egër.

## Kopshtet zoologjike



Direktiva e Kopshteve Zoologjike përcakton kërkesat për krijimin, licencimin dhe menaxhimin e Kopshteve Zoologjike me objektivin kryesor të ruajtjes ex-situ të kafshëve të egra. Direktiva kërkon zbatimin e duhur të legjislacionit ekzistues dhe të ardhshëm të Komunitetit për ruajtjen e faunës së egër; garanton që kopshtet zoologjike përbushin në mënyrë të përshtatshme rolin e tyre të rëndësishëm në ruajtjen e llojeve, edukimin publik dhe/ose kërkimin shkencor; siguron një bazë të përbashkët për legjislacionin e Shteteve Anëtare në lidhje me licencimin dhe inspektimin e kopshteve zoologjike, mbajtjen e kafshëve në kopshte zoologjike, trajnimin e stafit dhe edukimin e publikut vizitues.

## Statusi i transpozimit

Transpozimi i kësaj direktive është në një fazë fillestare. Neni 26 i Ligjit Nr. 10006 „Për mbrojtjen e faunës së egër”, i ndryshuar, parashikon vetëm që Ministri miraton

rregulloren për trajtimin e llojeve të faunës së egër në kopshtet zoologjike dhe mjedise të tjera, ku individët janë të ekspozuar ndaj publikut. Urdhëri i Ministrit të Mjedisit 182, datë 20.09.2016 „Për miratimin e Rregullores “Për trajtimin e llojeve të faunës së egër në kopshte zoologjike dhe mjedise të tjera, ku individët janë të ekspozuar ndaj publikut” “ transponzon pak kërkesa të Direktivës së Kopshteve Zoologjike.

Përkufizimi i kopshtit zoologjik , siç përcaktohet nga kjo direktivë nuk është transpozuar ende në legjislacionin kombëtar. Kuadri ligjor nuk ka caktuar ende një Autoritet Përgjegjës. Kuadri ligjor nuk ofron sqarime mbi sistemin e licencimit ose lejeve. Nuk ka dispozita ligjore për trajtimin e kafshëve, në rast të mbylljes totale apo pjesore të një kopshti zoologjik.

### **Kuadri institucional**

Institucioni kryesor përgjegjës për zbatimin e kësaj direktive është Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. Sidoqoftë, Inspektorati Shtetëror për Mbrojtjen e Territorit si dhe agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit (Policia Bashkiake, AKZM) duhet të mbështesin zbatimin duke siguruar monitorim, inspektim dhe zbatim të ligjit efektiv.

I vetmi institucion që konsiderohet kopsht zoologjik në Shqipëri menaxhohet nga Bashkia e Tiranës. Ka edhe disa vendë të palligjshme të menaxhuara privatisht ku kafshët shfaqen në publik.

### **Statusi i zbatimit, boshllëqet e identifikuar dhe veprimet**

Zbatimi i kësaj direktive nuk ka filluar ende. Zbatimi kërkon transpozimin e plotë të kërkesave të kësaj direktive në legjislacionin kombëtar.

Procedura për lejet e kopshteve zoologjike nuk është ende e qartë. Deri më tani, nuk është dhënë asnjë leje për asnjë kopsht zoologjik ekzistues në Shqipëri. Referencat për kushtet minimale teknike për të siguruar mbrojtjen e faunës së egër duhet të miratohen nga autoritetet përgjegjëse.

Për shkak të kapaciteteve të kufizuara dhe mungesës së roleve dhe procedurave të qarta, nuk ka një sistem eficient të inspektimit dhe zbatimit.

Meqenëse objektivi kryesor i kësaj Direktive është të mbështesë ruajtjen e llojeve të kafshëve të egra, është e nevojshme të sigurohet që e gjithë lista e masave të ruajtjes të përcaktuara nga kjo direktivë të zbatohet në mënyrë eficiente në kopshtet zoologjike.

## 5.

### POZICIONIMI I OJF-VE: PRITSHMËRITË MBI ÇFARË DUHET NDRYSHUAR DHE PËRMIRËSUAR

#### *...për Legjislacionin Horizontal*

Miratimi dhe kalimi i të gjithë ligjeve dhe akteve nënligjore të nevojshme për transpozimin e plotë të paketës të Legjislacionit Horizontal në Shqipëri për të siguruar aktet ligjore dhe zbatimin gjithëpërfshirës. Paketa ligjore për krimin mjedisor kërkon përparësi dhe pozicioni i ISHMPUT në administratën qeveritare duhet të sqarohet. Ne presim një inspektorat funksional dhe të pavarur brenda varësisë së institucioneve qendrore.

Përmirësimi i pjesëmarrjes së publikut gjatë konsultimeve dhe dëgjësave publike, veçanërisht në nivelet vendore, përmes një teknologjie të përparuar më transparente, gjithëpërfshirëse dhe bashkëkohore për informimin publik. Krijimi i një procedure të unifikuar për konsultimet publike gjatë proceseve të VSM-së është shumë e rëndësishme.

Kontrolli i cilësisë së procedurave dhe raporteve të VNM-së, duke vendosur një praktikë të mirë e cila mund të sigurojë kontroll të cilësisë dhe në të njëjtën kohë nishikim të studimeve ekzistuese në një frekuencë prej pesë vitesh. Profili i ekspertëve të sektorit të komisionit vlerësues të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, si dhe bashkëpunimi i publikuar me institucionet akademike dhe njësitë kërkimore do të ndihmojnë të gjithë procesin.

Përcaktimi i përparësive të buxhetimit efektiv dhe zgjidhjeve SMART për zbatimin e plotë të Legjislacionit Horizontal, për të forcuar kapacitetet e administratës publike në burimet njerëzore, njohuritë, aftësitë si dhe në pajisjet, shërbimet dhe zgjidhjet e Teknologjisë së Informacionit.

Zhvillimi i kapaciteteve për mbledhjen e fondeve për zbatimin e paketës ligjore të

Legjislacionit Horizontal dhe partneritetit me organizatat e shoqërisë civile, veçanërisht me Qendrat e Informacionit Aarhus.

### **... për Mbetjet**

Hartimi i Planeve Zonale dhe Planeve Lokale të Mbetjeve do të përcaktojë infrastrukturën e menaxhimit dhe trajtimit të mbetjeve në 10 zonat e parashikuara nga dokumentet strategjike. Infrastruktura brenda standardeve për menaxhimin e mbetjeve është një nga hallkat kryesore të parandalimit dhe zvogëlimit të sasisë së mbetjeve dhe depozitimit të sigurt të tyre.

Financimi për zbatimin e objektivave të vendosur nga Dokumenti i Politikave Strategjike duhet parë me përparësi. Për të rritur standardin e ofrimit të shërbimit objektivat e parashikuara nga Dokumenti i Politikave Strategjike dhe Plani Sektorial duhet të kenë mbështetje financiare të përvitshme sipas planit kohor të parashikuar. Mungesa e financimit çon në mos zbatimin e aktiviteteve të parashikuara në dy dokumentet strategjike dhe rrit kostot për vitet pasardhëse.

Ngritja e skemave për zbatimin e Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuarit do të rregullojë marrëdhënien ndërmjet prodhuesve, importuesve, qeverisë dhe kompanive të riciklimit për të menaxhuar në mënyrë të integruar mbetjet nën këtë kategori.

Ofrimi i shërbimit në të gjithë territorin do të ulë mundësinë e krijimit të vend depozitimeve ilegale apo depozitimin e mbetjeve buzë përrrenjve, lumenjve e rrjedhave ujore, të cilat kanë kosto mjedisore të lartë për vendin.

### **... për Ujin**

Sektori i ujit mbetet i fragmentuar dhe me përgjegjësi të shpërndara midis institucioneve në nivelin qendror dhe vendor. Qartësimi i përgjegjësisë sidomos në nivel rajonal dhe vendor duhet parë me përparësi me që ndihmon planifikimin dhe menaxhimin lokal të burimeve ujore.

Duke qene se sektori i ujit paraqitet me ecuri të ngadalte në përmbushjen e detyrimeve të Direktivës Kuadër të Ujit, duhet të synohet progres më i shpejtë në hartimin e planeve të menaxhimit për të gjithë basenet ujëmbledhës të vendit brenda 2022. Këto plane





menaxhuese duhet të paraqesin qartazi zonat me rëndësi natyrore, që kërkojnë mbrojtje dhe ku përdorimi i ujit të jetë i ndaluar ose i kufizuar. Përcaktimi i zonave sensitive në basenet ujore dhe monitorimi më i plotë i cilësisë së ujrave ndihmon ruajtjen e vlerave natyrore në këto basene.

Investimet kapitale të zbatuara për ujin e pijshëm dhe trajtimin e ujërave të ndotura kërkojnë forcimin e kapaciteteve njerezore për shërbimet lidhur me ujin në mënyrë që të rritet eficaenca dhe të sigurohet funksionimi i qëndrueshëm i shërbimit të furnizimit me ujë për qytetarët.

Digjitalizimi i të dhënave dhe asetëve në sektorin e Ujësjellësit dhe Kanalizimeve do të ndikojë drejtpërdrejt në rritjen e eficaencës së punës dhe përmirësimin e cilësisë së ujit dhe shërbimit ndaj qytetarëve.

Masa urgjente duhet të merren për të përparuar me transpozimin e Direktivës së Përmblyjeve dhe asaj Detare, të cilat do të çojnë në plane veprimi për adresimin e masave lehtësuese lidhur me urgjencat dhe mbrojtjen civile në zonat e prirura për përmblyje, dhe për zhvillimin e planeve të Ekonomisë Blu.

### ... për Natyrën

Procesi i përcaktimit të rrjetit Natura 2000 në Shqipëri është në një fazë fillestare. Duke u mbështetur në parimin e kujdesit paraprak, mund të dalim në përfundimin se lista e propozuar e zonave Natura 2000 mund të jetë e pamjaftueshme. Deri më tani ka boshllëqe të mëdha në të dhënave për shpërndarjen e habitateve dhe llojeve me rëndësi për BE-në.

Zonat e propozuara kanë kufij të përafërt dhe kërkojnë hartëzim më të hollësishëm të habitateve dhe përcaktim të përparësive të menaxhimit. Ka mangësi në zonat e propozuara për ruajtjen e biodiversitetit detar si dhe për ruajtjen e grupeve të veçanta të kafshëve (jorruazorët).

Direktivat kërkojnë që të ndërmerren hapat e duhur për të shmangur përkeqësimin dhe/ose shqetësimin e habitateve natyrore dhe habitateve të llojeve në ZVR edhe para shpalljes të tyre zyrtare. Projekte/plane të tilla duhet t'i nënshtrohen një vlerësimi të duhur të ndikimeve të tyre në ruajtjen e vlerave natyrore të zonës.

Moratoriumi i gjuetisë nuk po funksionon si duhet. Gjuetia ende ndodh në rajone të ndryshme të vendit, madje edhe brenda disa zonave të mbrojtura. Autoritetet e zbatimit të ligjit duhet kryejnë inspektim dhe mbikëqyrje të përshtatshme dhe rastet e gjuetisë së paligjshme duhet të ndiqen siç duhet. Korrupsioni dhe presioni politik janë ndër çështjet që ndikojnë në tolerancën ndaj gjuetisë pa leje.

Ka shumë shembuj të kafshëve të egra të ekspozuara ndaj publikut në kushte të këqija. Është e rëndësishme që autoritetet e zbatimit të ligjit të ndjekin penalisht këto raste.

Kopshti Zoologjik i Tiranës duhet të përditësohet për të dhënë shembullin më të mirë për kushtet që duhet të plotësohen për mbajtjen e kafshëve të egra dhe shfaqjen e tyre para publikut, teksa përmbysh njëkohësisht qëllimet për ruajtjen ex-situ të kafshëve të egra.

### **.. për kontributin e OSHCve**

Organizatat e Shoqërisë Civile mund të luajnë një rol të rëndësishëm katalizator për zbatimin e paketës horizontale. Ato mund të monitorojnë vazhdimisht zbatimin e legjislacionit dhe të sjellin argumentin alternativ. OSHC-të janë një aset për informimin dhe edukimin e publikut për platformat e paketës horizontale. Në të njëjtën kohë, me kapacitetet e tyre në shkrim dhe menaxhim projektesh mund të ofrojnë partneritet për ngritjen e teknologjisë së informacionit.

Për më tej OSHC -të mund të kontribuojnë procesin e integritimit dhe negociatave me ekspertizë teknike si dhe duke advokuar për arritjen e standardit të kërkuar mjedisor. Një tjetër drejtim në të cilin OSHC -të mjedisore mund të kontribuojnë në mënyrë aktive është rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve dhe bizneseve për përfitimet e reduktimit, ripërdorimit dhe riciklimit të mbetjeve, menaxhimit të burimeve ujore dhe të ruajtjes së cilësisë tyre, në punën kërkimore për mbrojtjen, menaxhimin dhe përdorimin e llojeve dhe habitateve të egra që gjenden në territorin kombëtar.

OSHC -të janë të vetëdijshme dhe ngrenë zërin e tyre me shqetësim nëse plane ose projekte mund të ketë efekte negative në zonat me vlera natyrore apo raste kur kafshët e egra trajtohen e mbahen në kushte të papërshtatshme.



## REFERENCA

### Referenca të Nën-kapitullit: Legjislatiioni Horizontal

- Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Faqja zyrtare, Këndi i konsultimit publik [www.akm.gov.al/publiku.html#konsulta](http://www.akm.gov.al/publiku.html#konsulta)
- Manual mbi zbatimin e Legjislatiionit Mjedisor - Kapitulli i Legjislatiionit Horizontal, Komisioni Europian [www.ec.europa.eu/environment/archives/enlarg/handbook/horizontal.pdf](http://www.ec.europa.eu/environment/archives/enlarg/handbook/horizontal.pdf)
- Raporti i vitit 2020 për Shqipërinë, datë 6.10.2020 [www.ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/albania\\_report\\_2020.pdf](http://www.ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/albania_report_2020.pdf)
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Faqja zyrtare, Këndi i deklaratave mjedisore [www.akm.gov.al/vendime-vnm.html](http://www.akm.gov.al/vendime-vnm.html)
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Faqja zyrtare, Lejdet mjedisore [www.akm.gov.al/ndikimi-n%C3%AB-mjedisit.html](http://www.akm.gov.al/ndikimi-n%C3%AB-mjedisit.html)
- Udhëzuesi për organizatat mjedisore, vëzhgimi i mjedisit në praktikë, Shkurt 2014, Qendra EDEN [www.eden-al.org/OldWeb/media/Vigjilencia%20mjedisore%20.pdf](http://www.eden-al.org/OldWeb/media/Vigjilencia%20mjedisore%20.pdf)
- Raporti mbi "Projektet hidroenergjetike të VNM / VSM në Evropën Juglindore", Tetor 2015: [www.seechangenetwork.org/wp-content/uploads/2015/11/EIASEA-of-hydropower-projects-in-Southeast-Europe-%E2%80%93-Meeting-the-EU-standards.pdf](http://www.seechangenetwork.org/wp-content/uploads/2015/11/EIASEA-of-hydropower-projects-in-Southeast-Europe-%E2%80%93-Meeting-the-EU-standards.pdf)
- Raporti i monitorimit: "Pushteti lokal nën lentsën e së drejtës së informimit", 2017, Bim [www.portavendore.al/wp-content/uploads/2018/04/Monitorim-Llogaritsh%C3%AB-në-Bim-E-drejta-e-informimit-2017.pdf](http://www.portavendore.al/wp-content/uploads/2018/04/Monitorim-Llogaritsh%C3%AB-në-Bim-E-drejta-e-informimit-2017.pdf)
- Revista Nr. 5, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Qershor 2018 [www.idp.al/wp-content/uploads/2018/07/revista\\_nr\\_5\\_idp.pdf](http://www.idp.al/wp-content/uploads/2018/07/revista_nr_5_idp.pdf)
- Raport vjetor, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, 2019 [www.idp.al/wp-content/uploads/2020/03/Annual\\_Report\\_2019.pdf](http://www.idp.al/wp-content/uploads/2020/03/Annual_Report_2019.pdf)
- Raporti mbi performancën e institucioneve

shtetërore, në lidhje me programin e transparencës, 2019, Qendra Res Publica - [www.portavendore.al/wp-content/uploads/2020/02/E-drejta-e-informimit-2019-Res-Publica-web-min-compressed.pdf](http://www.portavendore.al/wp-content/uploads/2020/02/E-drejta-e-informimit-2019-Res-Publica-web-min-compressed.pdf)

- Raport për Pjesëmarrjen e Publikut në Procesin Vendimmarrës të Kuvendit, 2019 [www.parlament.al/Files/Informacione/Raport%20mbi%20pjes%C3%ABmarrjen%20e%20publikut%20n%C3%AB%20procesin%20e%20vendimmarrjes%202019.pdf](http://www.parlament.al/Files/Informacione/Raport%20mbi%20pjes%C3%ABmarrjen%20e%20publikut%20n%C3%AB%20procesin%20e%20vendimmarrjes%202019.pdf)
- Plani i Veprimt 2020 – 2022 për Partneritet & Qeverisje të Hapur [www.ogp.gov.al/uploads/planiveprimi\\_2020\\_2022/1\\_Shtojca%20Guida%20strukturore%20e%20Planit%20e%20Veprimt%202020-2022.pdf](http://www.ogp.gov.al/uploads/planiveprimi_2020_2022/1_Shtojca%20Guida%20strukturore%20e%20Planit%20e%20Veprimt%202020-2022.pdf)
- Raporti i Prokurorit të Përgjithshëm mbi Gjendjen e Kriminallitetit për Vitin 2019 [www.pp.gov.al/web/kuvendit\\_raporti\\_vjetor\\_2019\\_28\\_3\\_2020\\_pp\\_perf\\_1864.pdf](http://www.pp.gov.al/web/kuvendit_raporti_vjetor_2019_28_3_2020_pp_perf_1864.pdf)
- Deklaratë për shtyp e organizatave mjedisore të Grupit Këshillimor për Krimin Mjedisor, Dhjetor 2020 [www.recshqipëri.org/news-al.php?id=51](http://www.recshqipëri.org/news-al.php?id=51)
- Prezenca e OSBE-së në Shqipëri bashkon institucionet e Shqipërisë për të forcuar luftën kundër krimit mjedisor, Maj 2020 [www.osce.org/presence-in-albania/451588](http://www.osce.org/presence-in-albania/451588)
- Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor [www.asig.gov.al/](http://www.asig.gov.al/)

### Referenca të Nën-kapitullit: Mbetje

- Agjencia Kombëtare e Mjedisit [www.akm.gov.al/](http://www.akm.gov.al/)
- Raporti vjetor i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, 2019 [www.akm.gov.al/assets/rqjm-2019.pdf](http://www.akm.gov.al/assets/rqjm-2019.pdf)
- Raporti vjetor i Entit Rregullator të Ujit, 2019 [www.eru.al/#](http://www.eru.al/#) [www.eru.al/doc/Raporti\\_vjetor\\_2019.pdf](http://www.eru.al/doc/Raporti_vjetor_2019.pdf)
- Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore <http://www.akbn.gov.al/mission/?lang=en>
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit [www.turizmi.gov.al/strategjia-e-mjedisit/](http://www.turizmi.gov.al/strategjia-e-mjedisit/)
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë [www.](http://www.)

- SANE27 - Kapitulli 27: Mjedis dhe Ndryshimet Klimatike, Raporti
- Shqyrtimit Analitik dhe Vlerësimit Përgatitor.
- Dokumenti i Politikës Strategjike të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve dhe Plani Kombëtar, 2020 - 2035.
- Studimi sektorial për kërkesën për investime për menaxhimin e integruar të mbetjeve të ngurta (ISWM) në Shqipëri - Raporti Përfundimtar i Studimit të Sektorit.

### Referenca të Nën-kapitullit: Uji

- Raport Vjetor i Entit Rregulator të Ujit 2019 ERRU 2020 [www.rru.al/doc/Raporti\\_vjetor\\_2019.pdf](http://www.rru.al/doc/Raporti_vjetor_2019.pdf)
- Raport Vjetor i Entit Rregulator të Ujit 2020 ERRU 2021 [www.rru.al/doc/Raporti\\_vjetor\\_2020.pdf](http://www.rru.al/doc/Raporti_vjetor_2020.pdf)
- Instrument for Pre accession Assistance IPA II Albania, 2014 – 2020 European Commission (2014) [https://ec.europa.eu/neighborhood-enlargement/sites/hoar/files/pdf/key\\_documents/2014/20140919-csp-albania.pdf](https://ec.europa.eu/neighborhood-enlargement/sites/hoar/files/pdf/key_documents/2014/20140919-csp-albania.pdf)
- Raporti i vitit 2020 për Shqipërinë, Komisioni Europian (2020) [https://ec.europa.eu/neighborhood-enlargement/sites/hoar/files/albania\\_report\\_2020.pdf](https://ec.europa.eu/neighborhood-enlargement/sites/hoar/files/albania_report_2020.pdf)
- EUSIWM / Mbështetja e BE-se për Menaxhimin e Integruar të Ujit, ADA (2020) <https://www.entwicklung.at/en/projects/detail-en/eusivm-eu-support-to-integrated-water-management-ec-funds>
- Strategjia Kombëtare për sektorin e Furnizimit me ujë dhe kanalizime, 2011 – 2020, Qeveria e Shqipërisë (2011)
- Strategjia Kombëtare për sektorin e Furnizimit me ujë dhe kanalizime, 2020 – 2030, Qeveria e Shqipërisë (2020) [www.akum.gov.al/](http://www.akum.gov.al/)

- Customer and performance-oriented drinking water and sanitation services, Dokumenti i projektit GIZ 2020 [www.giz.de/en/worldwide/20440.html](http://www.giz.de/en/worldwide/20440.html)
- Vlerësim i Performancës së Aktivitetit të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kapaciteteve të Sektorit të Ujit, Raporti Përfundimtar i Vlerësimit, USAID Maj 2019

### Referenca të Nën-kapitullit: Natyra

- Dokumenti i Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit, 2016, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
- Raporti përfundimtar i përfundimit të projektit NaturaAL „Forum i kapaciteteve kombëtare për mbrojtjen e natyrës - përgatitje për rjetin Natura 2000“, 2019, NaturaAL
- SANE27 - Kapitulli 27: Mjedis dhe Ndryshimet Klimatike, Raporti i Shqyrtimit Analitik dhe Vlerësimit Përgatitor.
- Ligji Nr. 8294 “Për Ratifikimin e „Konventës për Ruajtjen e Florës dhe Faunës së Egër dhe Mjedisit Natyror (ë Europës (Konventa e Bernës )”, 1998
- Ligji Nr. 9587 “Për Mbrojtjen e Biodiversitetit”, i ndryshuar (2006)
- Ligji Nr. 10006 “Për Mbrojtjen e Faunës së Egër”, i ndryshuar (2008)
- Ligji Nr. 10253 “Për Gjuetinë”, i ndryshuar (2010)
- Ligji Nr. 61/2017 “Për Zonat e Mbrojtura” 2017
- VKM Nr. 546 “Për Miratimin e Listës së Llojeve të Faunës së Egër, Objekt Gjuetie”
- VKM Nr. 866 “Për Miratimin e Listave të Tipave të Habiteteve Natyrore, Bimëve, Kafshëve dhe Spenjëve, me Interes për Bashkimin Evropian”
- VKM Nr. 897 “Për Miratimin e Rregullave për Shpaljen e Zonave të Veçanta të Ruajtjes”







# Këndvështrimi alternativ i progresit mjedisor

Negociatat e Shqipërisë  
në BE dhe Kapitulli 27





